

INTERVISTË ME SHKËLZEN MALIQIN

Prishtinë | Data: 20, 21 dhe 22 tetor, 2018

Kohëzgjatja: 361 minuta

Të pranishëm:

1. Shkëlzen Maliqi (I intervistuari)
2. Kaltrina Krasniqi (Intervistuesja)
3. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
4. Donjetë Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 20 tetor, 2018]

Pjesa e Parë

Kaltrina Krasniqi: Shkelzen, ma s'pari fillo me ni prezentim, ma s'pari ku ke lind? N'cilin vjet? N'cilin qytet? Mandej me na tregu pak për vendin ku ke lind edhe familjen.

Shkëlzen Maliqi: Unë kam lind me 26 tetor 1947, kom lindë në Rahovec, domethanë ka qenë borë e madhe dimën. Aty ka qenë baba jem atëherë me detyrë dhe kam jetu aty nja dy muj. Përndryshe, baba jem është i Prizrenit, familja e babës e Prizrenit kurse nana e Gjakovës, e kjo diqysh jam lind n'mes as anej as knej. Rahoveci atëherë ka qenë si nifarë ma shumë katun, qytezë-katun i madh ose si qytezë me do rrasa të... shpijat me rrasa kanë qenë krejt t'mbulune.

Dej n'pesë vjet kam qenë shumë *proud* [Eng], domethanë krenar me vendlindjen teme, por kur me pesë vjet m'patën çu atje me pa, u ftofa krejt se u doke katun. Familja jeme është e Prizrenit, dikun ka fundi i shekullit XVIII prej rrethinës të Kukësit ka ardhë ni katragjysh atje në Prizren. Aty kanë jetu domethënë nja katër-pesë breza, kurse familja e nanës është e Stavilecit, e Gjakovës. Këta Stavilecët që janë t'njohun krejt i kom si kusheri t'afërt, janë djemtë e axhës të nanës time. Tash çka me të tregu për familjen a...

Kaltrina Krasniqi: Fol për prindërit e tu pak.

Shkëlzen Maliqi: Po prindërit e mi, baba jem ka qenë si jetim, domethanë ka qenë pesë-gjashtë vjet kur i ka vdek baba i tij. A gjyshi jem Hazëri, ai ka qenë me shërbim dikund në Stamboll në Turqi. Domethënë ka qenë një Çausi¹ atje, një sulltanit të Turqisë të cilin me 1908 kur ka qenë revolucioni

¹ Titull i një udhëheqësi në hierarkinë e udhëheqësisë në Perandorinë Osmane. Inspektor i ditëve të sotme.

Xhonturk² atje u dashtë me u largu me ikë prej atjehit, e ka lanë krejt atje shpinë, e pasuninë, e krejt. E ka pasë vetëm një vajzë ai, hallën teme t'madhën. Ka ardhë në Prizren në vendlindje aty, mandej e kanë nrxanë këto Luftat Ballkanike, Lufta e Parë Botërore, e nuk ka mujt me shku atje në Stamboll me e nxjerrë pasurinë a diçka. Na gjithë në familje e kem pasë mit, se atje e ka pasë një shpi t'madhe, se një ditë munëm me e shit ose me i gjetë ato tapitë. Bile edhe tapitë kanë qenë, por gjyshja jeme si ato gratë tjera që kanë mbetë pa burra në atë kohë, ia ka dhanë njëfarë, e ka pasë mbemrin Pasuli, i familjes Pasuli i Prizrenit, ai ka thanë, "Kqyri i nxjerri ato tapitë me i shitë", po s'ka mujt kurgjo me bo.

Bile deri në vitet e '50-ta, '52, '53 ai kishte jetu, mandej kur ka vdekë janë hupë ato tapitë. Familja e axhës tim ka pasë shku në Turqi edhe halla në vitet e '50-ta nga fundi i '50-tave edhe kanë provu me i gjetë ato, po kurrë s'i kanë gjetë. Kështu, domethanë dikun me 1924 ka vdekë. E baba jem, edhe axha edhe dy hallat kanë mbetë qishtu si jetime. Baba jem ka nisë herët me punu si fmi me e mbajt pak familjen, mandej ka punu në shumë zanate, po mandej u bo furrëtar. Si furrëtar dikun i ka pasë nja... sa vjet ka mujt me i pasë, 18 vjet a diçka ka shku me punu në Shkup. Atje ka bo kesi farë simate e sene. Edhe mandej... prej atëherë u lidh pak edhe me këta, t'them ashtu, medresanët nga Kosova, domethanë kanë qenë të Prizrenit. Si Ramadan Vraniqin e këta, nifarë Gjergj Breci... ata... ndër ta ka pasë qisi lëvizje majtiste. Edhe ai pak shkollë ka pasë, tri vjet ka shku shkollë, ka ditë me lexu edhe është ndiku pak edhe ka qenë njëfarë antifashisti se gjatë m'tregojke që ka lexu lajmet për pushtimin e Abisinisë, Etiopisë, për Havi Sallasin e luftën këtyne, por edhe kur u pushtu Shqipëria u bo i afërt me këta.

Mirëpo, lufta këto e ka zatet në ushtri, ka qenë në ushtrinë Jugosllave. Ushtria atëherë ka zgjatë dy vjet e sa. Në '41-shin ai ka qenë në Zajëçar në Serbinë Lindore atje afër Rumanisë, po nuk e ka nrxanë rob ka qëllu, ai ka punu qashtu në... po të tregoj këto detaje nashta janë interesante, ka punu në ushtri ai ka qenë një njeri i gjindshëm, simpatik e kështu e ka punu në komand atje bile edhe ai ka qenë rrogat i ka nda kur kanë ardhë atje i ka nda oficerëve. Meqë me 6 prill ka ndodh sulmi, me 6 prill 1941 Gjermania ka sulmu Jugosllavinë edhe ushtria ka qenë nifarë, në, në kaos. Bash qato ditë kur kanë ardhë rrogat edhe diçka, tha, "Mu m'kanë mbetë me thasë ato paret", edhe ky ka shku i ka ble do rroba civile edhe u nisë n'kamë prej Zajëçarit në Prizren. Serbishten e ka ditë edhe u gjind qashtu. Natën kryesisht ka udhtu, ditën ka hi ka flejt dikun u mshef sepse me pasë nrxanë... sepse ajo Jugosllavia pat' kapitulu shumë shpejt mas një javë, a dhjetë ditë a, qishtu diçka, edhe ka qenë ushtria n'kaos e krejt, po qishtu diqysh ka mrrri deri në... Kur ka mbrri në Prishtinë ka thanë, "Okej, shpëtova" (qesh). Po masnej meniherë u lidhë me Lëvizjen, atëherë Komuniste Përparimtare në Prizren e mas disa mujve e kanë nrxanë e kanë burgos edhe ka qenë në burgun në Tiranë. Qikjo është... aty ka qenë në burg, deri në... ato burgjet kanë qenë si njëfarë shkollë komuniste plot ka pasë qisi farë, aty ka mësu shumë sene.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka përfundu n'burg... për shkak të... ?

Shkëlzen Maliqi: Po kanë qenë grupet e ktyne komunistëve që janë përgaditë për kryengritje për sene qishtu.

Kaltrina Krasniqi: E në atë kohë ka qenë Prizreni i okupum prej italianëve apo?

² Lëvizje nacionale-borgjeze që lindi në vitet '80 të shek. XIX në Perandorinë Osmane dhe drejtohej kundër absolutizmit të sulltan Abdyl Hamitit II.

Shkëlzen Maliqi: Italianët kanë qenë, po italianët. Mirëpo janë liru nga burgu kur kanë kapitullu italianët në shtator në vitin 1943. Atëherë kanë ardhë ata bugarët që e kanë pasë okupu Maqedoninë, kanë thanë, “Kush është këtu bugar le t’lajmërohet”. Ato evidencat senet si kanë pasë e ky u lajmëru masi e ka ditë maqedonishten që ka jetu në Shkup. U lajmëru si bugar, ja kanë ngjit një mbiemer si bugar Spaso, Spaso, qashtu diçka. Edhe celula e Komunistëve jashtë qytetit e ka organizu me dalë ata prej radhës, se janë bo ata 100-200 metra, krejt këta të burgosun që kanë qenë t’Maqedonisë perëndimore e kshu Dibrës e çka po di edhe aty mandej u largu prej asaj kolonës me do far sheja, tha vetëm ni problem e kanë pasë kur kanë nisë ata me e thirrë ky e kish harru emrin e vet, tha, që na kanë dhanë aty (qesh) ata e kishin thirë dhetë herë qat’ far Spaso, Spaso a çka po di derisa iu ka kujtu ktij, “Ja, ja”, hajt mirë, që i kanë liru kështu me hatër... se çka po di, Bullgaria i ka marrë t’vet, po qashtu... Po atje në burg, ai derisa ka qenë n’burg ka ndigju për atë rastin e vrasjes së asaj treshit të famshëm që ka qenë Sadik Stavileci, Gjorgji Martini edhe Vojo Kushi.

Kaltrina Krasniqi: A mundesh me e shpjegu pak më detalisht qet’ vrasje?

Shkëlzen Maliqi: Ata kanë qenë, domethanë njëfarë celule e Partisë Komuniste. Ajo farë... që kanë pasë njëfarë mledhje te Kodra e Kuqe në Tiranë, aty dikun mbrapa 15 katëshit shumë afër është një 200-300, 500 metra ma poshtë, aty kanë pas njëfarë takimi. Dikush a i ka paraqit a ka qenë shtëpia e rrethume... Edhe i kanë... këta kanë luftu pak sa kanë mujt, po janë vra te tretë atje. Legjenda ka qenë se ata kanë hyp n’tenkë ose nashta pak është e zbukurume, po saktë është që me ni shpi te ni “Ija” atje, qishtu i thojshin, masnej e kanë vizitu ato ma vonë 1971 si familje, e kjo ka ndodhë në vitin 1942 kur janë vra ata. Ma vonë ky Sadiku, daja jem, u shpall hero e kështu.

Baba jem e ka ditë këtë ngjarje edhe i ka bo shumë përshtypje. Edhe mandej kur u kthy në Kosovë meniherë ka dalë në Partizanë, s’ka nejt ma në Prizren se e kanë ditë që prapë e kërkojnë e lypin e ka shku në Malsi të Gjakovës. Atje ka luftu kryesisht, në qato zona të malit Shkëlzen e të Valbona, në... ku ka pasë nevojë qaty pari ka luftu. Edhe aty edhe ka vendosë që nëse mbetëm gjallë me ia ngjit emrin atij malit ku ka luftu, Shkelzenit, mu a din, djalit t’parë në familje, mandej qashtu edhe ka ndodhë. Po mirë, lufta ka qenë si luftë, ai e ka pasë kryesisht, kanë qenë grupet e vogla që janë sillë disa knej në Karadak, disa në malin e Sharrit edhe anej kah... Baba jem ka qenë edhe në konferencën e Bujanit, që për herë t’parë është fol për statusin e Kosovës në të ardhmën, edhe aty është aprovu ajo rezoluta se populli i Kosovës dëshiron të bashkohet me Shqipërinë edhe mas luftës do të duhej ta realizonte atë drejtën. Po ai s’ka qenë njëri ndër delegatët se ka qenë relativisht i ri, por ka qenë gjellbërës e ky ja ka bo bukën, a din (qesh), simpatike, po ashtu ka qenë. Domethënë kjo është historia e babës tem...

Mandej me ‘44-shin kur u shliku Gjakova, ai ka marr pjesë në sulmin e Gjakovës e tani në xhami atje te dera tu luftu atje dikush prej minarës e ka gjujt një bombë edhe këtij pak që e ka qit kryt është lëndu me ato... Nji sy e ka hup edhe në trup ka pasë shumë kësi farë, edhe deri vonë kur kam qenë fëmijë ose i dilshin ose... edhe pat bo atë synin operacion, i ka met kështu po nuk shifte me synin e majtë, kështu. Po atëherë mas luftës, ka mar vesh se bile edhe i ka taku njëhere në atje në Malsi të Gjakovës. Familja Sadiku, gjyshja prej nanës, bashkë me domethanë gjyshën teme edhe fëmijtë edhe nanën teme ata menihere kanë ikë prej Gjakovës se janë tut prej episaleve, me kuaj e kështu. Njihere e kish pa t’u e hyp n’kal atë nanën tem, Remzien, ka qenë hala... ajo ka lind me 1927, baba jem dikun me 1918 ose 1919, ‘19 me gjasa, po atëherë ka qenë ‘27-ta, 16-17 vjet ka qenë. Edhe shoqe me Ganimete Tërbeshin,

ata kanë qenë si aktiviste kanë bajtë materiale sene. Atëherë e ka pa ashtu n'kali, e ka ditë se është motra e Sadik Stavilecit edhe mas luftës i ka çu selam me u martu edhe qishtu janë martu.

Para meje e kanë pasë një motër ma t'madhe ajo ka lind në Suharekë në 1946, po pas një viti ka pasë njëfarë, t'them ashtu, a ftoje a diçka edhe ka vdekë kështu pa... nashta s'kanë qenë kushtet e mira. Baba jem ka qenë atëherë në '45-tën kur u lëndu, ka pasë qenë atëherë tre-katër mujë nëpër spitale për me u shëru. Kur e shërun, ata krejt partizanët e Kosovës i kanë çu në Vojvodinë atje dikun, i kanë majtë atje në Kikindë a ku, atë brigadën e famshme s'i kanë shti n'luftë, s'di edhe çka kanë dashtë me bo me ta, nashta veç me i largu prej Kosovës, e kur koka kthy këtu në Prizren ata i kanë thanë, "Ah tash s'mujm me t'çu atje veç ti ki me qenë OZNA³. Ki me qenë në këtë farë Shërbimin Sekret, Shërbimin e Inteligjencës". OZNA akronim është diçka Organizata për Mbrojtjen e Popullit, po kryesisht ka qenë famëkeqe i kanë, i kanë ndjekë {kollitet} ballistat e krejt këta që kanë qenë kundër regjimit të ri edhe bile i ka mbete asi nifarë nofke Mehmet OZNA. I ka pasë dy nofka Mehmet Cikuli dhe Mehmet OZNA. Cikuli e ka pasë prej fëminisë qashtu...

Aurela Kadriu: Çka i bjen?

Shkëlzen Maliqi: Kurgjo.

Aurela Kadriu: Çka i bjen?

Shkëlzen Maliqi: Ka edhe mbiemra Cikuli në Shqipëri i kam dëgju. A Mehmet OZNA është kështu si me funksion [në OZNA] e qashtu. Me '47-tën kur kam lindë unë, ai s'ka qëllu te shpija, nja dy javë, tri, ka qenë m'doket atje në malin e Berishës tu i ndjek këto Ballistat, Çetat e Ballistëve dhe që kanë qenë. Kur u kthy i kanë thanë, "Urime që t'ka lindë djali. Ja kena ngjit emrin Bajram", se kisha lindë unë në ditën e bajramit. Ai meniherë, "Çfarë Bajram" tha, "s'bon Bajram" tha, "ai e ka emrin Shkelzen". Ata kushërinjtë e mi të Prizrenit, kryesisht te shpija kanë fol turqisht, a din, kanë thonë, "Av av av Avavav, nedir bu ad. [Turqisht] Av av av çka është ky emër kështu?" As nuk kanë ditë me shqiptu, "Iskender, Iskender". Turqit "s-në" edhe "sh-në" nuk mujshin me e shqiptu n'fillim të fjalës, ia shtojshin një "i" po mandej diqysh janë mësu edhe kjo është njëfarë historie.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë fëminije ke pasë?

Shkëlzen Maliqi: Mandej baba jem ka bo menjëherë asi, a, çka?...

Kaltrina Krasniqi: Çfarë fëminije ke pasë?

Shkëlzen Maliqi: Po mirë ka qenë, relativisht i privilegjum. Domethanë, neve kemi jetu në Prizren kur kam qenë shumë i vogël, po baba jem kështu nifarë si kuadri i luftës edhe e ka pasë shumë t'afërt atë Katerina Patronogiq-Cica, ka qenë ni heroinë serbe e Prizrenit, e ka dashtë babën tem shumë. Ajo u

³ Drejtoria e Mbrojtjes Popullore, akronimi OZNA (serb. Odsjek za Zaštitu Naroda) shërbim informative i RSF të Jugosllavisë, i themeluar më 13 maj 1944, nën udhëheqjen e Aleksandar Rankoviçit, antarit të lartë të Politbrosë politike dhe bashkëpuntorit të afërt të Josip Broz Titos. Në mars të viti 1946 është riorganizuar në UDB (Upravu državne bezbednosti) dhe KOS (Kontraobaveštajnu službu Jugoslovenske armije) Shërbim i kundërzbulimit të armatës Jugosllave.

martu për ni partizan të Shqipnisë, Hajrullah Ishmin, po ai ka qenë ndër udhëheqësit prej serbëve ndoshta njëra prej ma...

Kaltrina Krasniqi: Ma të fuqishëm?

Shkëlzen Maliqi: Ma me ndikim këtu dhe gjithmonë e ka pasë me u avancu a diçka. Edhe shumë herët, diku viteve '50-ta ka shku në njëfarë shkollë në Beograd. Ka qenë Shkolla e Partisë, po s'di sa ka zgjatë m'doket një vjet, po a din si kurse t'shkurta për ni vit i kanë mësu çka mëson për ni shkollë t'mesme a qishtu diçka e kombinume. Se ky i ka pasë dikun tre klasa t'obligushme pak si... sa për sy e faqe mes dy luftërave, se s'ka pasë shkolla shqipe po qishtu pak si njifarë... edhe qaty...

Mandej kur u kthy ka qenë në njifarë posti në Prizren, n'polici një kohë ka qenë në Mitrovicë nja një vjet une i kom pasë atëherë tre-katër vjet edhe m'kujtohen ato, kujtimet e para që i kam të Mitrovicës. Ndoshta imazhi i parë që e kam ka qenë 1 maji i... m'duket ka qenë viti 1951 në Mitrovicë kur kam dalë me shetitë edhe m'kujtohet është ni shkollë atje që e ka një oborr përpara t'gjanë aty i kom pa do flamura e do sene. Si njifarë imazhi i parë që m'kujtohet kështu nuk muj me e rekonstrukt plotësisht po që m'ka mbetë n'kujtesë edhe lumi m'kujtohet. Neve e kemi pasë banesën afër lumit, ka qenë si nifarë pjerrtësine edhe aty poshtë kom zbrit lujsha edhe kanë qenë anash do, këto... të mbjelluna kallamoq e kështu, shkojsha aty vjedhsha kallamoq (qesh) me çu te shpija me pjek, e kështu, qato sene. I kom pasë do pula në oborr edhe njifarë biçiklete. Bile fotografitë me ato pula i kam dikun, shumë janë interesante a din, edhe i kam veshun do kule t'shkurta si femna (qesh), po djalë ashtu simpatik kom qenë (qesh).

Kaltrina Krasniqi: Mandej kur kanë ardhë motrat edhe vllaznitë e ju? Sa fëmijë jeni?

Shkëlzen Maliqi: Motra jeme ka lind edhe ajo në Prizren me '49-shin, vëllau në '54-shin ka lindë në Prizren edhe ai, edhe motra ma e vogël në Prishtinë me 1961. Baba jem prej 1954 u bo njifarë funksioner i lartë, se atëherë u bo shef i... domethanë, si njifarë Ministri i Rendit në atë Kosovë, atëherë ka qenë *pokrajina*, i thojshin krahinë me autonomi t'kufizune po e ka pasë njifarë... policinë e vet. Kryesist kanë qenë nën komandën e Serbisë hala, po qatëherë ka qenë nja dy vjet aty, bash këtu ku është tash Qendra e Policisë.

M'kujtohet, atëherë kam qenë në klasën e parë jom regjistru këtu në Prishtinë këtu te Vellusha kem banu afër shkollës. Jam nisë në shkollë kam shku për herë t'parë te kjo, sot është "Elena Gjika" atëherë ka qenë "Vuk Karadžić" po. E kam nisë shkollën shqip, po ai baba jem qishtu dy, tre vjet me një post masnej e kanë çu diku tjetër, zakonisht Prizren-Prishtinë, Prizren-Prishtinë, veç nihere kemi qenë në Mitrovicë edhe atëherë shumë herët kur kam lindë ka qenë me detyrë në Rahovec. Ma vonë dy vjet këtu këtu edhe qashtu shkollën e kam nisë këtu klasën e parë mandej deri në klasën e pestë kam qenë në Prizren, mandej prej gjashtën e deri të tetën në Prishtinë. Këtu e kam kry shkollën fillore e mandej në Prizren dy vjet shkollë, gjimnazin, edhe këtu vitin e tretë e t'katërt qashtu që...

Relativisht mirë kem qenë se krejt kanë qenë me nomenklaturë atëherë, Kosova nuk ka qenë aq e pasur as këta, po mendoj edhe udhëheqësit atëherë s'kanë pasë privilegje t'mëdha, por megjithatë kanë qenë t'priviligjun. S'kujtoj që e kena pasë naj fëmini t'keqe. Dikun prej viteve '56-'57 bile kem nisë me shku edhe në deti. Në Ulqin shkojshim, atëherë vitin e parë e t'dytë me do shatora me sene, sa mu gjind se edhe une kam qenë diçka prej fytit si i ndishëm edhe vëllavi jem Gazmendi që pat' lind 1954

edhe ai diçka smutë, edhe mandej na kanë çu qashtu n'deti. Tani çdo vit shkojshim. Kanë qenë atëherë pak si raritet, a din, shkojshim në atë plazhën e vogël edhe gjithë kishte mjaft vend, vishin do prej vendeve tjera të Jugosllavisë por s'ka qenë turizmi si sot. Qashtu. Nuk kam qenë shumë problem. Prizreni m'ka pëlqy shumë, Prishtina hiç.

Kaltrina Krasniqi: Kallxom pak për të dy qytetet?

Shkëlzen Maliqi: Po de. Prizreni ka qenë interesant, a din, edhe shumë ka pasë nifarë diversiteti si edhe sot. Prej fëminisë, domethanë prej gjashtë-shtatë vjetëve që i kam pasë i kam ditë të tre gjuhët të Prizrenit, të qytetit. Edhe ma s'pari shqip se n'familje flisnim shqip. Nana ka qenë e Gjakovës, mandej turqisht se pjesa ma e madhe e familjes janë të Prizrenit, po edhe gjyshja edhe nana jeme. Gjyshja ka qenë e Opojës me prejardhje, po babën e ka pasë, gjyshja prej nanës, u martu ai babgjyshi, katragjyshi jem prej nanës ai ka jetu në Prizren edhe gjyshja jem prej Prizrenit u martu në Gjakovë. Shqipën e ka ditë shumë mirë, po edhe turqishten, po edhe ne shpesh folshim te halla e këto me turqisht.

Është interesant se në Prizren në atë kohë, qytetarët ata kasabalitë që i thojshin, ata e kanë ditë kryesisht turqishten edhe serbishten gjuha e qytetit, qito kanë qenë. Këta ardhacakët kryesisht kanë qenë shqiptarë prej katuneve diçka, ata kanë fol shqip po për me u vendos edhe me u bo qytetar të Prizrenit edhe ata u dashtë me e mësu turqishten. Turqishtja edhe sot gati ka mbetë njifarë, si gjuha e kasabalive, prestigjioz. Për shembull, gjyshja nga ana e babës ajo ka pasë në mahallë do serbë, e ka ditë serbishten, po shqip s'ka ditë, ka marrë vesh pak po jo, turqisht po, e shqip s'ka ditë veç serbisht edhe turqisht. Qashtu.

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë qyteti në atë kohë?

Shkëlzen Maliqi: Qyteti ka qenë relativisht i pastërt. S'ka pasë shumë makina. Ajo shpija jonë ka qenë e gjyshit, aty ka jetu ky axha jem me familjen, ka qenë me ni pjesë qytetit aty përfundi gjimnazit ku është aty janë do rrugica diçka. Krejt ato rrugicat, atëherë në atë kohë çdo mëngjes kanë dalë e kanë pastru edhe oborrin e kalldrëmin e kështu, shumë i pastërt ka qenë kështu. Po shpija jonë te axha ka qenë e tipit shumë t'vjetër, m'duket se ata e kanë ndërto në fillim të shekullit XVIII dikund, sepse e ka pasë nifarë hajati⁴ t'madh në hyrje që gjatë mbulojave me do kashtë me, me... edhe mbi to qitshim ato qysh i thojshin, çilimat, e do sene.

E mandej ka pasë si shkallë n'dy anët, hypshe me disa shkallë e dhomat kanë qenë pak si ma t'nalta, ma të ngrituna, shumë interesant. Edhe aty në atë pjesën kanë qenë mutfakët⁵ e kështu. Aty hahej edhe buka. Shpesh e... kur ka pasë naj mysafir atëherë në dhoma të mysafirëve, disa dhoma kanë qenë atëherë. Ato dhomat kanë qenë interesante, orientale orenditë, me ato farë dollapet n'mure e me qato farë gjygyra si ato farë t'bakrit kryesisht kanë qenë ato.

Kaltrina Krasniqi: E ju qysh jetojshit, a jetojshi krejt në dhoma krejt bashkë a qysh?

Shkëlzen Maliqi: Jo, ne s'kemi jetu aty.

Kaltrina Krasniqi: Aha kjo ka qenë e gjyshit?

⁴ Shesh i shtruar dhe i mbuluar para ose pas portës a pas derës së hyrjes.

⁵ Nga gjuha turke - Kuzhinë

Shkëlzen Maliqi: E gjyshes, e axhës po shpesh kam nejt unë atje shkojshim si mysafirë. Baba jem ka pasë qisi zgadalime me njerëz se s'i jepshin banesa. N'fillim kem pasë është nifarë rrugë "Saraj bogaz" ajo që shkon te "Famipa" e knej. Aty dikund ni shpi kish mbetë bosh dikush që ka ik prej këtyneve që kanë qenë me, çka po di, a ballista diçka kshtu. Q'atë shpi e kem pas. Aty kemi nja dy-tri vjet, '54-shin kur ka lind vëllau kem jetu edhe ajo shpi ka qenë shumë interesante e ka pasë oborrin e madh t'gjatë, prej qatyt hit kam shumë kujtime. Kështu si ajo ka qenë dikun bile parashkollore, m' duket se qatëherë pata nisë me shku në parashkollore. Shkojsha te një shkollë aty afër që është në Papaz Çarshi i thojnë, ku është ajo farë shëtitore e Prizrenit, shadërvani kur hyp naltë është Papaz Çarshi në turisqst do të thotë Çarshia e Papazve e Popave se aty është Kisha Katolike, ma poshtë është edhe Kisha Ortodokse e aty është shkolla neve e qujshim atëherë "Bajram Curri" se gjatë luftës qashtu e ka pasë e na majke emrin m' duket ka qenë, s'di ni emen tjetër e ka pasë, po qaty është te mahalla e katolikëve është. Aty edhe une kam kry shkollën e ultë.

Aty ka qenë interesant se deri në klasën e katërt në shqip kam shku në shkollë, po atëherë një msus i jemi, Xhon Uroshi, e ka pasë emrin i ka thanë babës tem, "Këtë djalin e ki shumë t'zgjut. Pse s'po e çon prej klasës t'pestë në serbisht sigurisht ka me shku edhe në fakultet e diçka dhe le t'përgaditet kështu" Ai s'di pse, çka e ka bind babën tem, çka po di, edhe ka fol pak me mu, "A kishe shku?" Unë e disha, e disha serbishtën, por jo edhe aq mirë, "Mirë, OK". Njëmbëdhjetë vjet i kam pasë, njëfarë rezistence se kom asi, nuk kisha kurfarë paragjykime, kom pas edhe shokë serbë aty në banesë. Banesën e kam pasë aty te ura, jo e gurit po pak ma poshtë aty ku mbahen ato çelsat e fatit e diçka aty s'ka qenë ura hiç. S'di e ka pasë mar nihere uji edhe ka pasë mbetë shumë kohë vetëm me ato shtyllat, ato farë...

Kaltrina Krasniqi: Drrasa?

Shkëlzen Maliqi: As drrasa s'ka pasë (qesh). Po mandej e patën ndreq, e kjo është tash ma vonë e kanë ndreq qysh është tash e bash qaty njona prej banesave t'para kolektive, e ngritun, a din. Aty e kem pasë banesën, shkollën hypsha nalt asaj rrugës ku janë bash ato hotelet e senet...

Kaltrina Krasniqi: Edhe ia nise me shku n'shkollë serbisht, qysh ke ajo?

Shkëlzen Maliqi: Serbisht, po. Ajo ka qenë njëfarë pak... nuk ka qenë lehtë se ndonjëherë ose një fjalë e shqiptojsha pak si keq, ata më keshnin, nuk ka qenë fort përvoja e mirë, po kalojke. Po vetëm që ma vonë gjatë shkollimit pak jam largu prej... a din jom fut me ni botë krejt tjetër, gjuha e sene, shoqnia. Mandej, fakti që çdo dy-tre vjet jemi bart prej ni vendi në vendin tjetër kurrë s'kam zanë najfarë shoqnie tamam a din, që me pasë shoktë e mi. Unë kam t'njofshëm e kështu, po shumë pak më kanë mbetë asi shokë që njeri kur t'rritet shtatë, tetë vjet me shku me ni shkollë i ka shoktë e klasës. Unë i kam pasë do në Prishtinë, do atje, edhe kështu. As gjimnazin s'e kam bo si duhet, po serbisht pata shku n'shkollë. Mandej e mësova mirë gjuhën, se s'osht' problem me e mësu a din, se i vogël. Edhe për me lexu libra e sene shumë ma tepër ke pasë atëherë në serbisht se në shqip. Po shqipen e kom ditë ashtu të shpisë, hala e kemi fol atë gegnishtën, variantin tonë, po mandej e kom pasë pak njëfarë problemi me këto edhe ashtu unë jam pak i tërhjekun po u bona edhe ma shumë, a din. Unë jam introvert kam qenë gjithmonë edhe si i vogël. Edhe...

Kaltrina Krasniqi: E kujtimet për Prishtinën... se po m'intereson qysh po i ke pasë krahasimet?

Shkëlzen Maliqi: Prishtina s'më ka pëlqy. Në Prishtinë kam qenë edhe si shumë i ri, këto kujtimet e para nuk më kujtohen ato të '53-shit ose edhe ma herët, të '40-tave se edhe atëherë kem qenë ka fundi i '40-tave, po para.... Ata m'tregojnë se para, se kem shku në Mitrovicë kemi qenë në Prishtinë bash aty ku është "ABC"-ja e madhe, bile atëherë në atë kohë u ndërtu. Edhe tregojnë njerëzit që pata ra me një farë grope t'gëlqerës edhe menxi më kanë shpëtu. A din, kom qenë krejt i vogël. Ato janë vetëm me të ndigjume, ato nuk m'kujtohen, sigurisht i kam pasë nja dy vjet, dy vjet e gjysë, tre. Atëherë në atë kohë rrallë kujtohesh, qashtu. A prej klasës së parë a diçka, kur i kom bo shtatë-tetë vjet, ato më kujtohen shumë mirë edhe shkolla "Vuk Karadžić" atëherë që kam qenë edhe krejt. Kam banu aty ku është ajo ndërtesa të "Swiss Diamondi" që është ngjit kështu, qaty kam banu njo dy vjet prej atje m'kujtohet për shembull Agim Zatriqi e kemi pasë kojshi, e kështu.

Prishtina ka qenë relativisht e vogël. Aty te "Grandi" praktikisht mbarojke qyteti. Ku është tash Universiteti, kampusi Universitar ka qenë ushtria, Rektorati ka qenë selia e ushtrisë edhe aty kanë qenë do baraka do sene ajo zonë. Ka pasë diçka te Posta e Re andej do ndërtesa do sene po larg kanë qenë ato. Aty ku është tash "Rilindja" qaty pari, ndërtesa e "Rilindjes" madhe aty dikur ka qenë hipodromi fundi i qytetit. Knej këtu te Dragodani s'ka pasë kurgjo edhe u majshin garat e motoçikletave kështu si nëpër baltë, ka qenë interesant, krejt qyteti u mbledhke me i pa. Ma vonë ka fundi i '50-tave '60-tave kanë nisë me i ndërtu ato shpijat e sene edhe si zakonisht e kanë bo katastrofë pa naj plan, këto rrugicat e ngushta e kështu e qashtu, ka qenë shumë i vogël.

Kaltrina Krasniqi: E qyteti i vjetër?

Shkëlzen Maliqi: E qyteti i vjetër ka qenë interesant. Unë nuk e kam... nuk më kujtohet kjo tash ku është Kuvendi, thojnë që ka qenë nifare si Kapali Çarshi e Prishtinës, ndoshta e dyta në Ballkan për shkak të madhësisë. Ato m'doket kur kam jetu unë këtu qeshtu në kohën kur unë mbaj në mend, nuk më kujtohet se ka ekzistiu ose se e kanë nisë me ndërtu këtë Kuvendin. Vetëm më kujtohet se ka qenë ajo prej "Unionit", ku është tash "Unioni" përballë ka qenë ni rrugicë e vogël, qaty ka qenë korzë e parë dhe aty kanë qenë do dugoja, do sene, edhe aty poshtë ku është Posta e Re aty ka qenë nifare i thojshin *NAMA*, *Narodni Magazin*, a din Magazina Popullore, e qaty ka qenë njifare dugoje e madhe gjithçka aty blejshe. Aty e di që kom shku shpesh. Edhe ajo deri vonë ka qenë qajo rrugica kryesore, përballë goxha nifare si shesh i vogël mbrapa asaj rrugice, nga ana ku është tash kjo shtëpia e mallrave Gjermia aty ka qenë një bashqe e madhe. Verës aty u mbajshin, ka qenë si ni kafe me pi birra e me qesi sene një kështu (qesh), kafe verore. Aty afër diku ka qenë edhe një teatër, teatër për fëmijë, një sallë ato sene nuk ekzistojnë ma aty. Nihere i kam pasë lyp... Malon Lami ka pasë qenë aktor i Shqipnisë që ka pasë mbetë këtu diçka mbajke qitu kurse edhe grupin për teatër për të ri...

Kaltrina Krasniqi: Ku ka qenë ky teatër sakt?

Shkëlzen Maliqi: Bash qaty ku është Gjermia ose pak ma poshtë, qekjo zona. Noshta, qaty ku e keni ju atë "Dit' e Nat'in". Aty pari dikun. Tash ajo zonë u shkatërru krejt, janë ndërtu ndërtesat e reja "Bankosi" e tash qeveria ku është e këto, po aty pari ka qenë krejt ato. Po ato shtëpitë kanë qenë t'vogla një katëshe, dy katëshe edhe nuk ka nxanë shumë... Malon Lami m'pat marrë në atë shfaqje po pak u dëshprova shumë se veç ma kanë bo nifare kostumi të lepurit, veç njijherë kam kalu nëpër skenë edhe kam dalë (qeshë) e kështu. E humba mandej ambiciet me u bo aktor. Po, jo mirë, veç po boj

hajgare se si fëmija në atë... i shisha tjetërë qysh po lujnë po unë kam qenë shumë i vogël e ata pak ma t'mdhaj.

E mandej nuk më nxijke veni, se sa ia nissha diçka shkojsha me familjen me jetu në Prizren, se veç ni vjet kam pasë kry këtu qatëherë e kështu. Tash Prishtina ka qenë e vogël, knej verës ka qenë interesante. Këto ku është stadioni edhe atëherë ka ekzistuar. Kanë qenë këto dy lumejt u bashkojshin diku qaty te stadiumi edhe... Jo, as stadioni s'ka ekzistuar aty, po neve andej ka qenë si nifare moqali sene edhe aty shkojshim me lujtë, e si shkojshim pak ma nalt, kjo pjesa tjetër që po bohet tash Prishtina e re, atëherë knej ka Dragodani. Aty kanë qenë do... do kopshte me kumbulla diçka shkojshim si fëmijë me mbledhë ato kumbulla, jo gjenerike, po ato tjerat kumbullat e mdhaja t'kaltërta e qishtu qesi farë sene si fëmijë sherr bojshim.

Qikjo rruga, atëherë e "Beogradit" ka qenë se tash është "Fehmi Agani" ajo qaty dikun mbarojke dikun meniherë, s'ka pasë ma qytet, a din. Kështu ka qenë, kryesisht ka qenë Prishtina si nifare *kasaba* [turqisht - qytezë], po qatëherë ia nisi me u rregullu qendra, rruga kryesore u bo qatëherë u pasë bo. Unë kam pasë banu atëherë për së dyti kur erdhëm këtu me jetu, n'shkollë fillore kam qenë, kom qenë te ajo ndërtesa përballë "Sëiss Diamond"-it, që osht'. Poshtë i ka pasë zyret "Ramiz Sadiku" neve banojshim diku "Ramiz Sadiku" ndërmarrjen ndërtimore, deri vonë i ka pasë poshtë zyret. Unë në katin e tretë kam banu.

Kaltrina Krasniqi: Edhe libraria ka qenë?

Shkëlzen Maliqi: Libraria ka qenë poshtë edhe "Varteksi" dhe libraria andej dhe "Varteksi" ka qenë n'qosh ashtu. Prishtina ka qenë qytet i vogël. N'qendër nisi pak fundi i '50-tave, '60-tave me pasë edhe trafika, autobusa n'rrugë edhe korza u bo u bart aty. Kur u ndërtun krejt qito banesat e '50-tave qito farë "Tregtia", "Jedinstvo", ka qenë aty "Rilindja" atëherë ka qenë knej te muzeu ku është tash gjykata aty ka qenë "Rilindja", bash kur shkojsha n'shkollë kalojsha aty te "Rilindja". N'shkollë prapë kam shku prej klasës t'pestë deri n'tetën në "Vuk Karadžić" ose "Elena Gjika" po serbisht, qito janë ato.

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë ndryshe me shku serbisht në shkollë në Prishtinë prej Prizrenit a jo?

Shkëlzen Maliqi: Paj, jo, a din s'ka qenë ndonji dallim tepër i madh po pak jam rritë atëherë lexojsha kësi farë libra e sene.

Kaltrina Krasniqi: Çka lexojshë?

Shkëlzen Maliqi: Po lexojsha gjithçka edhe çka duhet për shkollë, po lexojsha edhe ato krimi romanet që dilshin një herë n'javë nifare, "Lun", "Kralj", "Ponoć", e kështu krejt serbisht kanë qenë. Edhe stripa, stripa kam lexu shumë në atë kohë. Edhe këto gazetat për t'ri edhe për rini "Plavi Vjesnik" i Zagrebit ka qenë shumë më e bukur se kjo "Politikin Zabavnik", ma i bukur në kuptimin, a din, i dizajnum ndryshe kështu. A "Politikin Zabavnik" ka pasë shumë informata e sene, por ma shumë m'pëlqejke "Plavi Vjesnik" se ka pasë ato nifare stripin kryesor *Flash Gordon*, si me anije kozmike me kësi sene, pak ma futuriste e ato. A te, te, te këta "Politikin Zabavnik" më duket, nëse nuk gabohem ka qenë, për shembull, *Princ Valianti*, a diçka edhe këto të Disney që janë këto Micky Mouse, Paja Patak që i thojnë Donald Duck-u e kështu.

Interesant te na s'ka pasë shumë stripe e kështu, "Pioneri" m'kujtohet edhe "Pioneri" i viteve t'para ka qenë ashtu njifarë modeli mjaft primitiv. Jam befasu kur jom kthy këtu në të '80-tat me jetu këtu prapë prej Beogradit, kishte mbetë njejtë me shumë pak ndryshime asnji... ama ato kur vishin gazetatat... se ata vishin me vonesë gazetatat prej Beogradit me makina me sene kah ora 10:00-11:00, në Prizren edhe ma vonë. Atë ditë pritshim a din rend me ardhë ni "Plavi Vjesniku" apo "Zabavniku" me pasë çka me lexu.

Kaltrina Krasniqi: Ku i blejshi në librari a në kioska?

Shkëlzen Maliqi: Në kioska, në kioska, në kioska s'ka pas në librari ka pasë por n'kioska. Këto që tregova për s'i kam lexu atje lexojsha i pata parapagu edhe kështu ato merrsha prej Novi Sadit, "Lun", "Kralj" "Ponoć" e këto. Ato kom lexu shumë e nana m'i heke s'më lejke me lexu a din.

Kaltrina Krasniqi: Pse?

Shkëlzen Maliqi: Paj, kishe shumë po lexoj sytë të prishen e kësi sene. Mu m'u patën prish pak sytë, i bajsha syzat e ajo m'thojke, "Mos lexo!" Po e kisha marr baterinë e nër jorgan lexojsha tinza qashtu. Ato i lexojsha për një në ditë, si këto romanet. E ajo është nifarë leximi që është zbatimëse e kështu, po për me përvetësu gjuhën e kështu ka qenë shumë e dobishme. E kam lexu *serious stuff* [Eng: gjëra serioze], për shembull, në Prizren kur kam qenë n'vitin e parë e t'dytë t'gjimnazit n'bibliotekë i merrsha do libra edhe ato kam pasë nisë me i lexu do vepra filozofike që s'i kuptojsha gati kurgjo, po diqysh inati m'shtike me lexu Aristotelin ose Platonin e kështu i merrsha n'bibliotekë. Qatëherë kom pasë nisë me pasë pak nifarë... edhe lexojsha leterësi serioze. Në Prizren në vitin e parë, dytë të gjimnazit kam qenë në redaksi të asaj fletushkës që e botojshin gjimnazi a din, gjithë ka pasë ni herë në muj.

Kaltrina Krasniqi: Cili gjimnaz?

Shkëlzen Maliqi: Gjimnazi ka qenë... atëherë e ka pasë emrin "Jovanka Radivojević - Kica" një heroinë e Prizrenit kështu partizane, qaty ku është gjimnazi... ni gjimnaz Prizreni e ka pasë atëherë. Atëherë edhe bojshim ilustrime; i bojshim me nifarë sistemi me shapirograf edhe përkthejsha diçka. Ka qenë interesant se atëherë në Prizren unë këtu n'shkollë fillore kam mësu frangjisht n'shkollë, këtu te "Vuk Karadžić", këtu te asi... s'ka pasë atëherë anglisht, frangjisht edhe rusisht më duket, po kryesisht ka qenë frangjishtja. Atëherë pat nisë me hi anglishtja nëpër shkolla, s'ka pasë as profesora. Në Prizren kur shkova atje n'gjimnaz veç rusisht kishte, nuk kishte as anglisht, as frangjisht. Mandej, ia nisa me mësu rusisht. Rusishtja shumë ishte e afërt me sllavishten ma shumë e kuptojsha dhe patëm bo edhe njifarë... na patën lidhë ata me do farë do shkolla të Rusisë edhe bojshim korrespondencë me ta.

Kaltrina Krasniqi: Shkrujshit letra?

Shkëlzen Maliqi: Po, me letra a din. Unë e pata n'xanë ni shoqe të Odesës, atje në Ukrainë, ia di emrin edhe tash, Maria Vjolstova, edhe fotografitë i ndrojjshim me diçka ka qenë si nifarë rrumbullaki.

Kaltrina Krasniqi: E çka i shkrujshit?

Shkëlzen Maliqi: Çka po di, çka kena mujt me shkru. Po mu m'u mërzi shpejt se nuk ishte asi nja, dy, tre herë i kam shkru, po lexojsha une pak rusisht a di kështu. Kur erdha këtu në Prishtinë nuk kishte

rusisht, po m'vike mirë a din, këtu kishte anglisht në gjimnaz. Edhe unë në fund t'vitit e jepsha si provim a din.

Kaltrina Krasniqi: E në cilin gjimnaz keni shku ktu?

Shkëlzen Maliqi: Te "Ivo Llolla" ka qenë atëherë kjo "Sami Frashëri" sot.

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë i vetmi gjimnaz a ka pasë edhe tjetër?

Shkëlzen Maliqi: M'doket ka qenë i vetmi, ma vonë është qelë kjo tjetra s'ka pasë atëherë... qyteti ma i vogël ka qenë, s'ka qenë aq i madh atëherë. '63-'64 kam qenë këtu në gjimnaz.

Kaltrina Krasniqi: Edhe gjimnazi t'ra me shku pak në Prizren pak këtu?

Shkëlzen Maliqi: Po de, dy vjet në Prizren, dy vjet këtu. E këtu nuk kisha... kur ishte ora e frangjishtës asi, po... kur mësojshin ata anglisht unë dilsha, e në fund t'vitit e jepsha rusisht nifarë si provimi, po rusishten e kam ditë me e lexu por jo me e fol kurrë ashtu. Edhe ma vonë kam lexu mjaft se osht' shumë e afërt me... gjuhë sllave është ajo, e qishtu. Çka tjetër po ju intereson?

Kaltrina Krasniqi: Qikjo pjesa... qekjo periudha e gjimnazit.

Shkëlzen Maliqi: E gjimnazin... n'gjimnaz veç jam konë pak ma i pjekun dhe ia pata nisë edhe me shkrujt poezi. E kam pasë në Prizren ato dy vjet e para ni shok pak ma i vjetër ka qenë se unë, Adem Zaplluzha, poet është ka botu shumë libra. Edhe tash kur i boton, i boton nga katër, pesë në vjet ndonjëherë. Por simpatik ka qenë edhe bokser ka qenë shumë i fortë kështu. E pata me to nifarë muhabeti, gjithë e kom pasë, edhe niherë i pata tregu do vjerrsha t'mia që i pata bo, serbisht shkrujsha atëherë dhe ato i pëlqenin, "Oh shumë janë t'mira..." a din kështu.

Kryesisht isha i ndikun prej Jesenjinit e qesi do farë poetëve që i kom lexu, por i kom lexu do sene tjera. Edhe Mayakovskin e kom pas lexu e pata gjet atëherë nifarë artikulli, qatëherë që kam qenë gjimnazist, s'di ku m'duket ndoshta në Prizren, ku ai spjegojke, jepke këshilla për poetët e rinj, për ritmikën e kështu edhe poezia e tij m'pëlqejke në përkthime në serbisht e kështu edhe. Atëherë mendojsha që kom me u bo poet ma vonë a din, edhe shkrujsha shumë poezi. Do poezi hala i ruj, janë mjaft t'mira, serbisht i pata shkrujt. Ma vonë i kam përkthi edhe ato po kurrë s'i kam botu, veç ma vonë i kam botu njo dy qisi kot t'vonshme. Edhe qaty, kom pasë qasi mendime, m'kanë pelqy kështu edheartet figurative.

Këtu në shkollën filllore e kom pasë njifarë profesori, ia kom harru emrin, ai në orën e vizatimit të arteve figurative... edhe atij i pëlqejke unë çka bojsha edhe m'jepte do detyra unë me bo kopje do veprave kështu, "Jo kqyre qito bone si ky", e ato ishin pak t'vështira me ia bo, a din, sipas dëshirës tina. E une provojsha me qenë si ajo, po nuk dilke bash mirë, po a din, tani thojke, "Jo nuk e ke bo mirë" (qesh). Ama ishin ato skenat e komplikume, najfarë oborri me pula me shumë detale që s'po di. Ama mu m'kanë tërheq gjithë artet figurative e kështu. Kam pasë do libra qisi me *slika*, me fotografi edhe lexojsha shumë sene. M'ka interesu, sidomos në atë kohë edhe në Prizren edhe në Prishtinë, m'ka interesu kjo çka ka ndodhë me stalinizmin, me... pse janë nda ata komunistët jugosllav prej atje, ndikimi i ideologjive në shkolla ka qenë gati direkt, a din, na kanë indoktrinu.

Kaltrina Krasniqi: Spjegoma qysh ka ndodhë qikjo?

Shkëlzen Maliqi: Po ajo normale se s'e din... nuk ke kundër, nuk kanë qenë kontekstet ti me mendu në mënyrë kritike. Plus unë kam ardhë nga familja që kanë qenë nga dy anë kanë qenë komunista përparimtarë e kështu, nuk e kemi, nuk e kemi mendu... s'ke pasë alternativa çka me mendu, po qeshtu. Kemi pasë ato orët e indoktrinimit, s'kanë qenë edhe ashtu të them të vrazhda, po çka po di vet atmosfera në shkolla nëpër festa sene ta ka imponu si njifarë... Mu m'kanë bo përshtypje shumë qito festat e viteve të '50-ta që janë bo në Prizren, sidomos këto nuk kanë qenë të atilla ose këtu ma vonë. Për shembull, kur ishin festat a 1 maji apo ndonjë tjetër, u bojshin si njifarë, ata i thoshin, baklada, domethanë i bojshin flakadanët. Krejt nxanësit prej kutijave të konzervave, aty e qitshin pak si naftë a diçka edhe atë farë fitilin edhe i ngjitshin për ni shtagë edhe flakadane shkojshim.

Mandej, qashtu kanë festu edhe fashistat edhe këta se ka qenë njifarë rituali i... A neve na pëlqejke të rinjve me shku nëpër qytete, në Prizren e kështu, prej Papas Çarshisë ose knej edhe i gjujshim ata n'lum edhe lumi merrke flakë ni kohë a din, interesant u doke pak tim e dishka. Qasi farë senesh. Plus ato fjalimet, e kur vike shtafeta e Titos u bojke nami ose u mbajshin ato gjatë pranverës përgaditjet për këto, atëherë i thojshin slet, kanë qenë si manifestime ku në stadium u mledhke publika krejt edhe bojshin do me muzikë për nder të Titos, për nder të partisë qashtu kanë qenë do aktivitete.

Pjesa e Dytë

Kaltrina Krasniqi: Para se me hi n'këtë fazën e studimeve edhe vendimit tond për me shku në Beograd kisha pasë qef veç me ditë qysh ka qenë atmosfera në shtëpi? Ti ke pasë motra, ke pasë vëlla, e ke pasë nanën? Çfare ka qenë qajo jeta familjare diqysh?

Shkëlzen Maliqi: Po ka qenë, t'them ashtu, tipike pak si për familjet shqiptare, pak ma e avancume ose ma përparimtare. Po kështu, nana ime ka qenë shtëpikë, nuk ka vazhdu shkollën ose menjherë mas lufte gjithë i bibe pishman, a din, se të gjitha ato shoqet e saja... por ajo herët ka lindë fëmijët e kështu, edhe qysh është bajtë prej një vendi tjetër edhe nuk ka mbërri me kry shkollën. Dike pak me lexu, por edhe ata që e ka mësu e ka harru, a din. Po kështu ka qenë shumë intelegjente dhe... por ka pasë do siklete t'veta bash për qato që s'osht' realizu, me nerva e me sene, e qishtu.

Baba ka qenë si tipik baba shqiptaro-autoritet (qeshë), autoritet i pakontestushëm. Po në të vërtetë nuk e ka apliku por qishtu njëfarë... vetë familja, vetë ambienti ta krijon ato si, "Nëse e merr vesh baba..." A din kështu. Une me to në të vërtetë kurrë s'kom pasë... shumë rrallë kom pasë ndonjë, a din, kur bojsha naj sherr a diçka ma t'madh, disa herë m'ka bërřitë e kështu. Por ai vet ka qenë si jetim qe u rritë, a din, edhe... ka qenë ma asi, nuk ka qenë aq i ashpër ose si me tregu atë pushtetin e vet. Edhe s'ka pasë shumë kohë, tanë kohën ka qenë nëpër puna, nëpër sene. Unë si fëmijë e mbaj n'mend, njifarë, ndoshta m'ka respektu ma shumë se tjerët. Por...

Kaltrina Krasniqi: E me motrat e me vëllaun?

Shkëlzen Maliqi: Me motrat, me vëllaznit krejt në rregull. Por vetë, unë vetë kom qenë pak i mbyllur gjithmonë, edhe kur kom... kanë pasë nisë me m'pengu manej qito ritualet e tepërta shqiptare. Edhe në Prizren edhe në... në Prizren sidomos. Si fëmijë atëherë nuk i vëren shumë, a din, se si fëmijë ty nuk t'shtin aq shumë n'atë lojë. Por për shembull kur shkojshim musafir në Prizren te hallat, te tezet, kudo që shkojshim, atje është njëfarë ceremonie e përshëndetjeve e tmerrshme. Kur nisin me pytë, a din, me rend, a din, nëse jemi dhjetë musafir edhe dhjetë t'shpisë atje ata, "Si është filani? Si është filani? Si është vëllau? Si është ky?" Edhe tani ai tjetri rend qashtu. Mu ato formalitete m'u dokshin edhe t'tepërta, edhe, a din, edhe n'përgjithësi.

Mandej, qyteti... në Prizren, kom pasë nisë edhe si gjimnazist, ato dy vitet e para me ndi këtë presionin, se a din kur... baba im ka qenë atje pushtet, ndër pesë-gjashtë ma t'randësishmit t'qytetit, edhe si sekretar i partisë ose si kryetar i rrethit edhe i qytetit ka qenë, si thojshin ata, *Bog i Batina* [Zot dhe Shuplakë] në serbisht (qeshë) domethanë krejt iu kanë frikësu. Edhe mu meniherë m'shtishin do sene që e disha që e bojnë për babën teme dhe jo për mu, a din, kështu për shembull, që m'bojshin presion me shku n'do kurse t'partisë diçka, si parapërgaditje, si shkollë, çka po di politike qaty në Prizren kur kom qenë edhe pata shku disa herë po mandej u mërzitsha kisha qef vet me lexu, vet me mësu, vet me asi... Nuk, edhe ishin atje si njëfarë... shkolla nuk m'pëlqejke hiç kurrë, shkolla si shkollë, sa ma shumë jom rrit ma pak m'ka pëlqy a din, ato me t'pyt e me... Sistemi ka qenë i tillë që t'mytke, nuk m'ka pëlqy shkolla bile dojsha me e lanë, po atëherë nuk kisha pak si zgjedhje. Qito farë provime e sene kur t'thirrshin me t'pyt e s'po di...

A me shkrujt kom ditë gjithë mirë edhe merrsha nota t'mira me shkrim, a me gojë disi si pritojsha me fol, edhe çka po di, unë n'vërtetë kështu kam qenë edhe i gjallë edhe me shoqni edhe çka kam lujt futboll në atë kohë derisa nuk nisa me mbajt syza pak nuk mujsha bash me qenë si duhet edhe basket edhe ksi sene... Në Prizren shoqnia rrugës ka qenë ma interesante se kjo. Si i vogël patën dashtë me m'çu n'skollë t'muzikës, violinë, a diçka, m'vike marre prej shokve rrugës me shku me ia nisë (qesh). I kam pasë qisi farë kopuka⁶ (qesh)që ata i përqeshnin ata, "A qy, qy", edhe, "Jo, s'du une". Kjo është një send, i vetmi send që ma vonë e kam, a din, m'ka ardhë keq që s'e kam mësu atë farë muzikën me nota me sene nashta m'kish vyjt.

S'di a jam muzikal a jo, por mendoj se mirë kish qenë me e ditë me e lexu muziken si duhet. Kështu m'pëlqen, po jo si dikujt tjetër, a din, muzika. Muzika mandej edhe gjatë edhe si, kur vetën e kam konsideru poet m'pengojke, se n'mëngjes me nisë me e ndëgju muziken tani tanë ditën t'u sillke nëpër mend. M'pengojke, a din, ma hupke ritmin e tem që e kam t'brendshëm, njëfarë, ama kështu muzika gjithë është imponuese a din, t'merr me veti. Çka deshte tjetër me t'thanë?

E për, kryesisht, mandej nisë, osht' mentaliteti aq primitiv që mu edhe kështu ata t'afërtit t'familjes edhe njerëzit n'rrugë më nalshin, "Ej ti pse po i mban floktë e gjata, a e din djali i kujt je? E kështu, ashtu" Më bezdisshin kështu çka po di. Nuk... shumë provinciale ka qenë atë kohë Prizreni edhe Prishtina, gati jo ma mirë por pak ma ashtu, edhe ma n'moshë kam qenë, e Prizreni me këto sene pak ma konservativ ka qenë edhe sot ka mbetë qashtu po m'duket në këtë aspekt.

Kaltrina Krasniqi: Qysh vendose me shku në Beograd?

⁶ Mistrec

Shkëlzen Maliqi: Po u dashtë diçka me studiu edhe këtu nuk kishte ndonjë zgjedhje. Po patën ardhë disa fakultete 1966-tën. Këtu s’ka pasë, ka pas ndërtimtaria a diçka, krejt kanë qenë degtë e fakultetit atje ka pasë gjuhë, letërsi e qisi sene histori m’doket, po nuk ishte. Po ishte normale me shku në Beograd, s’kishe ku tjetër, çka ka qenë në pyetje, çka? A din, po une kisha pasë disa variante kom pasë ose letërsi ose filozofi edhe atëherë vendosa për filozofi. Edhe arte kam mendu pak, po aty ishte përgaditje e sene pak ma specifike edhe thashë okej filozofia si pak ma e gjanë edhe pata nisë me lexu atëherë mjaft do sene edhe temën që e kam pasë, temën e maturës, ka qenë “Kafka dhe Kama” për ekzistencializmin e kam pasë.

Kafka është kryesisht shkrimtar po te Kama ki edhe këto veprat filozofike, “Mitin e Sizifit”, ato krejt i kam lexu. Edhe e pata bo ni shkrim qashtu 66 faqe se nuk është e zakonshme se 15-20 faqe i bojshin tjerët, po qashtu tu lexu anej knej, interesant ka qenë e kam hup atë shkrim. Nuk ka qenë diçka top, po ma patën vlerësu mirë atëherë profesorët. Edhe shkrujsha une, ato, kur i shkrujsha këto hartimet që i bojshim atëherë serbisht normal, atë mësuesen që e kam pasë ka qenë e filozofisë ajo lexojke n’krejt shkollën këtu në Prishtinë, për shembull, kishe edhe m’çojshin në ato garat a din? Garat e qytetit. E diçka njiherë pata shku në dom, aty në Shtëpinë e Armatës, njifarë gare e pata fitu m’duket shpërblimin e dytë, po ata thojshin, “I joti ka qenë krejt ma i miri, po, a din...” Kisha shkrujt diçka për Frojдин edhe marksizmin, a din (qeshë), diçka e kisha përzi dhe ajo profesoresha mandej e kish lexu në krejt shkollën. Qashtu m’u pat’ rrit nami që shkruj mirë, a din.

Edhe kam lexu mjaft, se leximi është baza e jetës për gjithçka, literatura... Si gjimnazist kam lexu, për shembull, edhe këto, i lexojsha revistat kulturore ma të avancume të kohës “Oko” e Zagrebit pat’ qenë si diçka edhe “Književne Novine” e Beogradit edhe do qesi farë, edhe do revista ato i gjejsa edhe nëpër kiosqe këtu. Ato i lexojsha, leterësi, poezi, ese. M’interesojshe atëherë shumë budizmi edhe zen budizmi edhe kjo farë filozofia e jetës, se njeriu e ndërton vetën si ni vepër, a din, edhe Sartri e këto i kam gjetë se njeriu është vet projekt po, a din qysh, atëherë në ato kohëna kaniherë ki edhe do mendime ksi farë edhe pesimiste edhe kështu. Ballafaqimi me vdekjen është shumë traumatik te t’ritë që nuk munesh me e kuptu se jeta sa po jeton krejt mirë por një ditë ki me vdek edhe jeta s’ka kuptim e kështu njifarë, edhe disi i kem kalu ato.

Kaltrina Kelmendi: Edhe mandej shkove në Beograd prej Prishtinës dhe Prizrenit?

Shkëlzen Maliqi: Prej Prishtinës jam nisë, po prej Prishtinës e në Prizren gjithë i kam pasë lidhjet edhe këtu po kam nejt, kam qenë në klasën e tretë, t’katërt, çdo vikend shkojsa në Prizren atje e kam pasë shoqinë ma t’mirë lujshim futboll ose najsen tjetër kshtu. Po këtu jam përgadit për asi... për... filmin e kam përcjellë shumë, se kam harru ni pjesë është shumë e rëndësishme, filmin prej Prizrenit. Se prej vitit, atje, ‘56-‘57 kur kem banu aty te ajo ndërtesa e re në Prizren ajo është afër kinemasë, tash Lumbardhi ku është, e aty në atë kinema ka qenë ni djalë i axhes i babes tem drejtor, Shefki Gështenja, qishtu e ka pasë emrin edhe ashtu që isha aty çdo ditë.

Kaltrina Krasniqi: Çka kqyrshë?

Shkëlzen Maliqi: Krejt filmat i kqyrsha.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë filma vishin?

Shkëlzen Maliqi: Po krejt çka kanë ardhë n’rend edhe serioz edhe ma shumë na pëlqejshin këta Westernat, kaubojsat, po ka pasë edhe filma tjerë interesant. Po unë i kqyrsha edhe ata që kanë qenë t’ndalun për rininë (qeshë). Nifarë filmi ka qenë i famshëm Alan Moreau cullak dilke edhe qisi farë sene. Po i kqyrsha krejt filmat edhe... se qaty 50 metra prej shpisë kem pasë banu edhe e kisha hyrjen kështu pa pagesë, u bona si i shpisë aty edhe shumë filma kam kqyr. Mandej edhe në Prishtinë kam kqyr.

Kaltrina Krasniqi: N’cilat kinema kqyrshe në Prishtinë?

Shkëlzen Maliqi: Ma shumë te kjo kinemaja e vogël, te “ABC”-ja e vogël.

Kaltrina Krasniqi: Qysh e ka pasë emrin atëherë?

Shkëlzen Maliqi: Qysh e ka pasë... “Kino Rinia” ka qenë edhe...

Kaltrina Krasniqi: A osht’ “Kino Vllaznimi”?

Shkëlzen Maliqi: Noshta, s’po di tash kom harru. Këtu te qendra, se aty vishin filmat ma artistik. Atëherë kur kam qenë në Prishtinë vitin e tretë e t’katërt kqyrsha filma ma artistik franqezët, çekët e kështu. Ata nuk i lujshin shumë gjatë një ditë, dy se s’kishte publikë, a din. Unë iksha prej shkollës edhe i kqyrsha mos me i hup. Atëherë i kom përcjellë shumë, a knej te “Kino Rinia” e madhe kom pasë shku edhe si fillorist, kjo që ta përmenda atë heroinën Katerina Patronogiq Cica. Cica e thirrshim krejt, si mashkull ajo, e ai burri i vet nuk dojke me shku n’kinema, s’di pse, e gjithë m’thirrke mu, a din. Më huazojke prej, mos me shku vet n’kinema, lozhën e merrke ajo edhe aty kqyrshim filma; çdo film ajo e kqyrke edhe unë me to. E pata bo si shoqe, po ajo mandej në Beograd kom pasë ra n’konflikt me to kur patëm bo demonstratat e ‘68-tës, po të tregoj ma vonë.

Po qashtu a din, mirë. Filmat i kam përcjell edhe shkrimet për filmat edhe filmat jugosllav do që m’kanë pëlqy e kështu. Kosova hala s’ka pasë ndonjë film atëherë, kanë qenë qita që i bojshin si koproduksion me tema të Kosovës a din.

Kaltrina Krasniqi: Janë filma shumë t’hershëm t’viteve të ‘60-ta...

Shkëlzen Maliqi: Po t’viteve të ‘50-ta. Mandej kur u xhirojshin në Prizren, si fëmi atëherë shkojshim mas ekipeve e sene e qishtu pak.

Kaltrina Krasniqi: Në princip ata kanë qenë filmat ma propagandistik?

Shkëlzen Maliqi: Po kanë qenë ose me luftën ose me Luftën e Dytë Botërore me diçka. Në përgjithësi kanë dominu filmat e luftës propagandistik, ‘60-ave kanë pasë nisë këtu pak si.... Po qajo, domethanë, ka qenë viti, domethanë, kur jam regjistru 1966 ka qenë shumë nifarë viti interesant sepse atëherë pat’ ra Rankoviq dhe u bo nifarë komisioni me hetu atë çka kanë bo në Kosovë. Rankoviqi pak ma herët ka pasë ra, por atëherë ka qenë periudha kur u... baba jem ka qenë zëvendës kryetar i Komisionit për hetimin e krimeve ose vrasjeve krejt çka ka ndodh në ‘50-tave, ‘60-tave edhe në aksionin e mbledhjeve t’armëve, edhe në proceset si Procesi i Prizrenit, e kështu. Ku, a din, policia, shërbimet sekrete kanë bo represion edhe kanë pasë nja 70-80 vrasje si vdekje t’dyshimta ose vrasje që i ka bo policia që janë hetu.

Në atë vit u regjistrova në Beograd, verës shkova çka po di, u regjistrova, po ishte njëfarë periudhe kur këta t'familjes time u frikësojshin se këta, këta që kanë punu këtu te Shërbimet Sekrete në Kosovë, serbët që i kanë largu nga puna ata kanë shku i kanë strehu atje në Beograd. Edhe baba im ka pasë frikë prej revanshizmit, po m'i pat' dhanë ai qato, do dokumente me i lexu para se jam nisë unë në Beograd me e kqyr qat' raportin që e kanë pasë bo. Edhe atëherë edhe pat nisë me e ndryshu kursi, për, ndaj Kosovës n'krejt Jugosllavinë te Tito e knej, patën nisë me i fut këtu ato ndryshimet, thjeshtë une i kam pasë do...

Njiherë pata hup këtu, ni ditë shkova në vizitë te një familje ruse i kanë pasë. Rusët që kanë ikë prej Rosisë, atje mas revolucionit, atje mas, disa mijëra veta janë strehu në Jugosllavi. Një familje prej tyne ka qenë në Prizren edhe unë i kam njoftë prej Prizrenit. Ndonjëherë shkojsha në vizitë te ta se n'vitet... ata m'patën thirrë n'vërtetë një ditë. Një vajzë e tyne ka pasë bo vetëvrasje, vetëm qat' vajzë e ka pasë ajo familja, e pat' bo vetëvrasje, çka po di ka pasë qenë në një aferë. U dashuru me njëfarë shqiptari, çka ka ndodhë aty s'di, po ata dyshojshin që edhe kjo është njëfarë rasti i dyshimt edhe e kanë paraqit për hetime. E nashta ata me atë qëllim m'kanë thirrë mu, po unë edhe ashtu shkojsha ndonjëherë te ata.

Atë ditë kam pasë nejt te ata ma shumë, ma bonën nifare darke e sene edhe u vonova shumë n'shpi, s'jom paraqit deri në 12:00. Atëherë, s'kanë pasë telefon mobil me m'gjetë ku jom edhe janë shku te shoktë e mi që i kam pasë, nifare Zlatko e do tjerë, s'më kanë gjetë kërkund edhe veç kur jom ardhë ma vonë kah 12:00 në shtëpi ata ishin shashtrisë. E atëherë baba jem tha, "Kqyr kështu, kështu, kështu..." ia nisi me m'tregu çka po ndodhë edhe ai kishte frikën te familja se për veti ka qenë trim, a din (qeshë).

Edhe mandej dikur tha, "Lexoje këto ti ki me shku në Beograd. Ruju se nuk e din çfare janë ata!" E kështu e diçka. Po nuk ka qenë aq t'them ashtu, hala atmosfera, që ky nacionalizmi serb që edhe atëherë ka punu njëfarë dore natën, jo hapur. Se Jugosllavia i ka pasë dy politika, njëra ka qenë zyrtare emancipuese për shqiptarët që duhet me pasë shkolla e kështu, por natën prej '48-shit ka nisë kjo vija tjetër me thanë se shqiptarët janë element i pa sigurtë, nuk janë lojal, janë për bashkimin me Shqipërinë kundër Jugosllavisë, kundër Titos, e kësi sene. Edhe i kanë djegë kryesisht këta katunarët e shkretë, gjithçka çka që kanë bo, ato pak a shumë dihen.

Une për këto sene pak kom ndëgju edhe atëhere pak kom ditë edhe '50-ave ka qenë nifare periudhe, tash po kthehemi mbrapa po s'ka lidhje. '50-tave kur pat' nisë shpërngulja për Turqi, unë atëherë kam pasë, s'po di, tetë, nantë, dhjetë, njëmbëdhjetë vjet, e këta t'familjës patën nisë me shku, këta axha, edhe hallat me familje plus edhe do kusheri tjerë, t'nanës tem e dajtë e saj e kështu. Gjyshja jeme masi që, gjyshja e nanës, ka pasë shumë kusheri ajo çdo vit shkojke, a din.

Kaltrina Krasniqi: Në Turqi?

Shkëlzen Maliqi: Në Turqi me do paketa e sene, shkojke e u kthejke, me do dhurata e sene e kështu. E gjyshja tjetër ajo ka jetu me, domethanë me axhën tim se ai ka qenë vëllau i madh. Edhe ai ka pasë shku në Turqi atje jetojke. Po edhe këta shoktë e mi që i kam pasë të rrugës e kështu, gjatë vitit shkojshin dy, tre, katër, pesë po, çka po di. Atëherë nuk e kam kuptu krejt, a din, po ka pasë edhe raste se vishin edhe do kusheri kur i burgosshin ose diçka e disha që kanë diçka me nacionalizmin e ballistat, ka pas diçka burgosje e kështu, po nuk kam qenë i vetëdijshëm. Mu ma shumë m'interesojke

me e kuptu vet regjimin e stalinizmin, sidomos për ato kom lexu shumë libra, se baba jem e kishte bibliotekën e vet se kur ka studiu ka qenë në Beograd, ka ble do libra interesante kanë qenë edhe ato.

Të them një ide ka qenë, t'them ashtu, një fenomen i kultit të personalitetit, proceset e montuara, ato i kam pasë studiu kështu edhe njëfarë, a din qysh, krimi i dyshimit në komunizëm atëherë m'u ka paraqit po nuk e kom... se kam mendu që ka qenë njëfarë devijimi që tash mundet me u ndreq, a din. Edhe një temë tjetër që u hapke lidhur me këtë ka qenë Shqipnia. Shqipnia, që unë atje e kam pasë ni dajë hero komunist, ka ra n'luftë e kështu, po që në rrethin familjar sidomos te daja, djali i dajës që e kam pasë gati moshatar pak ma i ri se unë ka qenë Valboni, Valbon Stavileci, me ata shpesh e kem diskutu këta se, ky ka qenë njëri prej themeluesve të njërit prej atij grupit t'rinjëve në Partinë Komuniste të Shqipnisë kur u themelu.

Ky grup ka qenë kundër Enver Hoxhës që ai me u bo kryetar, mandej ai me një farë dore u hakmarrë e kështu. Megjithatë legjenda familjare tregojke se vërtetë Sadikun, dajën tem, e kanë menjanu nuk ia kanë dhanë rëndësinë sa duhet, pse ka qenë kosovar edhe kështu, se atëherë kam dëgju pak se ata kanë paragjyqime për kosovarët edhe prej gjyshës e po nuk i jepsha shumë rëndësi. Por, megjithatë njëfarë qëndrimi negativ për Enver Hoxhën e kem pasë edhe atëherë, sepse ashtu në familje flitej edhe prej propagandës ose prej materialeve që kam mujt me i lexu atëherë librave e sene. Tashti e disha që aty njëfarë regjimi stalinist, e kulti i personalitetit, e nuk e kam pasë fare njëfarë, t'them ashtu, qëndrimi pozitiv për atë lloj t'regjimit. Mendojsha që është fallco, se Titoja është pak ma liberal ose nuk ta ka ndalu me lexu libra e diçka, se ti mujshe me lexu shumë literaturë botërore ose me pa shumë sene që kanë qenë relativisht për ato kushte liberale.

Qeshtu që përgaditja jeme ka qenë kështu deri në 18-19 vjet shumë e hapur për botën edhe relativisht pak kom pasë, t'them ashtu, respekt ose afinitet për ato vlerat lokale ose... jo vetëm në kontekstin e Kosovës, por edhe në Jugosllavi shumë pak lexojsha autorë Jugosllav. Disa natyrisht i kom, m'u kanë imponu si Danilo Kishi ose kështu edhe disa prej atyne që llogariten si klasik Krležha ose... po edhe Andriqi do tregime, do sene edhe pse atëherë nuk e kam ditë që Andriqi ka pasë qisi farë. Ma vonë e kam kuptu në fund të '60-tave, '70-tave që ka qenë, ka bo disa laborate si... nëpunës i ministrisë të jashtme të Serbisë për shqiptarët që kanë qenë si, tejet negative gati si Çubriloviqi. Por, letërsinë e ka pasë shumë interesante edhe t'mirë edhe kështu. Po kryesisht lexojsha ose literaturën botërore që është përkthyer në atë kohë me shumicë bile edhe ato që janë si moderne ma avant-garde prej Joyce e...

Kaltrina Krasniqi: Becketi...

Shkëlzen Maliqi: Joyce, Becketi, Hemingway si stilist, ata e kam pasë adhuru edhe sot dhe e adhuroj shumë i mirë e qashtu... kjo ka qenë parapërgaditja ime se shumë herët kam lexu këto edhe kam pasë njëfarë dritare në letërsinë ose në mendimin botëror shumë herët. Ata... ka pasë ni lloj kanali selektiv edhe n'përcjelljen e mendimit botëror se edhe këto revistat e hapura dhe kryesisht theksin e kishin te... ose e përcjellshin ma shumë literaturën majtiste ose marksizmin kritik e kështu, po megjithatë ka qenë komplet ndryshe nga ajo marksizmi dogmatik ose... edhe në t'vërtetë në vet sistemin Jugosllav ka pasë oaza ku ende mbizotëronte ky farë dogmatizmi, a din. Po këto qysh janë ato *mainstream* [anglisht - rrymë qendrore] i publikimeve ma cilësore t'kohës ka qenë relativisht e hapun ose kritike ose i shtjellonte disa probleme. Plus në art dhe në kulturë kanë qenë disa tendenca që në t'vërtetë e

kritikonin vet realitetin e Jugosllavisë të asaj kohës në kuptimin e Shkollës të Zagrebit të Filozofisë ose të Filmit të Zi, qysh e shihnin ata *Crni Talas*, vala e zezë e filmit Jugosllav...

Kaltrina Krasniqi: Ata mandej janë burgosë...

Shkëlzen Maliqi: Disa janë burgosë, po ata pak ma vonë janë burgosë po edhe në '60-tat ka pasë qasi kur unë kam qenë gjimnazist, kanë nisë këto tendenca në letërsi, në film, në arte, e tjera.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka qenë e ndalume?

Shkëlzen Maliqi: E ndalune, ma vonë kur t'vijmë në vitet e '68-'69, ka qenë qajo farë disa filma janë ndalu edhe si ky filmi "*Plastični Isus*" i Lazar Stojanoviçit. Ato mandej do ta kem shok kur ka dal prej burgut, e kam njoftu e kam njoftë edhe kështu po s'kem qenë shok atëherë '68-tën, por kjo është storie e ma vonshme e Beogradit kur kam shku në Beograd në '66-tën në vjeshtë. E kur shkova në vjeshtë, thash kam shku pak si i përgaditun nga baba im, që duhet të kem kujdes se atje ka nifare reaksioni shumë ma t'fortë, qashtu ai e interpretojke. Nuk i pëlqejke atij që po studioj filozofinë, po nuk është përzi, "Vet e ke zgjedh..."

Kaltrina Krasniqi: Pse?

Shkëlzen Maliqi: Po ma vonë i kanë thanë këta shoktë e tij që janë në Beograd, këta me funksione kosovarët, çka po di, Ali Shukria e këta farë tjetër, se... ose Kolë Shiroka e këta që i ka pasë të Prizrenit si shok ata i kanë thanë se në Fakultetin Filozofik ku po regjistrohna është një grup profesorash që janë anti-Titisa, janë t'dyshimtë e kështu e qaty. Aty mandej ma vonë do t'bohët ni lloj, t'them ashtu, bërthame, prej ku ka nisë revolta e '68-tës, edhe kështu po kjo është një storie në vete a din, t'them ashtu.

Kur kam shku atje jam ballafaqu edhe mandej mas, për shembull mas një viti kur ne e patëm nis me '66-tën si pata mrii une në fakultet, demonstratat kundër Vietnamit e kështu. undër luftës në Vietnam kundër amerikanëve, atëherë pata, kur dolëm prej asaj sallës ku e majtëm këtë farë tubimin, aty na kanë prit policia pa pritë e pa kujtu, s'dishim folëm qaty kundër imperializmit e çka po di. Po në atë kohë Jugosllavia paska qenë në zor me e fitu njifare statusi të tregtisë t'libër me Amerikën që është një privilegj shumë i madh edhe regjimi si regjim policisë i ka thanë, "Mos të na bëjnë sherr me Amerikën", e kështu.

Si dolëm neve ata ishin vendos te Fakulteti Filologjik njifare dy, trolejbusa me e nda masën në dy pjesë a din, edhe unë qysh kam dalë aty instiktivisht në anën e djathtë as nuk kqyrsha, kur përnjëherë ata u largun prej meje. Kur përnjëherë p'e shoh një polic aty shlemin si gjerman (qeshë), tu ma mshu në kokë, ma ka bo ni gungë qikaq t'madhe {tregon me dorë}. Po mirë, nuk m'ra as t'fiktë as veç pak i pash ato yjet edhe u largova nuk më... Atje mandej i shifsha njanin nja pesë veta polictë tu e rrah ish rrëzu në tokë njani edhe e rreshin e kështu u bo njifare kaosi.

Unë ika me njifare rrugice qaty e mas asaj kem pasë luftu me ata policët nja pesë, gjashtë orë nëpër rrugë. Ka qenë si dimën, si akull borë m'doket ka pasë, i gjujshim i bojshim ato topat e borës si gurë edhe i gjujshim kah sytë i kishim lëndu {tregon me dorë} edhe ne ata edhe ata neve, qishtu. Për herë t'parë aty n'qat' rrugicë kur shkova ata dojshin me shku te, te... në rrugën Knez Mihajllova, në qendër që është ajo aty n'qosh, afër fakultetit tonë ka qenë ajo libraria amerikane "*Američka Čitaonica*", qysh i

thojnë si leximorja amerikane, libra t'bukur e krejt, po ata e kishin rrethu policët nuk lejshin. Aty për herë t'parë e patëm pa që kali nuk shkon te njeriu, a din, kur u afriu aime kali polictë me kali, ai kali kështu {shpjegon me gjeste ngjarjen}ai u çu edhe e rrëzoi atë policin. Edhe ni shoqe që ka qenë aty, për pak me e nxanë atë, asaj kurgjo s'i ndodhi.

Qashtu mandej patëm shku, u mblodhëm prapë studentat dikund tjetër, u bom grup e shkum te Ambasada Amerikane, nuk na lanë e qishtu nëpër qytet e, a din, demonstrata e parë e madhe që kam marrë pjesë. Ma vonë e patëm bo në fakultet aty një lëvizje si një grup që qishtu organizojshim demonstrata kundër... për raste t'ndryshme, për represione ndaj studentëve në Gjermani për Linduçkën kur e patën plagos e qasi për Nipista Dorakistin e patën burgos në Greqi, ai është nifarë kompozitori i famshëm. Bile unë vet kam marrë pjesë në atë demonstratë atje, jo në aksionin se i patëm ly Ambasadën e Greqisë me do parulla kundër asi, unë isha roje nuk e lysha ato (qeshë). Ma jepën aty ni çikë, kishe na çift e me lajmëru nëse vjen dikush (qeshë).

Kaltrina Krasniqi: A ka qenë freskuese për ty me e ndrru krejt ambientin, qysh ka qenë me shku në Beograd prej Kosovës?

Shkëlzen Maliqi: Po ka qenë, interesant ka qenë ai qytet. Ka qenë ma s'pari... atëherë ka qenë qytet relativisht i hapun për ... besoj që në regjimet komuniste s'ka pasë qytet ma t'hapun se Beogradi, krejt Jugosllavia, Zagrebi, po sidomos Beogradi, ka qenë qendra e Jugosllavisë po edhe qendra ma e randësishme, edhe krejt rinia nga të gjitha viset e Jugosllavisë vike aty. Ka qenë pak si ma... plus e kishe afër me shku, për shembull, në Hungari ose në, edhe në Perëndim se në ato vite kur shkova ende s'ka qenë liberalizimi i plotë i vizave.

Por dikun mas nja dy-tre vjetve Tito pat' bo gati krejt vendet evropiane regjimin e udhëtimit pa viza, pos, vetëm disa vende Spanja e Portugalia ato kanë qenë hala me regjime edhe Bashkimi Sovjetik e Amerikë qaty kem pasë vizë. Në vende tjera mujshe me shku edhe me u kthy si student. Çdo vjet shkojsha verës dikund i mledhsha ato si pesë dinarshe ka qenë, si pesë marka, për shembull, me ni kacë kur u bojshin nja 200-300 qasi...

Kaltrina Krasniqi: Pare.

Shkëlzen Maliqi: Pare i shndroshim ato n'marka edhe shkojsha në Romë a dikund rrisa nëpër këto... ose te naj shok ose te naj hostela t'lira, e qishtu, ose në strajca flejshim n'rrugë dikund nëpër parqe qishtu.

Kaltrina Krasniqi: E fakulteti?

Shkëlzen Maliqi: E Fakultetin Filozofi e regjistropa edhe nuk më pëlqejke aq shumë fakulteti as profesorat a diçka, veç disa nja a dy, tjerët jo. Po nuk ka qenë ai regjimi tepër i fortë. *Demek* [Turqisht - domethënë]në komplet studimet i kam pasë nja 18 provime, 19, do kanë qenë si t'lehta para ushtarak, mos i llogarit ama ato landët e filozofisë kanë qenë shumë të...

Kaltrina Krasniqi: Të ngjeshuna?

Shkëlzen Maliqi: Jo, shumë literaturë material me lexu, kështu që nuk ishte lehtë me e dhanë provimin, në fakt unë n'vend se me zgjedh atë rrugën e lehtë unë nissha me e lexu seriozisht qit' literaturën e krejt e s'mrrisha me lexu kur e lexojsha gjysën dilsha në provim a din?

A n'do landë nuk mujsha hiç me mësu shumë kanë qenë palidhje, pedagogjia edhe profesori i keq edhe libri s'kuptojshë kurgjo ose diçka për etikën ka qenë nifare libri e kam pasë edhe marksizmin, Andrea Stojkoviç, ai shumë dogmat ka qenë edhe s'mujshë me lexu atë, por te ai disa herë dola kështu kot a din, i kqyrsha pytjet ia kthejsha. Niherë pata fol diçka ma dha nifare gjashtëshe edhe dola qashtu i knaqun, po nuk i jepsha shumë zor asi fakultetit. Kur e jepshe kushtin, i jepshe tre provime njo t'metke shkojshë në klasën e dytë e qishtu. Kam pasë absolvu, domethanë, për nja pesë vjet po më kanë pas metë shumë provime, po nuk i.... Mandej pata nisë me punu verës me majt vetën, deri n'katër vjet i kam marrë prej shpisë m'pagujtën, m'çojshin ata pare, s'kom pasë as bursë as kurgjo as s'kom lyp çka po di.

Ma vonë punojsha. Nisa me punu si konservator i freskave nëpër manastire në Serbi edhe në Kosovë pak po ma shumë në Serbi. Kom punu nja gjashtë, shtatë vjet ashtu, edhe pata mësu boll mirë atë zanatin, po ishte veç me jetu, me mbijetu. Edhe punojsha, si student, punojsha n'mëngjes u çojsha herët për me e shpërnda qumështin te shpijat, ka qenë ajo kooperativa e studentëve edhe relativisht mirë pagujshin. Po u çojshë në 5:00, 5:30 i shkepshë nëpër adresa edhe mandej shkojshë edhe pak bojshe gjum e kështu.

Unë natën nuk flejsha gati hiç, shkojsha direkt i shkepsha mandej flejsha deri në ora nji, dy kam qenë shumë asi, ma shumë zog i natës kam qenë gjithë, tanë kohën atëherë edhe me lexu, edhe me shkru, edhe me mësu ditën kam qenë i ma... Çka po di, ashtu jetoja atëherë. Beogradi mandej ato vite u pat'... '70-ave edhe '60-ave, '70-ave kur i hapën kufijtë edhe hajnat shkun prej Beogradit edhe kriminelat shkun krejt nëpër Evropë e bojshin atje probleme se s'kishin çka me vjedh shumë atje nëpër asi. Ka qenë qytet relativisht i qetë në atë kohë, derisa nuk nisën me qit' do bomba me nji kinema atje në Beograd nisën me ja u ngjit ustashve nashta edhe ata kanë qenë ustash këta nacionalistat kroat, emigracioni kroat e diçka. Po jo kështu ka qenë natën ke mujt me shëtiti e me nejt deri vonë e ksi... mandej kom pasë bo shoqni kështu interesante disa lloj shoqnishë sidomos me artistat...

Kaltrina Krasniqi: Pamor.

Shkëlzen Maliqi: Pamor, kom pasë shumë e kam pasë njifarë... Mandej do filozofë e do tjerë po nëpër kafenetë e Beogradit nifare bohemije e asaj kohes...

Kaltrina Krasniqi: A shkrujshë?

Shkëlzen Maliqi: Shkrujsha ka pak për veti, jo aq shumë, vetëm ma vonë kam nisë me publiku '70-tave disa sene '72, '73, '74-shin m'doket e kam botu nifare shkrimi, ni reagim po ma shumë ka qenë për ni artist gjerman, Joseph Beuys-in. E pata komentu ni ligjeratë që e ka majt për herë t'parë qishtu e qatëherë diçka kam botu po shkrujsha ma shumë për veti edhe për qato nevojat për shkollë që është dashtë seminare e sene.

Pjesa e Tretë

Kaltrina Krasniqi: The pak parëz qet incidentin që ka ndodhë me ustash?

Shkëlzen Maliqi: Me?

Kaltrina Krasniqi: Me ustash.

Shkëlzen Maliqi: Ajo ka qenë...

Kaltrina Krasniqi: Po m'intereson, a ka qenë ashtu prominente, a kanë qenë promintente lëvizjet nacionaliste dhe fashiste? A ka pasë vetëdije për qato grupe?

Shkëlzen Maliqi: Jo, shiko në fundin e '60-tave ka qenë shumë turbullues për regjimin e asi... edhe fillimi i '70-tave në Kroaci edhe në Slloveni, sidomos në Kroaci, ka fillu një lloj, ata i thojshin maspop, lëvizja masive a din, njëfar rezistence masive, që, e iniciume prej vet udhëheqësisë kroate të komunistave por aty mandej kanë hy edhe këta nacionalistat e kiaro fashistat e kështu. Thjeshtë, federata nuk funksionojke ma si, a din, këto manej edhe në teori a diçka u shpjegu kështu se... ky zhvillimi i parë, komunizmi i parë, investimet e para, a din, pak me entuziazëm, pak me ndërto fabrika e sene, kjo periudha ka qenë okej.

Po kur ka nisë me... ky sistemi centralist i planifikuar i investimeve diçka, në shumë aspekte ka nis me çalu ose i kanë çu investime t'gabushme ose nuk ka qenë sistemi aq funksional. Atëhere disa ekonomistë nga... sidomos nga Sllovenia e kështu, ma s'pari viteve '50 ka nisë mu zhvillu ky koncepti i vetëvendosjes, i vetëvendosjes jo, po qysh i thojnë asaj, vetë... *samoupravljanje*...

Kaltrina Krasniqi: Vetëqeverisjes...

Shkëlzen Maliqi: Vetëadministrimit, vetëqeverisjës. Domethënë që punëtorët me pasë, jo vetëm drejtorati, por edhe punëtorët me pasë t'drejtën me udhëheqë fabrikat e punëtorët, aty çka kanë prodhu. Ky pak, në vitet e '60-ta tash është vendosë me futë elemente të tregut se me planifikim po gabojnë, byrokratët gabojnë, a din, nuk munden me planifiku nevojat e shtetit edhe të qytetarëve e kështu, si duhet. Edhe ia nisi me u futë ekonomia e tregut, njëfarë kombinimi edhe dirijume edhe ekonomia e tregut.

Po ajo manej, plus u hapën kufitë, njerëzit që kanë qenë pa punë kanë mujtë me u largu, me shku në Gjermani me punu. Edhe atëherë ka qenë një, një, për nja disa vjetë kanë pasë shku gati një milion e gjysë e ma shumë veta, edhe atëherë vala e parë e kosovarëve, shqiptarëve të ktuhit, të Maqedonisë, të krejt nga Jugosllavia kanë dalë jashtë. Ai është migracioni i parë i madh i shqiptarëve. Po kjo i ka damtuar edhe themelet e federatës që ma herët ka qenë e centralizume, prandaj republikat kanë lypë ma shumë pavarësi. Edhe mas ramjës të Rankoviçit, ata disi e stigmanziuan si ky ka qenë ai unitaristi, ai që ka dashtë më mbajtë Jugosllavinë me dorë t'fortë edhe n'favor të sërbeve deri diku.

Atëherë vendosën që për, jo me naj transparencë t'madhe publike, po komunistat mes veti, që të decentralizohet shteti. Në vend të demokratizimit, e kanë decentralizu. Kjo ka qenë njëfar {pin ujë} zgjidhje, ndoshta jo ma e mira e Titos që e ka bo edhe e Kardelit, e këta udhëheqësve që kanë qenë, sepse nevoja ka qenë për demokratizim në të vërtetë, të regjimit, por nuk kanë guxu me demokratizu se e kishin hupë pushtetin ata vetë (buzëqeshë). Por e kanë decentralizu domethënë, Tito e ka, e ka bo njëfarë sistemi, si një lloj gati konfederate, por me udhëheqje kolektive. Me i ikë modelit që t'gjitha regjimet komuniste përfundojnë me diktaturë të njanit, me kult të personalitet e kështu...

Tito vetë e ka pasë një kurth t'personaliteteve pade kqyrë si zbuten, si nuk {pin ujë}... e bonën udhëheqjen kolektive edhe vendosjen kolektive. Për shembull presidenca e Jugosllavisë deri sa ka qenë Tito gjallë i ka pasë ai tetë zavendësa, nga gjashtë republika, dhe dy krahina që me kushtetutën e '74-shit ma shumë lidhën me federatën se me Serbinë, këto dy krahinat e Serbisë, Kosova dhe Vojvodina. Ky ka qenë një model si kalimtar, i cili pastaj të '80-tave do të shkaktoj krizë tjetër, kur Serbia e sulmoi këta edhe thanë (kollitet), ata prapë thanë, "Ose Jugosllavia do të jetë prapë ma unitare..." Sepse atëherë serbët dilshin si populli i parë ma.... "Ose do të prishim këtë federatë". Domethanë, momerandum i famshëm i Akademisë së Shkencave të Serbisë i viteve të '80-ta, jo, po '80-ta. Mbas vdekjes së Titos kjo.

Po, atëherë ekstremizmi... domethanë, Jugosllavia në Luftën e Dytë Botërore nuk ka qenë vetëm luftë me okupatorët, gjermanët, italianët edhe pak bullgarët, s'di, po edhe ata m'doket jonë, e kanë marrë një pjesë të Maqedonisë e kështu. Por ka qenë edhe luftë vllavrasëse domethënë ashtu, sa i përketsllavëve, mes t'nacionalizmave ose fashizmave që ka pasë edhe në Kroaci edhe në Serbi, edhe kështu këto regjimet që kanë qenë me... ajo manej, komunistat Jugosllavë edhe Tito e ka fitu atë luftë me këtë parullën se Jugosllavia e Re do të ndërtohet në themelet e tjera edhe si një lloj "Bashkim Vllaznim" edhe ku secili komb dhe kombësi do ta ketë t'drejtat e barabarta. Po deri sa ka qenë Tito, kjo ka funksionu deri dikun. Po veç prej fundit të '60-ave, '70-ave jonë shfaqë qeto tendencat, egoizmat nacionale ose kur këta modeli i zhvillimit ose i mendësisë në Slloveni, e në Kroaci ma shumë, ka qenë pro perëndimorë edhe e kanë kërku tregun ma t'mirë.

Serbia edhe atëherë ma shumë ka qenë e lidhur me Rusinë edhe me investime prej asaj zone. Edhe meqë serbët kanë jetu me një përqindje relativisht t'madhe edhe në Bosnje edhe në Kroaci, a diçka, ata u mundojshin me, me... edhe pse edhe Serbia e ka pasë të '70-ave njejtë një lëvizje liberale, e cila ka qenë për demokratizimin ma shumë se sa për decentralizimin, po edhe ato Tito me ba njëfarë barazpeshe, kur i largoi komunistat e Kroacisë, i largoi edhe këta të Serbisë, Nikeziqin, edhe Latinka Peroviqin e kështu. Aty ka qenë një shqiptar, Orhan Nevzati me ta, njëfar sekretari.

Po qato, ka pasë shumë, ka qenë situata shumë, t'themi ashtu politikisht dinamike, por është zhvillu ma shumë te elitat, elitat.

Kaltrina Krasniqi: Domethanë nuk osht' ndi në jetën e përditshme qato dinamikat ma të mdhaja?

Shkëlzen Maliqi: U ndi manej kur ka shpërthya a diçka kur ka ndodhë...

Kaltrina Krasniqi: Jo po mendoj për qato vjet specifikisht, fundi i të '60-tave, '70-tave.

Shkëlzen Maliqi: Po u ndi, se në '68-tën ke pasë demonstratat të mëdhaja që kanë qenë edhe refleksi i atyne botërore. Por edhe në Beograd kur nisën ato në '68-tën në qershor, ato pjesërisht... neve s'e kem ditë atëherë, neve që kemi qenë majtista, edhe ma shumë e kem kqyrë botën edhe kështu. Po ato njifarë dore kanë qenë edhe një reagim i asaj pjese nacionaliste të Beogradit, e cila ka qenë e paknaqun se bash qaty dy javë në maj ka qenë njifarë mledhje e Komitetit Qendror të Serbisë ku Dobrica Qosiqi dhe Antoni Isaković, dy shkrimtar... Edhe një historian ka qenë, tre veta. Ata e kundërshtun politikën e komunistëve të Serbisë ndaj Kosovës, hapur. Qosiqi ka pasë thanë, "Nëse vazhdon kjo politikë neve për disa dekada do ta humbim komplet Kosovën. O tash do të bëjmë diçka o..." Ata nuk u pajtuan komunistat, e përjashtun a diçka edhe vazhdoi procesi qysh ka nisë me '68 e kështu, që me, me u rritë autonomia e Kosovës.

E këto me 2 qershor kanë nisë demonstratat, me njifarë incidenti qishtu te, koncert a çka ka qenë diçka, e ka intervenu policia po... domethënë njëfarë, ka pasë njëfarë induktimi të dyfishtë. Neve në Fakultetin Filozofik mandej, bo menjëherë qendra e kësaj protestës, neve e kishim idenë qishtu si, si në Francë ose në Poloni që qata bojshin, edhe në Amerikë ka pasë atëherë stude... '68-ta ka qenë me protesta të mëdha. Studentat ma shumë kanë qenë si anarkista, si njifarë... po {pin ujë}... Kurse edhe këtu në Kosovë '68-tën ka pasë, bile edhe këtu kur erdha, mas një kohe, në janar në të vërtetë, këtu kanë qenë, për festën e flamurit u bënë demonstratat, këtu edhe në Tetovë.

Po kur erdha në janar në Prishtinë, ajo kohë është pauza semestrare pak ma e gjatë, edhe bile punojsha një hulumtim atëherë me një shok të Beogradit, për pozitën sociale të minatorëve diçka nëpër, këtu nëpër Hajvali e nëpër Kosovë. Këtë djalin e dajës, Valbonin, e pata taku. Ai Valboni m'thojke, "Këto demonstratat e juja në Beograd, edhe këto po thojnë kanë qenë përkrahje e Qosiqit jo asi..." (qeshë) Edhe ai shoku im, ai Vlada Mijanović, edhe ai ka qenë njëfarë, ma vonë u marrë, njoni prej kundërshtarëve ma t'mdhaj të Titos, të regjimit edhe ka ra në burg. Edhe ai thojke, atëherë thojke, ai m'tha, aty në atë bisedë thojke, "Tito ka urdhëru prej këtu, e këtu, prej Beogradit për Sarajevë, a ku ka pasë njëfarë takimi" tha, "ai i ka çu ushtrinë me intervenu kundër demonstruesve në '68-tën në Beograd".

Edhe tash qashtu, ai e bojke një propagandë, ky djali i dajës thojke... Ato kanë qenë në të vërtetë nacionalista, e në të vërtetë kto janë tash interpretime të, në këtë kohë po e shofim që secili komb një ngjarje e interpreton kah kandi i vet. Ekonomikisht edhe ideologjikisht edhe si, si... ka pasë shumë arsye për paknaqësi në atë kohë te disa shtresa të popullsisë. A disa jonë adaptu me atë regjim ose më atë sistem ose kanë pasë punë t'mirë. Edhe tash e dijmë se bash qatëherë prej të '70-tave e këndeje, ata që kanë qenë të, të adaptum më sistemin kanë mujtë më bo, me marrë kredite, me bo shtëpija, edhe me pagu ato kredi edhe mandej mas disa... një viti, dy-tri viteve sa një kuti qibriti i ka ardhë ajo kësti me pagu, se inflacioni ka ra, po de, ashtu ka pasë...

Domethonë, dikush ka qenë i privilegjumë në atë regjim, disa jo. Edhe ka pasë shtresa të popullsisë që jonë, që kanë qenë relativisht të pavarura, sepse Jugosllavia kurrë nuk e ka ndalu pronën private, por vetëm e ka kufizu. Si me thonë, toka, dhjetë hektari ka qenë maksimumi që kom mujtë me pasë. Por

me pasë dyqane, biznise të vogla, ka pasë mundësi, domethanë... Ama ky është rast se ka mbijetu, ka mujtë pjesërisht edhe mu pasuru, por edhe me metë e pavarur prej ndikimeve ose me ra në ndikime tjera ose me ringjallë nacionalizmin ose çka po di. Neve studentët kemi qenë si në hava (qeshë).

Kaltrina Krasniqi: Në të '70-at ti faktikisht absolvon, a po?

Shkëlzen Maliqi: Po. Kom absolvu m'duket me vitin '71. Mandej m'kanë pasë metë nja katër provime, n'secilin vit nga një ose pesë, prej 17-18 sa i kem pasë krejt. Do kanë qenë kësi landë t'randa Filozofia një, dy, tre, qishtu, a don kanë qenë kësi pak palidhje, çka po di, pedagogjia ose etika, një, dy edhe ato kanë qenë. Do i pata dhonë, do jo. E manej çdo vit nga një provim e jepsha ose dy, deri të '78-tën, atëherë kom diplomu. Ndërkohë, e kom pasë marrë temën, diku para... Në '75-tën ose '76-tën, qashtu në atë vite, e pata marr një temë, meqë punojsha nëpër manastire e kështu, isha dhe afër me artin bizantin mesjetar, thashë hajt si filozof... edhe shpesh me këta historianët e artit bisha në njëfarë kundërshtime rreth ktyne artit mesjetar e kështu. A din, atëherë shumë e potencojsin se kjo është trashëgimi serbe, e diçka, mu m'u duke... i kom pasë do vene ku kom punu, i kom pasë pa që kishte shumë ndikime të artit antik, a din.

Plus e kisha njëfarë kujtese edhe prej Deçanit si fëmijë i vogël kur kam qenë. Atje i kem pasë disa kushtet, e shkujsh, disa herë e kom vizitu manastirin. Ata priftat atje sa m'tutshin, ashtu edhe mu duke interesant. Edhe në Prizren te, ka qenë kjo Shën Petka ose Bogorodica Ljevishka që i thojnë, ëshë në qytetin e vjetër aty. Kështu, mendojsa me marrë diçka, me kqyrë se, ato idenë e kom pasë çfarë, në bazë të cilave mendimeve, ideve është mbështetë ai arti, jo me i interpretu pikturat, po a ka {bënë sikur shkruan në dorën e vet} kësi kontribute estetike. Ata shokët e mi të filozofisë krejt thojshin, "Kjo nuk ekziston, s'ka pasë estetikë në mesjetë". Por kur shkova te ai, njëfarë profesori, s'ka qenë kumeditë se çfarë profesori, por ashtu. Bile ka qenë i kontestum e kështu njëfarë dogmati. Ka qenë Dragan Jeremiq. Ai u pat, u polemizojke me, atëhere me [Danilo] Kishin, e Kishin unë e kisha idoll. Po masi ai ma jepjke estetikën, u ula te ai me, me....

Unë i thashë, "Kom ardhë me paraqitë një temë që nuk ekziston: Estetika bizantine". Ai menjherë kcej prej karrigës, tha, "Kush t'ka dezinformu ashtu? Qysh nuk ekziston?" (Qeshë) "Mirë", thashë une asi. Tha, "Boma një, një koncept". Unë pata nisë me lexu edhe ma herët do sene, kur ia pruna atë draftin, ka qenë nja dy-tri tema kështu me tema që po du me i realizu. Edhe i kqyri tha, "Po ti po don me bo libër" (qeshë). Thashë, "Jo, jo, veç qeshtu..." "Mirë, mirë" tha "vazhdo!" Në atë kohë kam punu pak. Një kohë nja gjashtë mujë kom hulumtu në... anglishtën e disha jo shumë mirë, pak pata mësu kur kom qenë në ushtri, '74, '75 në Zagreb. Aty natën kur kom qenë *požarni*, që i thojshin *dežurni* [Nga srb.: kujdestar] me rujtë kasarmën, kazermën, atje e mësojsa. Por jo edhe aq mirë.

Por rusishtën e disha edhe i gjeta do punime të, të, origjinale të... Thuhet, është një korpus i botimeve që quhet "Patrologia Greke". "Patrologjia Greke" domethanë krejt shkrimet mesjetare greke edhe të kohës të krishtianizmit të hershme edhe më vonë, i ka pasë botu Franca në anglisht në shekullin XVIII. Edhe latine, edhe greke, por mu m'interesojsin këto greke, shkrimet greke. I gjeta gati gjysën e më shumë t'përkthyme rusisht, e ka pasë domethanë patrikana e Serbisë, aty njëfarë bodrum në

biblotekë. Aty gati çdo ditë shkoja, lexojsha se tjetër vende s'kishte. Por edhe në këto bibliotekat tjera kom pasë hulumtu një kohë.

E qashtu e pata mbledh do materiale edhe e përgadita ata. Në '78-tën kam diplomu. Po ai punimi përnime m'ka dalë, bile edhe nuk e kom përfundu krejt sa kom pasë materiale, po m'ka pasë dalë 360 faqe. Kur ia u çova atyne, ata thojshin, "Po kjo osht' doktoraturë". A din, se me vëllim. Edhe interesant ka qenë. Qashtu unë gjithmonë i mrapshtë. Ata njerëzit gjithmonë më kanë kritikuar ma vone, "Po pse nuk e bojshe njëherë për diplomë njo tridhjetë faqe, katërdhjetë. Mandej për magjistraturë ia shton edhe nja pesëdhjetë..." (qeshë). Po tani qashtu e kom pasë bo edhe okej është.

Atëherë patën nise me m'çmu edhe këta kolegët e krejt, se thojshin kjo interesant. Nuk ka qenë shume perfekte ai punim, i kanë mungu shumë sene kështu rele... Literatura relevante që kur punon diçka serioze duhesh me përfshi edhe çka po di, qata në gjuhën gjermane e kështu. Diçka në përkthime kom pasë kapë, edhe frangjisht disha pak, po jo aq shumë, a din. Mirëpo, ka qenë shumë njëfarë pune pionere sepse s'ka pasë as në literaturën botërore pos te disa rusët, për estetikën e asaj kohës, libra tamam për estetikën, ma shumë me analizu mendimin se sa...

Edhe atëhere isha, ata, në të vërtetë edhe Fakulteti edhe Insituti i Filozofisë m'thojshin se mirë kërkush s'është marrë me këtë temë, mundesh ti me vazhdu a diçka. Bile, ma pat' dhonë Insituti i Filozofisë në Beograd njëfarë si burse diçka, me e kry një pjesë, që iu duke ma interesante për Ikonoklazmën, është një periudhë kur bizantë, ka pasë edhe lindje atje të ortodoksisë, ka pasë fillu njëfar *schisme* e madhe. Domethanë jonë çu disa teolog kundër ikonave për me i shkatërru ato dhe i kanë shkatërru. Por mandej ka qenë edhe reaksioni e kështu, edhe ajo periudha është shumë interesante. Edhe m'duket edhe ajo pjesa që e pata botu atëherë diku në '80-tën prej këtij punimi është ma e përpunume, ma e mira n'krejt atë hulumtimin që pata bo.

Edhe njëfarë dore dojsa me u bo bizantolog, me e mësu greqishtën e vjetër. Kom pasë fillu me mësu do kurse atje, por veç atëherë gati patëm hy në vitet e '80-ta, u ndërru edhe situata në Jugosllavi, edhe statusi im si me... Në vitin '78 u pata punësu edhe në Fakultetin Filologjik në Beograd, dega e Albanologjisë. Tash, a din, të gjithëve na kapi pak edhe politika edhe këto sene edhe nuk më dukej më interesant me u marrë me atë, a din. Edhe pse kom pasë gjithmonë ide me kry atë, me botu atë punimin, me punu edhe pak e me botu. Vetëm mas 20 vjetëve, domethonë 1999 e kom botu qatë vëllimin e parë në shqip të "Estetikës Bizantine".

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë atmosfera në vitet e '70-ta?

Shkëlzen Maliqi: Hë?

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë për ty atmosfera në vitet e '70-ta?

Shkëlzen Maliqi: Ka qenë qishtu, idea me përfundu studimet. Nuk kisha ide m'u kthy në Prishtinë, e kam pasë jetën relativisht interesante. Verës punojsha nëpër, si konservatorë a diçka edhe se udhëtojsha jashtë, në Romë, Venecia, në Istamb... Turki e kështu. Shpesh kom udhëtu ose në Evropën

e mesme... por njëfarë dore nuk e disha as vet çka, çka kom me punu a din. I kom pas do shoqe, disa vajza me të cilat kom kalu, ato m' thojshin, "Hajde e ke dhanë një provim, likuidoje vitin e dytë, hajde vitin e tretë..." Edhe qashtu kadalë dalë u afrova edhe diplomova. Nuk ka qenë, ka qenë një periudhë kur unë jom tërhekë, po mendoj edhe prej... Në '68-tën, prej '68-tës deri dikun '69, '70 kom qenë atkiv edhe në ato lëvizjet rinore atje, në '68-tën që ka qenë n'krejt botën, i kem pasë edhe në Beograd edhe në Slloveni.

Mandej pak u zhgënjeva me ato ose edhe isha i detyrumë se në '69-tën, meqë unë isha në atë grupin e vogël, ata e qujshin... të Fakultetit Filozofik kryesisht, regjimi atëherë e qujke anarko-liberalët në Universitetin e Beogradit, kemi qenë nja 20-30 veta, ashtu me emra ndonjëherë na përmendshin. E mu më keqpërdorshin kështu si, sepse prej atyre në atë grup vetëm une dhe një, një shok tjetër kemi qenë {pin ujë}... Prindërit i kemi pasë asi në atë nomenklaturën komuniste. Ai, ai djali e ka pasë mbiemrin Udoviçki, a baba i tij ka qenë Danilo Udoviçki, baba i vet ka qenë njëfarë ambasadori, e kështu, njëfarë antëtari i komiteteve qëndrore. Edhe baba im ka qenë në komitetin qëndror, atëherë të Serbisë edhe anëtar i Këshillit të Federatës edhe qujt atëherë, njëfarë... ai, m'lajmërunë këta t'kabintetit të Fadil Hoxhës a diçka, "Çka po bon kështu, pse..." A din, m'bojshin presion, "Baba yt ka dhanë dorëheqje, nuk është mirë kështu".

Edhe unë e shifsha se edhe këta kolegët e mi menjëherë na keqpërdorëshin, na qishtshin neve si pëpara, kishe neve jemi... Ndonjëherë edhe kur majshin noj protestë, gjatë, policia kur i bënte raportet... se na vishin raportet edhe ato t'policisë çka kanë bo, se i kishin do lidhje qishtu nëpër komitete diçka. Aty, për shembull dilke, se n'do parolla që janë thanë dikush ka bërtitë, bërtitë, "Rrnoftë Enver Hoxha" e qesi sene, a din (qeshë). Edhe krejt manipulimi ishte që me prezencën teme në ato grupe. Dhe thashë unë, "Hajt, po tërhiqna". A din, edhe u tërheqa prej asaj jetës aktive.

Vet kjo fakti që mandej shkojsha me punu nëpër manastire thojsha, "Po shkoj në manastir". Si a din, kur zhgënjehet t'rejat ose t'ritë prej jetës e kështu, "Po shkoj në manastir". Po ka qenë ma shumë simbolike. Jom tërhekë pak n'veti edhe mendojsha çka me punu, çka, nuk disha. Kisha ambicie edhe letrare, edhe kam ba do skenare për filma që kurrë s'i kom përfundu, s'i kom realizu, ashtu që... Por a din, jeta shkojke disi edhe vetëm... a ndërkohë, po mendoj Beogradi atëherë ka qenë tepër i hapur edhe pse kriza ka pasë ndodh jo në Kroaci, jo kështu. Edhe vet në Beogradin atëhere liberalët i patën largu nga pushteti, erdhën do qisi farë kuadro pak ma dogmate e asi, por Tito e mbajke krejt nën kontroll, ende.

Ma herët pata folë për atë sistemin që e krijoi, në vend të demokratizimit e favorizoi decentralizimin, që i forcoi këto njësitë federale. Aty Kosova ka pasë fat që hyni në njësitë federale, me një status pak ma t'vogël edhe haptaz u flitke atëherë se domethanë Kosova e ka krejt statusin e republikës, veç emnin nuk e ka. Ashtu dhe më vonë e kemi kuptu se Tito ka thonë, "Merrni krejt çka mundeni, vetëm mos e lyni emnin se tranohet Serbia". Serbia e ka pasë provu atëherë, me, me e ndryshu këtë situatën me Kosovën që është kriju me kushtetutën e '74-tës. Sepse përnime i ka, ka qenë njëfarë paralelizmi i plotë mes republikave edhe dy krahinave. Edhe ato i kanë pasë përfaqësimin në, në Kryesinë e Federatës, përfaqësimin proporcional me ministra edhe në ministrinë e, edhe në qeverinë e Jugosllavisë, Federatës. Edhe në, në asamblenë, në parlamentin e Jugosllavisë e kanë pasë,

praktikisht të drejtën e votës. Asnjë ligj, asnjë vendim i madh s'ka mujtë me, me kalu pa pëlqimin e... për shembull buxheti e këto sendet.

Në praktikë fshtirë ajo ka mujtë me u realizu sepse ka qenë edhe partia që ka ndërmjetësu, kështu do vendime janë marrë me kompromise, por ka pasë situtata kur përnime edhe Kosova e ka blloku aprovimin e buxhetit vjetor e kështu... tu kërkua ma shumë ndihma. Për shembull, qato që i ka marrë ndihmat nga Federata për zhvillimin e rajoneve të, me pak të zhvillume diçka. Mirëpo, ka qenë periudha shumë e shkurtë, '74 kur u aprovu ligji, '75 kur ka nisë m'u, m'u apliku në kuptimin e plotë, edhe në '80-shi, '81-shi kur ka nisur ky procesi reversibil, anti-Titist e kështu, vetëm deri në '80-tën kështu ka qenë.

Unë në Kosovë atëherë visha rrallë, nganjëherë kështu pesë gjashtë herë në vit, por edhe Kosova ka pasë përfitu prej asaj. Unë nuk e kom përjetu atë autonominë, por u shifke se edhe thashë që sot kur e shohim të gjitha objektet e modernizmit taman jonë ndërtu në atë kohë edhe kanë nisë mu ndërtu edhe institucionet, ato të asaj autonomie t'largë. I kem pasë edhe disa, nuk kem pasë Ministri të Jashtme, por një sektor që në të vërtetë kanë punu si Ministri e Jashtme. Edhe për shembull nuk e ke pasë Ministrinë e Mbrojtës, por e ke pasë Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, që ka qenë njëfarë, nuk ka qenë direkt përgjegjëse për armatën, por për këto rezervat. Dhe Kosova e ka pasë atë Ministrinë, baba jem ka qenë njani prej ministrave t'parë aty që e ka udhëheqë këtë sektor dhe kanë trajnu njëfarë si ushtri rezervë e Kosovës në rast lufte. Qashtu ka qenë doktrina atëherë.

Por edhe ka qenë tendenca krejt republika në Jugosllavi me pasë edhe armatën e vet, armatimin dhe armatën. Kurse kjo armata Jugosllave ka qenë e centralizume dhe edhe Tito atyne iu ka delegu me rujtë Jugosllavinë si tanësi, sado që këto njësitë federale e kanë lyp pavarësinë ma t'madhe ose {pin ujë}. Në aspektin e jetës këtu mu duke se gradualisht sa ma shumë që afroheshim të '80-tave ka pasë një gjallëri, ma s'pari që u hap universiteti edhe Prishtina u bo një, një qytet ku ndryshe tash frymojke. Përpara ka pasë kështu, ka qenë hala ma shumë të '60-tave, ma shumë si *kasaba* e tash u... Edhe ishin ndikimet, kishte diskotekat e para, jo kështu, njëfarë ndikimi... Një jetë pak ma e gjallë edhe pse nuk rrisa tepër shumë, a din, ka ndodhë ndonjëherë që për shembull... edhe s'ka pasë bash shumë vende kështu që, ma shumë dominojshin çajtoret, me ato filmat e Tatlisetit se këtyne kështu plotë ishin me asi...

A ka pasë ndodhë njëherë, për shembull me Enver Petrovcin e pata njoftu atje dhe kështu kur vishim këtu u takojshim edhe në Prishtinë. Një herë patëm dalë në mbramje te "Hotel Grandi", thojshin ka muzikë a diçka. Shkumë atje në atë sallën ku është ajo, ai far murali, ai mozaiku i Muslim Mulliqit, kur hymë mrenda, ajo salla plotë tym atëherë pishin {bënë sikur pin cigare me dorë}. Edhe aty janë për shembull pesëqind meshkuj napër ka... Aty njifarë *pevaljke* që ishte kangëtare... Hymë pak edhe u kthym kështu si (qeshë)... S'ishim mësu në Beograd që shkojshim a din me shoqni t'përzime femna sene, hala na u duke si se femra këtu është e mbyllun. Ditën ndashta i shifshe kështu, ka pasë do kafiqa atëherë, edhe kur dilshin atje, ma shumë femrat serbe ishin, rrallë këto shqiptare të emancipume. Prandaj, kur kom ardhë të '80-tave, në '82-shën jom kthy këtu në vjeshtë. Kjo situatë pak edhe ma shumë osht' avancu, po prapë ka nisë edhe atëhere kriza politike.

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 21 tetor, 2018]

Pjesa e Katërt

Kaltrina Krasniqi: Para se me hi në të '80-tat, a ju kujtohet njifarë, diqysh '81-shi prezentohet si njifarë vjeti befas, a e ki ti përshtypjen se ka qenë gradualisht tu u ndërto tereni për...

Shkëlzen Maliqi: Po shiko, '68-ta ka qenë njifarë kthese këtu në Kosovë, se për herë t'parë republikisht ka dalë kërkesa për republikë edhe pse nuk i kanë dhanë shumë za, po u dike që kush... filani, filani, filani ka lyp republikën. Po u fashitë se ka ardhë meniherë intervenimi prej s'nalti, "Nuk është momenti, bohet ma vonë nashta duhet me e mësu Serbinë me asi..." Kështu. Për shembull, thojshin Rezak Shala ka kërku, ka qenë prokuror a çka ka qenë atëherë, ose Ramadan Vraniqi kështu edhe publikisht nëpër takime... po mandej e fitoi qat' autonominë e zgjerune edhe tash janë bo dy vija këtu. Ka qenë një vijë e ktyne aparaçikëve, partizanët shqiptar që kanë luftu në Luftën e Dytë Botërore. Qajo gjenerata e Fadil Hoxhës, e Xhavit Nimanit e ktyne, ata njifarë dore e kanë marrë përsipër me e ndërto tash këtë autonominë edhe ate me ja përshtat sistemit jugosllav, por me lypë sa ma shumë t'drejta edhe me ndërto këtë subjektivitetin e Kosovës.

Kurse në prapavijë u ngritë... në prapavijë ose në ilegal, sepse nuk ka qenë e... nuk ka mundur hapur të shtrohet çështja e themelimit të kufinjëve ose që Kosova t'i bashkohet Shqipërisë e kështu. Disa, këta, ka qenë ky grupi, për shembull si Adem Demaçi e këtyne që janë dënu edhe në të '60-ta po edhe ridënu ma vonë, edhe do intelektualëve e kështu që kanë nisë me fol, pse ne jemi me Jugosllavinë kur s'jemi sllav, kur... edhe vet Jugosllavia atëherë u vetëdijësu se emni, po sidomos himni, ka qenë shumë problematik, që atëherë si fëmi neve nuk e dishim që na shtishin me e knu, "Hej sloveni, još ste živi", edhe unë e kam ditë përmendësh ata se kam qenë edhe vëzhgus edhe kam shku nëpër male me ata, a din. Çdo mëngjes e çojshim atë flamurin e Jugosllavisë a Serbisë edhe e knojshim "Hej sloveni", a ma vonë kur u rritëm tham, "Po pse? Çka po e knoj unë sllovenëve?" (qeshë).

Njifarë dore, unë në ato '70-ta, vitet e '70-ta edhe këto, jo krizat, po prirjet intelektuale që i kam pasë edhe pse nuk kam botu për shembull kurrë edhe ato që i kam pasë shkrujtë poezitë, ose... Kam pasë nisë n'ndërgjegje me e ndi vetën si t'mangët se nuk shkrujsha edhe shqip, a din. Meqë i pata ndërpre leximet n'shqip prej fëminisë pak e kisha problem. Pata nisë me lexu mandej ndonjë libër që e gjejsa këtu interesant, për shembull Kadareja kur u bo i famshëm provojsha me lexu edhe shqip edhe pse prapë ma lehtë m'shkojke me lexu, asi, serbisht kur e përkthejshin atje. Kështu, mendojsha që nuk jam bash komplet edhe faktikisht pak kam qenë si i ngurrum me publiku ose mendojsha nuk është hala, ata që po e boj nuk është tamam, a din, nifarë... ose menojsa jam hala i ri nuk duhet asi, po thjeshtë, nuk kam pasë asnjë njeri, t'them, ashtu besnik që i kam besu. Disave që e kanë pa thojshin, "A kjo është interesant..." Po nuk, nuk kam botu gati kurgjo '70-tave sado që kam shkrujt.

Mirëpo, kam pasë nisë me u vetdijësu se, megjithatë, vet ajo situata e '70-tave, do biseda politike ndonjëherë edhe që kam pasë edhe do kontakte shumë të çuditshme se nuk besojsha që ekzistojnë asi njerëz, për shembull, disa historianë, disa studentë t'ri moshatar t'mi që studiojshin histori. Njëherë e kam pasë një polemikë shumë t'ashpër ai folke kshtu si ato që i disha prej librave prej aty në kohën... në fillim të shekullit XX. Ato që i kritikojke Tucoviqi, nacionalizmin ekstrem serb se Kosova është tokë serbe, se na kanë sjellë këtu turqit, na kanë dhanë pushtetin, ju kem bo serbëve çka s'ju kem bo,

Shkodra është e serbëve, e qesi sene Durrësi e qisi sene, a din. M'u doke si anakronizëm, nuk besojsha që kësi njerëz ndonjëherë vijnë në pushtet ose marrin dhenë, por shumë shpejt do t'ndodhë kjo pasi në fillim të '80-tave nisën publikisht me dalë këta n'skenë.

Kaltrina Krasniqi: E ti në '81-shin ke qenë në Beograd?

Shkëlzen Maliqi: Unë në '81-shin kam qenë në Beograd ende deri në '82-shin kam qenë atje deri n'fund. Mandej filloi me u prishë atje atmosfera e sene. Ajo shoqnia jeme ka qenë shumë normal edhe 90 përqind e tyne edhe sot janë ashtu normal, po që u zgju njifarë, t'them, u zgju qajo demoni i nacionalizmit. Unë e kam në ato shkrimet e mia edhe librin e kam pasë përshkru qat', të them ashtu, qat' zgjimin ose paraqitjen e parë të këtij farë nacionalizmi ose edhe fashizmi serb në situata që i kam pasë përjetu '70-tave. Do kontakte e do sene që tash s'di sa muj me i tregu mirë, po edhe i kam pasë tregu, e kam pasë bo nifarë paralele me nifarë shfaqje t'famshme që është luftë në atë, atëherë në "Atelenë 212", ajo ka qenë kult shfaqja e "Radovan Trećí" lujke ky, emrat ndonjëherë i harroj.

Kaltrina Krasniqi: N'cilin vend ka luftë?

Shkëlzen Maliqi: I ka luftë... është aktori ma i mirë serb i asaj kohe, ai ka vdek... Zoran Radmilloviq, s'e njef ti Zoran Radmilloviq...

Kaltrina Krasniqi: Jo...

Shkëlzen Maliqi: Po, Zoran Radmilloviq, po po ai është. Ai ka qenë aq aktor i mirë edhe aq shumë improvizojke me ato shfaqje. Ai e lujke nifarë katunari serb që ka ardh në qytet edhe tash këtë farë vizionin e këtyne ruralizimit të miteve nacionaliste serbe, jo aq hapur, por përafërsisht ashtu, kundërshtimin e civilizimit me nifarë humori shumë interesant. Po, ai Zorani ka qenë shumë shumë spirituoze edhe ka pasë për shembull, në ndonjë moment e ndërprejke zhvillimin e shfaqjes normale edhe kah 15 minuta improvizojke sa që bishin, keshin edhe krejtë kolegtë që lujshin me to në shfaqje.

Ashtu që për atë shfaqje kurrë s'ka pasë bileta, rrallë gjejshe se saherë që e shikojshe ke pasë qisi farë sene t'mira. Po une tu u nisë prej kësaj e kom pasë bo njifarë analize që disa shokë t'mi e përdorin ende në ligjerata si ni shembull, për këtë farë, si mund... si mundet një shoqëri të hy në regres në... që njerëzit, t'them ashtu, të degradohet edhe elita edhe mënyra e funksionimit të shoqnisë e çka po di. Në disa sa jam kështu i qartë, po ato për fat i kam shkru. Kur t'shkrujam pak ma i kujdesshëm, dhetë herë i kthehna naj fjalie naj ideje, a kështu kur flas i kam si do lakuna që s'muna me kujtu as emrin e Zoran Radmilloviqit. Tash çka deshta me thanë tjetër, për '70-tat apo?

Unë kështu, kur je i ri edhe studion, se i bon 27-28 deri në 30 vjet edhe i bon edhe e zhagit, edhe ka qenë atmosfera në krejt Jugosllavinë që nëse nuk ke hi në sistem me u bo anëtarë i Partisë Komuniste e kështu. Unë kam qenë nifarë gjysë disidenti se, domethanë prej '68-tës e andej, edhe nuk më interesojke as këtu me u kthy me u bo... se këtu baba im edhe familja kanë qenë ata që quhen nomenklaturë, kanë pasë do poste, po as atje domethanë... e atje nuk mujshe me përparu shumë. Une vetëm në vitin '78 kom pasë mundësi niher me u punësu pak ma rregullisht, qaty në katedrën e Albanologjisë edhe aty me mjaft probleme.

Herën e parë kur pata konkuru e anulun konkursin me arsytimin se nuk... jam element si i dyshimtë '68-ta e kështu, se policia, shërbimi çka po di atje e kanë dosjen teme nuk.... Mandej, unë kur i tregova

babës atje, ni kohë s’pata fol me të prej ‘68 deri në ‘72, ‘73, ‘74, s’kom folë a din, por kontaktet me familje i kom mbajt, se...

Kaltrina Krasniqi: Nuk folshe me babën?

Shkëlzen Maliqi: Po me babën se ai thojke, “Unë të ndihmoj t’i çoj paret”, por unë devijova ia nisa kundër familjes, kundër komunistëve (qeshë).

Aurela Kadriu: Dashta me u kthy te vitet e ‘70-tave, kah mesi i viteve të ‘70-tave, fillimi i ‘80-tave se tregimit që po e kallxoni po m’doket që qikjo periudha kur e keni artikulu njifarë qëndrimi politik...

Shkëlzen Maliqi: Unë e kam artikulu edhe ma herët ‘68-ën, por unë thashë që u tërhoqa. Unë e kam përcjellë edhe në atë kohë kur isha në manastir edhe.... Jo, në manastir nuk kam qenë, por kur punojsha qisi puntë me arte, me freska kështu i rregullojshim ato freska, i pastrojshim. Por, i kam përcjellë tanë kohën edhe kam pasë shokë që kanë qenë në politikë ose disident ose disa kanë ra n’burg. Unë nuk rashë, m’kanë marrë n’pyetje disa herë po s’kam ra. Po unë u tërhjeka për mos me pasë familja pasoja edhe mandej mas disa vjetëve kishe u pajtum pak se, a din, nuk bojsha unë ma probleme ama tash i përcjellsha çka po ndodhë, a din.

Neve vet Federata e Jugosllavisë s’kemi besu që aq lehtë shkatërrohet, a din, po problemet kanë ekzist. Kanë ekzist problemet mandej u bonën edhe ekonomike, po vet pozita jeme që u punësova katër vjet nuk kishe as idenë kur mundesh me fitu, bo naj banesë për vete, a najsen për me jetu atje diçka. Edhe baba jem hala ka qenë anëtarë i Këshillit të Federatës ma shumë se dhjetë, dymbëdhjetë vjet edhe e kemi marrë ni banesë, se i ka taku. Ka mujt me e marrë ni banesë në Beograd, niherë provojke, por mandej me dy mendje, “Po, jo, po, jo”. Thojke, “Me e marr banesën mbetet atje përgjithmonë”. Nana jeme i ka fol, “Mos ia merr banesën atje, se nuk kthehet mo” (qeshë) qisi do muhabetesh kanë qenë. Por, unë, si me thanë, i kam pasë qato dilemat e mia çka me bo tash me jetën teme? A me shku në perëndim si shumë veta që shkojshin atëherë? I kam pasë...

Derisa kam qenë e lidhur me ni vajzë, ka qenë e Dalmacisë, por e lindur në Beograd edhe kështu. Atëherë kam qenë pak ma stabil edhe qaty jetojshim, po mandej u patëm nda në ‘78-ën kur diplomova e tash m’u hap dilema. Mirë, hyna n’punë, po nuk kisha përspektivë. Ata të fakultetit, aty e kam pasë një shef të katedrës, ky farë Tërnaci, Halit Tërnaci. Ky Haliti ka qenë njifarë si profesor idioti edhe pshtjellke diçka. E ka pasë çu Kosova atje si kuadër e tash lypke me e kthy me naj post këtu në Kosovë, e qisi farë sene shkrujke do letra, po mandej u lidh me këta, e shfrytëzunë ata të Beogradit. Ia nisi ai mas ‘81-shit me i bo do denoncime, e pat’ bo ni listë të keqpërdorimeve të Xhavit Nimanit. Sa veta i ka punësu të familjes e qishtu, m’thojke edhe mu me nënshku po pritojsha me nënshku edhe i pata prish puntë me to edhe dojsha me e lanë atë katedrën e fakultetin e krejt.

Bile edhe baba më pat’ thanë, “Hajde, këtu une t’maj ose rri atje po le atë pisin mos rri me të, ta paguj une ni kohë derisa nuk gjen naj punë ma t’mirë”, ose m’thojshin hajde këtu e qashtu. Une, atëherë krejt atmosfera ia nisi me u prishë, shkrimet, gazetatat, senet. Edhe mandej kur i ke 35 vjet, atëherë edhe pak lodhesh e kështu mendon. Edhe unë prapë e kisha idenë me ikë dikund n’mal me jetu ose edhe me lexu libra (qeshë)... Nuk di, edhe thashë, niherë mendojsha me shku në Francë s’di qashtu e kom

pasë njifarë mundësie, po thojsha apet asi po kthehna këtu në Prishtinë, se ata prindët metën vetëm, motrat, vëllau ka jetu kur u martu me nusën e vet nji kohë.

Mandej, ata dolën n'banesë se zakonisht nuset e vjehrrat nuk e çojnë mirë qishtu diçka ka ndodhë edhe motrat u martunë e ata prindtë metën vet edhe m'thojshin, "Hajde, se krejt i ke kushtet edhe ni kat po ta japim", edhe thashë, hajt ta provoj. E qashtu erdha në Prishtinë, pak si i hutum a diçka edhe ky ka qenë fundi i '82-tës. E atëherë ndodhi që bash kur u ktheva këtu, edhe sa kam qenë në Beograd punojsha te katedra e Albanologjisë, e për herë t'parë kam pasë shumë literaturë n'gjuhën shqipe ose për shqiptarët ose për...

Edhe ato shkrimet e viteve para njiqind viteve e kështu, e kur u bojshin... kur patën nisë polemikat mas '81-shin ata i thojshin atëherë irredentizmi shqiptarë e çka po di, kërkesat shqiptare, statusi i Kosovës, pse e kemi aq autonominë e lartë e kështu. Disa herë m'u krujke dora me shkrujt edhe i pata shkrujt do reagime, po diqysh metshin të papërfundune. Kur u ktheva këtu, nihere s'kisha as punë veç erdha këtu rrrisha. Nja katër muj kam nejtë këtu pa punë, e nji ditë p'e lexoj njifarë shkrimi të do akademikëve që e kam ditë që janë nacionalista e kështu e njifarë Pavlle Iviq e kritikojke nji libër që ish botu në, në, në Tiranë i Akademisë atje të Shkencave, "Shqiptarët dhe trojet e tyre", qishtu diçka, a din. Dhe ky e sulmojke ate, jo kështu nga një pozitë normale, por nga pozitë e nacionalizmit serb. Ata tash u forcunë kaq shumë saqë ia nisën kështu.

Unë ia shkruva nji letër "NIN-it" pak si të gjatë edhe iu thashë, "Pse po botoni kësi farë shkrime? Nuk luftohet nacionalizmi shqiptar me nacionalizmin serb", edhe qisi farë sene. U çudita, ata e qitën, e botun atë artikullin, ka qenë njifarë redaktori i asaj rubrike të letrave t'lexuesve në "NIN". "NIN-i" një javore shumë e famshme e Beogradit, "*Nedeljne Informativne Novine*" [Gazeta Informativne Javore]. I cili, Ljuba Stoiq e ka pasë emrin, ai psikolog ka qenë, e kam njoftë edhe prej fakultetit kështu. Unë atëherë, e kam pasë nofken Zen, Shkelzen s'mujshin me e shqiptu ata serbët asniherë, pos Zen ose Xen ose Zen. E s'ka ditë që jam unë, po e ka pasë ai koleg Nait Vrenezin e ka thirrë me telefon i ka thanë, "A po e njeh bre këta? E kam marr nji letër shumë interesante. A din kush është ky Shkelzen Maliqi?" "Po, po" tha, "e njoh, e kam pasë shok".

Unë me Naitin prej Prizrenit njihemi, kemi qenë, ndoshta nji vjet është ma i vjetër. Por, prej gjimnazit e kështu kemi pasë shoqni. Edhe në Beograd mandej, ai e pat' kry psikologjinë. Edhe ai e ka botu atë letër, po ai m'ka pasë bo... jo, që e ka pasë botu këtu në Prishtinë, por mas disa dite krejt faqja e "Rilindjes" me atë shkrimin tem. E ia kanë qit edhe atij Pavlle Iviqit që me pasë barazpeshë, po ajo ka pasë jehonë shumë t'madhe këtu. Për herë t'parë që dikush haptazi [ka marr pjesë] me njifarë diskursi intelektual. Mandej këta njerëzit këtu s'më kanë njoftë, shumica kanë thanë, "Kush është ky? Me siguri është ndonjë pseudonim". Edhe a din, menxi, po, mirëpo ajo m'boni të famshëm. Mandej kemi pasë edhe njifarë...

Kaltrina Krasniqi: Ky ka qenë i vetmi shkëmbim që e keni pasë me...

Shkelzen Maliqi: Po, ky i pari ka qenë, i pari. Mandej ia shkrujta edhe ni përgjigje, ata u përgjigjën edhe unë ni përgjigje mandej e ndërpreu ata. E mandej ia nisën me m'njoftë. Mu m'kanë njoftë disa njerëz prej ktuhit si Rexhep Ismajli e këta, albanologët vishin nji herë n'javë me dhanë mësim atje në Beograd, i njifsha disa, e pak hina kështu edhe në çështje të intelektualëve menjëherë edhe do filozof

nisa me i njoftë këtu e kështu. E mandej ia nisa me e zanë njifarë rrjete publicistike. Me 35-36 vjet kam nisë me... e pata botu qat' studimin për ikonoklazmin në 1980, por ajo ka qenë kështu me xhiro t'vogël, kush e ka lexu ata do filozofa do kështu. Ama me hi në publicistikë, kështu me dyer t'mdhaja mandej nisa me shkrujt do artikuj tjerë, masnej u bona nifarë publicisti i njohun këtu edhe në qarqet jugosllave.

Kaltrina Krasniqi: Për kond shkrujshe ma shumë?

Shkëlzen Maliqi: Po fillimisht viteve '80-ta në fillim s'kam shkrujt edhe aq shumë aty këtu do reagime, do sene po prej '84-shit, '85-tës kur është botu, për shembull, ni libër, libri për Kosovën i Dimitrije Bogdanoviq atje në Beograd, Akademia e Shkencave e ka pasë botu edhe ai ka qenë njifarë akademiku. Unë e pata zbulu se ai libër është komplet kopje e një libri tjetër që e ka shkru një emigrant serbo-malazez çka ka qenë, njifarë Stjepçeviq për nevojat e propagandës të nacionalizmit serb në atë kohë. Edhe e pata botu ni artikull shumë t'gjatë këtu te "Thema", atëherë dilke si revistë e shoqatës të filozofëve ose te "Gjurmët Albanologjike".

Ata frangjisht e patëm botu, po ama mandej e pat' marrë "Vjesniku" i Zagrebit gati komplet e ka pas qit. Masnej hinëm në njifarë polemike, masnej m'sulmun ata të "NIN-it" do redaktorë edhe me ta kam pasë njifarë polemike rreth kësaj, por teza ka qenë e njejtë. Nuk munesh me e luftu nacionalizmin e shqiptarëve i cili është beninj në krahasim me nacionalizmin serb, nëse e jep hapësirën që serbomëdhejt ta luftojnë nacionalizmin e shqiptarëve. Kështu diçka ka qenë. Po ajo është veç diçka...

Mandej kam shkrujt kryesisht për revistat në Kroaci dhe në Slloveni, por edhe disa në Beograd ndonjëherë m'porositshin. Mandej Bosnja ka pasë atëherë shtypin që iu interesojke, jepsha intervista e kështu. Në Sanxhak ka pasë dalë një kohë njifarë reviste edhe për ata shkrujsha qishtu. Novi Sadi kryesisht kanë qenë shkrime publicistike, por relativisht t'mira ato shkrimet e '80-tave. Mandej i kam përmbledhë me një libër "Nyja e Kosovës" që ka dalë për herë t'parë më 1990-shin, në Ljubljanë është botu në shqip. Domethënë Ljubljana atëherë na përkrahke, sllovenët.

Kemi qenë me ni panair në Beograd me Ali Podrimën edhe ai, i kishim do shkrimtarë slloven miq e ai i thojke, "Pse s'po ia botoni Shkelzenit qato shkrime që po i boton te ju?" Edhe ata m'thirrin mas disa jave m'thanë, "Bjeri për një muj, një muj e gjysë po i botojmë veç me i përgadit". Por, unë shumicën i pata shkru serbisht i shkrujsha, ata i përkthejshin edhe i botojshin sllovenisht se këtu s'mi botojshin shkrimet kritike direkt, vetëm kur u botojke në "Danas" [Sot] dikund e merrshin këtu se u botu në "Danas" dikund nuk e merrshin ata përgjegjësinë. E kam shkrujt, për shembull, i çojsha te ka qenë Zenun Çela atëherë redaktor, e çojsha naj shkrim për flamurin çka po di për kurikulat kanë qenë do polemika atëherë ose do tema t'ndishme. Ai e lexojke thojke, "Shumë mirë e ke shkru, po s'guxojmë tash me botu. E kam ni sirtar ku i rendis shkrimet edhe vjen koha kur do t'i botojmë", po mirë s'paku ai ishte i sigurtë.

Mandej po ato, Ali Podrimja prapë i ka meritat se thashë, "S'muj unë për dy muj me i përkthi ato", se shumë kanë qenë tha, "Jo, unë t'i organizoj veç bjermi shqip", edhe i ka shpërnda atje. Do ia ka dhanë Rexhep Ismajlit, do Gani Bobit, do Hivzi Islamit, Vehap Shitës. Vehap Shita përkthejke kështu me dhetë gishta thojshin i shpejt ka qenë shumë ma... Po për një tri javë krejt m'i bonën gati edhe e çum atje në Ljubljana, i botum. Ka qenë libër interesant ajo, ka pasë dalë me njifarë defekti në faqën titullare edhe

për qita na patën vonu nja dy, tre muj me e dërgu. Njifarë redaktori, atje njifarë shqiptari që e botojke “Alternativën” atje në Lublanë, njifarë reviste e parë si alternative që ka dalë. Këtu bile edhe ata e patëm inicu bashkë me Ali Podrimën.

Kur ishim në, disa herë patëm shku në Bled atje, ishin takimet e Klubit Slloven Internacional e na thirrshin atje. E Alia edhe unë i thojshim, “Pse s’po...” i kem pasë atëherë neve do... këtu ka qenë fundi i ‘80-tave, ‘90-ave qishtu kur ka pasë qisi t’ikun nga Kosova që jetojshin në Slloveni edhe do shkrimtarë e diçka, “Pse s’pe boni një revistë për neve që po jetojmë këtu?” Bile unë e pata përgaditë pak ma herët nga fundi i ‘80-tave një revistë këtu me atë emrin “Alternativa”, por atëherë s’mujsh me botu revista kështu për qefi me regjistru, por u dufke me marrë leje prej Lidhjes Socialiste Popullit Punues të Kosovës.

Ka qenë Sali Nushi njifar shefi i asaj ose në kryesi përgjegjës për kulturën ose diçka. Kur ia çova propozimin a diçka, m’njifke personalisht prej Beogradit. Njeri simpatik ka qenë, ia nisi me m’sha serbisht, “*Kakva alternativa, jebem vam majku, çfarë alternative po lypni?*” (qeshë) “Por, jo titull Alternativa jo kështu, po ashtu”, ama jo, s’na lanë. Bile e pata përgaditë ni numër a diçka e Aliu ju thojke sllovenve, “Qe e kem edhe titullin Alternativa”, “Mirë, mirë”, (qeshë) s’ishte që e patëm bo, nuk e bom. E këtu, “Jedinstvo” edhe këta serbët lokal na kritikojshin se pat’ dalë si informatë që po botohet “Alternativa”, me “A” t’madhe si edhe nifar zgjidhje grafike e kem pasë këta thojshin, “Po kjo ‘A’ domethanë Albania”. Këta për qita e kanë bo edhe dizajnin dhe shumë atmosferë e keqe ka qenë me serbët lokal sidomos me “Jednistvon” e qishtu.

Pjesa e Pestë

Kaltrina Krasniqi: Veç edhe një pyetje për vitet e ‘80-ta. Gjatë viteve të ‘80-ta në princip fillon me u zhvillu njifarë skene kulturore në Kosovë, edhe sidomos n’muzikë mandej ka tendenca edhe n’leterësi e ka tendenca edhe n’film e...

Shkëlzen Maliqi: Jo, une kur kam ardhë këtu e kam gjetë skenen shumë t’heshtun, t’mbytur e kështu. Ka pasë tendenca edhe në të ‘70-ave, nashta disa që po i përmendi, për shembull Ali Podrimja, Eqrem Basha, Mensur Arifi, Rexhep Ismajli e këta, bile edhe Ibrahim Rugova. Ata e kanë pasë një edhe kanë qenë ende... sa kanë pasë dalë prej studentave, këta e kanë pasë nisë njifarë fushate me demonopolizu edhe me fut një frymë t’re, po nuk e kanë leju, ka qenë njifarë polemike atëherë. Une s’e kam ditë, po kur erdha këtu unë ma shumë u shoqnojsa me qita njerëz edhe... po n’përgjithësi e kom pa se kultura e Kosovës është si kulturë e rezervatit, domethanë, si indianët që i futshin në rezervate edhe thojshin, “Merreni me veti ju”. Domethanë... këtu 90 përqind të doktoraturave kanë qenë të albanologjisë, folklor e qisi sene, a din.

E pata kritiku edhe publikisht, për shembull me ni intervistë që pata dhanë për “*Delo*” e Zagrebit, mandej do intelektual qisi që këtu u çmojshin si kordinant si Rexhep Qosja, e kështu. Une kur i lexojsha m’u dokshin si me lexu Biblën ose diçka qashtu shumë... jo vetëm t’dalt mode, por me retorika, me përsëritje diçka. Ato nashta kanë pasë njifarë roli kështu vetëdijësimin e kështu, do romane, do sene

që i kanë shkru për emancipimin e shqiptarëve, por vet kanë qenë shumë të mbyllun. Mandej edhe kanë qenë kundër alternativave në çdo kuptim, përhapjen e kulturës a për diçka.

Kur ndëgjojsha, për shembull se bash qiky Rexhep Qosja e qita tjetër nuk kanë leju që “Rilindja” si shtëpi botuese ta botoj përkthimin e [Herbert] Marcuses ose dikush, ai ka qenë njifarë marksiti kështu, a t’pëlqen, a nuk t’pëlqen po thjeshtë, “Jo, çka po na duhen ata”, e kështu. Kanë pasë do farë, si duket njifarë mendësie edhe pak rigjide edhe tu i shiku ato farë në Shqipni, qëndrimet atje që janë kështu. Unë e kam pasë.... Në ‘86-tën jam bo anëtar i redaksisë së “Fjalës”. “Fjala” ka qenë e vetmja revistë dy javore, ka qenë për kulturë e për çështje shoqërore, qashtu u qujt. Fillimisht u bona vetëm anëtarë i redaksisë se ka qenë Vehbi Kikaj, ni poet për fëmijë, shkrimtar për fëmijë në atë kohë.

Atij ia patën dhanë këtë revistë, ai e mbante, sepse ia pata nisë unë disa polemika ose që u afirmova edhe n’shtypin jugosllav edhe këtu, kanë mendu që mirë është me m’pasë n’redaki. E edhe ia nisa me ia redaktu filozofinë e këto shkencat shoqërore, por edhe nisa me shkrujt për do filma, për do sene. Ka qenë ni periudhë, atëherë n’fillim, bash në ‘86-tën kur kam shkrujt për disa filma kështu në mënyrë kritike, për filmin e Agim Sopit edhe për ni film të Isa Qosjes kështu me përjetime kritike se, ku i kanë, gabime dramaturgjike ose mënyra e realizimit e kështu. Edhe për ato u pat’ bo shumë njifarë buje, gati ka pasë me... është caktu me u majt njifarë, t’them ashtu, ni tubim i madh kur i presin. Por, e ndalun ata s’e lanë kta Lidhja Socialiste edhe këta mos të...

Po akuzat ishin kështu se, për shembull te filmi i Agim Sopit, unë hala shkrujsha serbisht a din, po ma ka përkthi Vehbi Kikaj, unë disha edhe shqip po më merrke shumë kohë me artikulu tamam. Ai e kish bo titullin “Dramaturgjia e Pandehur - Njeriu prej Dheut”, a qysh e ka pasë ni film Agim Sopi diçka për emigracionin shqiptar, për depresionin e kohës të Rankovićit a diçka. Ky titull, ajo i “Pandehuri” e kështu ma shumë lidhet me terminologjinë juridike diçka edhe u bo njifarë afere, ata m’sulmojshin. Mandej, nisën me m’sulmu si dora e zgjatur e Beogradit, po sulmon kulturën shqiptare diçka, nuk e kisha unë atë qëllim po qashtu e lexojshin ata.

Gjithë kam pasë polemika në atë kohë me Mehmet Krajën edhe me qito klanet ekzistuese këtu, për shembull niherë ka qenë njifarë premiera botërore e një drame të Schnaiderit, ni dramaturg i Kroacisë. Ata ma porositën Jusuf Buxhovi e këta rubrikën e kulturës me e shkrujt. Une e shkrujta mirë edhe afirmative, ata, “Jo, s’po e botojmë”, nuk ju pëlqeu, kanë mendu se kam me mjegullo mu m’u dok shumë interesant ka qenë edhe tema e krejt. Kështu nuk kam pasë shumë te këta... ata që e kontrollojshin kulturën në Kosovë nuk kam pasë shumë përkrahje, por njifarë dore ka pasë edhe tjerë që mendojshin që ky është e arsyeshme nuk është vetëm asi...

Bile edhe m’kujtohet se atëherë kur e pata shkrujt kritikën e ktyne filmave, ky Azem Shkreli si drejtor i Kosovafilmit në atë kohë pat dhanë dorëheqje se ka qenë në Bordin, në Këshillin e “Fjalës”. Por mas ni kohe, ai ka qenë ma i arsyshëm njeri. U patëm taku me ni rast edhe tha, “Nëse e ke shkrujt prej bindjes okej është, po nëse dikush t’ka shti atëherë është poshtërsi”, “Jo...” mandej u pajtum, po këta që janë prek këta artistat nuk mujshin me e kuptu. Nuk ka pasë këtu domethënë kritikë normale ose jetë normale ndoshta edhe pse krejt kultura ka qenë e monopolizune. Ti ke pasë ni botues, praktikisht ni e gjysë se shtëpia, kjo Enti i Teksteve Shkollore ndonjëherë botojke naj libër e dikush qishtu pak si krejt e monopolizune edhe nuk...

Mandej, kur shkrujshin kritika ose shoku për shokun ose rrallë ndonjëherë naj inat që kanë pasë mes veti u shprehte përmes gazetave e kështu, e kështu. Kjo ka qenë njifarë amullie, plus ka qenë kohërat e vështira sepse më ndjekshin, çdo gabim që dikush e bojke nëpër gazeta atëherë e sulmojshin, si irredentist. Ka qenë presioni te krejt intelektualët me u deklaruar me shkru kundër Shqipnisë, do nuk dojshin sepse nuk pranojnë urdhëra, do sepse bindjet i kanë pasë atje, a din, e qashtu. Ka qenë shumë e vështirë me.... Në atë kohë kam qenë, jo ma i guximshëm, po kam ardh prej një mjedisi tjetër edhe nuk i kuptojsha këto kufizimet ndonjëherë nuk më interesojshin.

A mu patën ardhë dikun kur është botu libri ndoshta ka qenë '84-shi ose diçka këta të "Rilindjes" patën ardh më thanë "A don me bo ni kritikë të librit të Enver Hoxhës 'Titistët'", unë thashë, "S'po di, duhet me lexu nihere te kqyri çka ka", edhe ma sollën ata, e kishin marrë, kish mrrri prej Tiranës. E lexova edhe m'u dok shumë primitiv, asi libër politik, si pamfletë si diçka, po shumë dobësi kishte. Po unë atëherë, në atë kohë lexojsha diçka edhe Kardelin edhe i thashë, "Une e shkruj vetëm me një kusht, kur ta kritikoj këtë farë Enver Hoxhën do ta kritikoj edhe Kardelin se i njejtë..." edhe pse temat janë krejt ndryshe krejt, po mënyra e artikulimit edhe thashë, "Unë muj me shkrujt si filozof si njeri që..." "Aaa, jo s'bon ashtu, atëherë na qet në asi..." (qeshë) edhe atëherë unë thashë, "Jo s'po hyj në këto lojna tash me..." Une boll isha i angazhun në shtypin jugosllav që e kritikojsha këtë nacionalizmin serb, Millosheviqin e... Millosheviqi ma vonë pat' dalë, po qatëherë ka pasë nisë kështu. Kështu që nuk...

Mandej ndodhi edhe diçka tjetër se Vehbi Kikaj u pat' smu edhe vdiq shpejt edhe ni kohë ajo "Fjala" mbeti pa bos. Mandej e shpallën konkursin e këta shoktë e mi thojshin, "Merre ti, merre ti", edhe konkurova. Ata m'kishin zgjedh mu. Ata, disa prej redaksisë janë idhnu e kanë lëshu e kështu, por çka po di, mu m'caktun. Nuk m'kishin vet a jam anëtarë i partisë, kanë mendu se qasi jom unë i familjes e krejt... me pasë ditë nashta s'më kishin bo. Por, si duket atëherë kish intervencu Azem Vllasi, s'kanë guxu dikond tjetër me e bo se ai ka qenë bash qat'herë Kryetar i Komitetit, me dijeninë teme a diçka, edhe me "Fjalën" që kem nisë me e botu në '87-tën për herë t'parë nis një shtyp i Kosovës, një botim, nisi tash me iu kundërpërgjigjë, me u bo si ata, jo në nivelin e tyne si këta të Beogradit, po me u përgjigjë mos me lanë haptë, taman me njifarë platforme shumë ma t'bukur, ma përmbajtësore, ma...

Unë e mora revistën, ma s'pari ia ndrrova dizajnin, dizajnin, shumë bukur ka qenë ka pasë dalë. Negrën e pata marrë si dizajner, përpara s'ka punu ai dizajnm mu veç m'pëlqejke mënyra qysh p'i bon stripat që në "Danas" i bojke atëherë. Edhe kjo ishte një revolucion i vogël në shtypin atëherë të kohës, se ato katër, pesë faqet e para i bojshin i sjellshin tekstet e zgjedhuna prej sllovenëve, kroatëve, edhe serbëve normal kundër regjimit atje edhe këtu shkrujshim edhe komente. Dhe nja katër, pesë numra kalunë ashtu kerkush s'reagojke. Veç ni ditë erdhën ata thanë, "I ka lyp Ali Shukria prej Beogradit..." Ka qenë atëherë në kryesinë e partisë në Beograd, "Është puna keq", tha (qeshë), "se neve nuk guxojn me bo si 'Književna Novina' në Beograd" "Nuk është se... veç po tregojmë se ku janë teprimat edhe idiotizmat që p'e bojnë atje". Fushata anti shqiptare në atë kohë ka qenë n'kulm, ajo ka qenë dikun pak para kur...

Kaltrina Krasniqi: Fol pak për natyrën e qisaj fushate anti shqiptare që ka qenë?

Shkëlzen Maliqi: Ajo pat' nisë kur erdh Millosheviçi n'pushtet ajo u bo e pa durueshme po, për shembull ka pasë, e lroi shtypin në Beograd me i hap rubrikat e tëra me reagimet kishe t'qytetarëve e kështu, kishe të shkenctarëve e kështu, kur botojshin gjithçka. Përnime, si pleh sulme kundër shqiptarëve, ofendime, tituj si me shpifje si *Fake News* [Anglisht - Lajme të rreme]. Kishe kjo pjesa

shqiptare po i malltretojnë, po i dhunojnë serbët çdo ditë e pa përshkrushme është ajo që... Edhe e ka pasë qesi odjeci, reagovanje [Serbisht - jehona, reagimi], “Politikën” si një gazetë ma prestigjioze edhe ma e vjetra në Ballkan ditore, ka pasë ra aq poshtë saqë nuk është e përshkrushme. Sot me çelë me kqyr këto gazetate e ekstreme serbe qysh janë këto “Kuriri” qashtu çdo ditë kishte, por atje për neve ishte pak si... a din në veshët tonë u duke shumë e çuditshme në çfarë ekstremi e çfarë akuza u bojshin. Domethanë, kjo ka qenë njifarë përgaditje e terrenit për me e marrë autonominë e Kosovës.

Problemi i Serbisë ka qenë kushtetuten e ‘74-tës se nuk mujshin thjeshtë me e kthy situatën, Kosova kinse formalisht ka qenë pjesë e Serbisë, po nuk kanë mujtë ata as ushtrinë, as kështu, n’kufi u dashtë me u nalë pa e dhanë lejen kryetari i Kosovës s’kanë mujt me hy këtu. Problemi kryesor, për shembull në ‘81-shin me ardhë Policia Serbe këtu me intervenu bile jo serbe edhe jugosllave ka qenë, se është dashtë me nënshkru Xhavit Nimani. Xhavit Nimani s’ka dashtë me nënshkru, tre ditë i ka majt në kufi. Ata në Merdare kanë prit aty, mandej është dashtë diqysh me ndrru e kanë gjetë njifarë forme e dikush tjetër ka nënshkru s’më kujtohet kush, po mendoj unë s’kam qenë këtu po qashtu më kanë tregu.

Kjo edhe, nuk kanë mujt as me e ndrru është dashtë me e ndrru komplet kushtetutën edhe sistemin për me e kthy kontrollin Serbia në Kosovë. Dy herë është shpallë gjendja e jashtëzakonshme, nihere në ‘81-shin atëherë kanë ardhë forcat federale këtu me e kontrollu situatën e kështu mas dy-tre vjetve edhe pat’... babes tem Mehmetit që me ‘81-shën u pat’ zgjedh Minister i Brendshëm edhe ka arritë diqysh me e kthy situatën normale edhe mas dy vjetëve, tre vjetve e kanë hek gjendjen e jashtëzakonshme. Por Serbia s’ka qenë e knaqun, ma vonë prapë ka bo provokime tjera sene edhe e kanë kthy prapë, po nuk kanë mujt me e ndrru kushtetutën në mënyrë normale, sepse nuk ka qenë tash vetëm kundër Kosova, po kanë qenë t’rrezikume edhe Sllovenia edhe Kroacia, ata s’e kanë lanë kursesi. Edhe këto republikat tjera kanë pasë Maqedonia e Bosnja, kanë pasë qëndrime krejt, ata vetëm kanë mujt fillimisht me bo përveti edhe ato me dhunë Malin e Zi edhe Vojvodinën, amo s’kanë mujt me e ndrru situatën.

Prandaj, kur erdh Millosheviçi në pushtet, njëra prej parullave t’ija ka qenë, do ta ndrrojmë situatën edhe kushtetutën, situatën në Kosovë me t’gjitha mjetet nëse duhet dhunë me dhunë. Parafrazë është, ndoshta e ka thanë pak ma ndryshe po qishtu osht’, me t’gjitha mjetet, legale edhe jo legale edhe qashtu kanë vepru. Ma s’pari kanë nisë luftën mes opozitës brenda partisë në Serbi me njifarë mbledhje t’famshme kur e kanë ndrru atë Ivan Stanbolliqin edhe tjetër këta që kanë qenë për masa ma t’buta, nuk kanë qenë edhe ata kundër, edhe ata e kanë dashtë Kosovën me e disiplinu ose me e fut... Mirëpo, kanë mendu që kjo mundet me ndodh ma gradualisht ose mos me e provoku shkatërrimin e Jugosllavisë.

Ndërkohë, në ‘85-tën ose ‘86-tën është botu edhe ni projekt i Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Serbisë ku ka qenë njifarë memorandum i famshëm i cili kishte ilegalisht, një version i tij u publiku u bo si e madhe diçka n’fillim edhe Millosheviçi edhe komunistët e Serbisë e luftojshin, ishin kundër tij po në të vërtetë ma vonë e morën platformën e tij me e realizu. Në atë dokument Akademia Serbe e kishte këtë... njifarë konstatimi se Jugosllavia e Dytë, kjo Jugosllavia Federale është kriju me premisat anti serbe. Domethanë, një premisë kështu që figuronte me ni sllogan, “Serbia e dobtë, Jugosllavia e fortë”, kjo ka qenë qajo formula, kinse Tito me atë formulë e ka ndërto këtë federatën, kurse ata mendojshin t’kundërtën.

Nëse nuk ndërron raportin, raportet në federatë atëherë Serbia do të shikoj mënyra tjera qysh me realizu interesat kombëtare të Serbisë, qoftë edhe me shkatërrimin e Jugosllavisë. Këtë platformë më vonë e mori edhe Millosheviqi, por edhe një pjesë e ushtrisë Jugosllave, njëfarë gjenerali Lubiçiq që ka qenë autoriteti kryesor atëherë, me... ai e ka përkrahë Slllobodan Millosheviqin edhe ka ndërtu një platformë që përmes ushtrisë, përmes këtij lëvizjes masive, organizimit të mitingjeve, të presioneve. Ky e pat' fillu këtu në Fushë Kosovë, me serbët e ktuhit patën nisë me protesta u mledhshin dyqind-pesëqind veta, këta serbët lokal, i bojshin ultimatum Serbisë ose shkojshin te kuvendi i Jugosllavisë atje tu u anku për situatën këtu e qishtu.

Domethanë prej një komune relativisht t'vogël, s'di atëherë a ka qenë komunë a ka qenë paralagje e Prishtinës, nashta hala ka qenë paralagje e Prishtinës, e dridhshin krejt federatën. Mandej kanë pasë organizu disa incidente shumë t'forta regjimi i Millosheviqit që neve e kemi pasë denoncu atëherë si "Djegjen e Reichstagut". Ka qenë njëfarë vrasje e katër ushtarëve të Armatës Jugosllave në Paraqin, në 1987-tën në shtator pas të cilës, domethanë u mor si pretext me, me, me... për ma s'pari spastrimin e vet radhëve të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë prej atyne që ishin kundër vijës Millosheviqit e mandej edhe njëfarë popullizmi ekstrem me krejt Jugosllavinë. Ky rasti Paraqinit ka qenë që njëfarëushtar shqiptar i ka vra në gjum katër veta që kanë qenë si t'zgjedhun, njëri kroat, njo i Bosnjes, njo kështu, Kelmendi e ka pasë mbiemrin ai ushtari. Kot, inskenim ka qenë edhe mandej e kanë gjetë kishe kanë bo vetëvrasje a diçka në një pyll atje afër, krejt ka qenë e inskenune.

Domethanë, Millosheviçi ka ardhë me dhunë edhe pa dhunë s'ka mujt as me u largu prej pushtetit edhe mandej i ka shkakto disa, ni seri luftash me zor, domethanë me imponime i ka... Ai që ndrohet Kushtetuta e Kosovës e Serbisë e kështu. Po ajo, mandej ka qenë edhe akti njëkohësisht edhe akti i shkatërrimit të Jugosllavisë sepse prej momentit që është marrë autonomia e Kosovës nuk ka funksionu sipas Kushtetutes '74-shës as Asambleja Federale. Nuk ka mujt se për çdo vendim u dashtë me e pasë edhe aprovimin e Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës, e Sllovenia e Kroacia nuk lejojshin me punu pa e pasë edhe komplet, sipas kushtetutës së '74-shit këtë procedurën se s'i duhet...

Edhe ndërkohë kanë nisë me i aprovu edhe vet ligjet seperatiste tyne s'ka pasë kush me i pengu për këtë është kriju njëfarë situatë e dhunshme e Serbia provonte, me dhunë i pushtoj dy njësi federale, Vojvodinën edhe Malin e Zi. Në Novi Sad e organizun ni demonstratë t'madhe mandej e kanë qujt Jogurt Revolucion, sepse e kanë gjujt kuvendin me jogurta e kësi sene, po ata mandej vet u dorëzun, ata autonomistat e dorëzun pushtetin. Kurse në Mal të Zi edhe aty u bo njëfarë inskenimi që me e marrë pushtetin këto forcat pro - serbe. Në Bosnje nuk kanë pasë aq sukses, vetëm që e kanë organizu elementin vetë serb atje. Kurse kanë provu, për shembull me bo demonstrata anti sllovene kundër, me i çu njerëzit n'kamë ktu serbët që jetojnë atje edhe me çu autobusa atje, por nuk ka pasë sukses se nuk i kanë lanë milicia edhe politika sllovene e kështu. Ka qenë një periudhë shumë dramatike e zhvillimeve ku secili, domethanë element i asaj federatë çdo komb është homogjenizu rreth qëllimeve madhore për me mbrojt kombin, për me avancu kombin.

Kështu edhe te na ka ndodh i njejt send, '89-shi, '90-shi na edhe ata të gjithë u bashkum rreth një ideje se s'dojmë me nejt me Serbinë edhe kjo ka qenë e qartë. Deri në '89-shin hala ka pasë kësi njëfarë shance, për shembull kur e patën, kur janë majt demonstratat këto marshet në Kosovë si... Serbia organizojke qisi mitingje t'mdhaja nëpër krejt Jugosllavinë e Serbinë, e Ushqe. Kosova në t'njejtën kohë në Ushqe thojshin janë mbledhë një milion vetë, Ushqe është në Beograd të ri, në Beograd është.

Kosova ka reagu me kundër marshe. Prej t'gjitha qyteteve janë nisën njerëzit gjysë t'organizun, t'organizun prej fabrikave e kshtu deri në Prishtinë kanë ecë, prej Gjakovës, prej Prizrenit, prej Mitrovicës e krejt edhe u mledhshin këtu me mbrojtë atë kohë udhëheqësinë e Kosovës se dojshin me zor me e hek Azem Vllasin që ka qenë edhe Kaqusha Jasharin, m'i hjek prej pushtetit e me instalu dikond tjetër ata.

Këta arritën me e bo, po njifarë dore në atë demonstratë për herë t'parë e ke pa që e kanë lidh bashë ata flamurin tonë të Kosovës me ate qysh ka qenë atje u pat' bo njifarë kompromisi me e pasë na këtë flamurin si të Shqipnisë, këta që e kemi shqiponjën dy krenare, por yllin ia kemi rritë. Kosova e ka pasë ma t'madhe se të Shqipnisë nji yll e i thojshin ylli i Azem Vllasit, se ai ia ka pasë ngjit me dallu prej atyne, mos me qenë. Mirëpo, ata në ato demonstrata simbolikisht e lidhshin me flamurin e Jugosllavisë, jo të Serbisë ose edhe me fotografi Titos. Kanë pas dalë atëherë punëtorët e këta.

Edhe disa njerëz t'mençem në Beograd, si Koça Popoviq e këta, nji ish Ministër i Jashtëm i Serbisë edhe kështu i Jugosllavisë, ata thojshin, "Shqiptarët, ne mundemi me u bo me i lidhë me Jugosllavinë, por jo me Serbinë", a din, kjo ka qenë momenti i fundit kur hala ata kanë pasë kësi.... Ata udhëheqësia pak ma e moderume e Kosovës me Kaqusha Jasharin e Azem Vllasin, ata provojsin me e shit këtë idenë se munem me mbetë me Jugosllavinë. Atëherë u prish edhe kjo, shqiptarët dulën edhe prej, ata që kanë qenë në lidhjen komuniste nashta kanë mbetë edhe disa veta, por të gjithë u homogjenizun edhe Jugosllavia faktikisht s'ka pasë shanca me mbijetu në ato rrethana edhe në këtë presionin që e bojke Serbia për me imponu zgjedhje.

Domethënë në atë situatë që vet Serbia e provokojke, domethanë e nxitke njifarë... shtjellimin e asaj krize Jugosllave, ka pasë provu me e bo njifarë, nji nji si t'them ashtu, gati si puç ose me pushtu në mënyrë ilegale shumicën në kryesinë e Jugosllavisë se kanë qenë tetë njësi. Tre kanë qenë kundër ndryshimeve të kushtetutës e krejt me mbetë Jugosllavia ashtu qysh ka qenë në '74-shin, kurse me Serbinë atëherë kanë qenë kjo Sllovenia, Kroacia, Maqedonia kundër, kurse Bosnja ka qenë pikëpytje. A Serbia pat' marrë këtë, e ka pasë Vojvodinën e ka pasë n'kontrollë, Kosovën e ndrroi e qiti atë strategjinë e futi njifarë figure, gogoli, Sejda Bajramoviq, kot njifarë njeri me e përfaqësu Kosovën që s'ka qenë as i zgjedhur as, e pytja ka qenë... Malin e Zi e kanë pasë tre, janë katër, po Bosnja, kanë shpresu te Bosnja, se në atë kohë kryetar ka qenë ni serb i Bosnjës, njifarë Bogiq Mogiçeviq, po ai nuk e votoi edhe mbetën katër-katër.

Kanë majt disa seanca të kryesisë të Jugosllavisë edhe nuk arritën me e bo. Nashta kanë mendu edhe me bo naj puç ushtarak po ajo kish pasë jehonë shumë të keqe në qarqet ndërkombëtare, s'kanë guxu. Masnej kanë shku me skenare tjera, separatizëm nifarë dore. Serbia, në të vërtetë atëherë e para i ka aprovu komplet ligjet që e pavarësojnë ato prej Jugosllavisë edhe ndryshimi i kushtetutës ka qenë i asaj natyre pasi që është ndrru, e imponun ndryshimin e Kushtetutes të Kosovës atëherë e patën përgadit vetën që t'jenë shtet i pavarur mirëpo në teren punojshin që me kryengritjet e Serbëve në Kroaci dhe në Bosnje ta zgjanojmë dhe të krijojmë një Serbi të Madhe, po kjo mandej nuk i ka funksionu. Tash s'di çka me fol.

Aurela Kadriu: N'cilin vit, a u mshel "Fjala" bashkë me gazetatat tjera, po mendoj me institucionet?

Shkëlzen Maliqi: “Fjala” nuk është mshel, po unë një vjet e kam udhëheq “Fjalën”. Pas një vjeti bojshin shumë presione e sene, m’i hjekshin, për shembull dy faqe. Natën, ajo cenzura e natës, vijke edhe thojke, “T’i kanë hek” ose e ndalojshin botimin. Ma vonë e pata vendos me dhanë dorëheqje, por nuk ma pranojshin kështu, por e botova mandej dorëheqjen e bona si ilustrim, fotografi. E qita në mes ilustrimeve, se s’kisha kështu, nuk ma lejshin me botu. Po ata atje punëtorët e shtypshkronjës, do i kanë pasë shprijunat ata edhe ashtu e lexojshin tu i shtyp ajo del, roto kanë qenë. Dikush e ka pa e kanë lajmëru krejt, u shtyp komplet, e kanë hjek qat’ ilustrimin edhe e kanë rishtyp. Kur dul nesër n’shtyp s’kishte... po unë e pata marrë ni grusht asi e kam edhe atë numrin e [gazetës] me dorëheqjen time.

Mandej nuk isha ma kryeredaktor, m’lanë edhe pak në redaksi. Ajo ka vazhdu me dalë deri diku, po kur u mbyll e gjithë, “Rilindja” kur u ndalu me 1993-shin atëherë u ndërpre për ni periudhë. Ma vonë e lejun, po tash si Graçanicë e shpallën aty, lejojshin “Rilindjen” ma jo, u botojke si “Bujku”, e murr rolin e “Rilindjes”. “Bujku” ka qenë ni gazetë për bujqësi. “Zëri” e ka pasë njifarë statusi si të veçantë edhe ajo vazhdoj me dalë edhe do publikime tjera. Po, ajo ka qenë veç vitet kur këtu u ngushtu autonomia edhe e lejojshin ato sa për sy e faqe me pasë argument kur u ankojshin amerikanët ose këta t’hujt, “Çka po ju boni ktyne?” “Po jo bre, a p’e sheh ata e kanë shtypin po botojnë çka po dojnë. Qe po na shajn neve këtu”. Përnime na kemi qenë t’lirë nuk e cenzurojshim, mujshim me botu çka t’dojmë.

Kaltrina Krasniqi: Qysh kanë qenë vitet e ‘90-a për ty?

Shkëlzen Maliqi: Fundi i ‘80-tave fillimi i ‘90-ave ka qenë shumë, t’them ashtu, intenzive kanë qenë se shumë ngjarje edhe atëherë gati plotësisht u futëm në politikë. Në ‘89-shin, neve e kemi pasë krejt vitin prej shkurtit deri n’vjeshtë dikund shumë t’randë, sepse kur u këputen qato masat e fundit të jashtëzakonshme u burgosën dikun n’fillim të, n’fund të shkurtit ose n’fillim t’marsit, nja katërqind intelektual e do figura kështu. I patën çu në izolim edhe i kanë rrah në Vranje, e dikun këto burgjet e Serbisë edhe këtu gati u fashit krejt skena mbeti pa za. Ishin ndalu këto tubimet publike në fund të... Tash s’e di a e kam kronologjinë n’rregull a jo, po mirëpo ‘89-shin në Jugosllavi ishte pak ndryshe se fillun...

Ra sistemi komunist, në të vërtetë, Partia Komuniste e Jugosllavisë është shpërbë në janar ‘89-shin, dështoi qajo farë kongresi i fundit i Partisë Komuniste. Sllovenët dolën e lanë edhe u prish. Tash shteti mbeti, po si figurant u majshin mledhjet e kryetarëve të republikave nuk u morrën vesh kurgjo. Kurse në fund të ‘89-shit... e duhet pak me asi... po n’rregull jam. Jo në fund të ‘89-shit, po n’fund të ‘88-shit n’mledhje me nivel jugosllav edhe unë kam qenë si përfaqësues i Kosovës me ndihmën ose me organizimin e Ambasadës Amerikane, i kemi pasë nisë do konsulta në Zagreb me kriju njifarë platforme si me dalë prej krizës që u pat’ fut Jugosllavia. E kemi pasë njifarë konsulte në Zagreb dikund në nëntor, dikush ka qenë njifarë Branko Horvat, profesor ekonomist i Zagrebit në atë grup, edhe kanë qenë do prej Sarajevës, prej Zagrebit, Beogradit, e krejt, Lublanës.

Horvati në të vërtetë e kishte një ide që Jugosllavia me u rikostruu edhe me u bo sistem dypartiak. Ai thojke, “Lidhja Socialiste me u shndërru në parti, që i bon konkurrencë...” njifarë ideje ishte gati si bajate, por ai u mundojke formën qysh me legalizu. Ne tjetër edhe këta sllovenët si ma t’zëshëm që duhet me nisë diçka një organizatë, domethanë një organizim ashtu që lufton për demokratizimin e Jugosllavisë. Nuk dojshin me bo parti politike po qishtu.... Edhe aty u morëm vesh që të organizohet mas një kohe, ka qenë me 2 shkurt më duket shkurt të vitit 1990 në Zagreb është majt ky farë kongresi

ose mledhja themeluese, njifarë organizate që është qujt *UJDI, Uruženje Jugoslavenska Demokratska Inicijativa*, domethanë Shoqata për Demokratizimin e Jugosllavisë qishte njifarë shoqate. Njiqind nënshkrus i ka pasë, prej Kosovës kemi qenë unë edhe Muhamedin Kullashi, e qashtu.

Ajo organizatë neve është dashtë me 20 shkurt me majt mbledhjen këtu, me formu degën këtu. Në vendet tjera ndërkohë u bo edhe... ajo ka qenë njifarë organizate që nxiti procesin e themelimit të partive në vendet tjera, këto nuk mujshin me ndalu se ishte shoqatë po mbetëm në Slloveni Partia Social Demokrate u kriju vet e ka shpall e ka bo. Ama te na e patën organizu krejt, ato tubimin i patëm thirr njerëzit po atë ditë pat nisë greva në Trepçë kur hyjnë minatorët, une e pata organizu me disa veta të... ka qenë ni barakë atje afër, tash ku është Lidhja e Shkrimtarëve, baraka e Bashkësisë Kulturore Arsimore të Kosovës ku punojsha une. E kom pasë nij sallë t'vogël i pata thirrë shumë veta, figura t'politikës që njihen edhe ka qenë ndoshta tubimi i parë publik.

Në të vërtetë para kësaj ia patëm nisë në Fakultetin Filozofik me i mbajt do tribuna mas njo gjashtë mujve, mas qasaj kur kërkush s'ka bo, provum me e bo nji tribunë për gjendjen në Jugosllavi e diçka kështu. Bile unë pata shku me fol, nuk na ngucën domethënë edhe ashtu u bo situata që nuk mujshim me prit, duhet me pasë diçka, me e pasë ni trup që t'përfaqëson. I vetmi në '89-tën që ka funksionu ka qenë Ibrahim Rugova si kryetar i shoqatës. Nuk ka pasë adresë tjetër që dikush ka pranë që pranojke me folë. Unë si individ kom folë shpesh për BBC kur vishin gazetarët e huj, por nuk e ka pasë peshën. Ama Ibrahim Rugova ishte Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, kur jepke deklarata politike ai e merrke "*Schpiegel*", e merrke krejt bota edhe Beogradi masnej e shajke (qeshë) vetvetiu, ishte i vetmi, këta tjetër edhe s'guxojshin me fol se u tutshin prej pasojave.

Pjesa e Gjashtë

Shkëlzen Maliqi: Neve në vjeshtë të atij viti, '89, e pamë të udhës që me nisë megjithatë përgaditjet që me bo këtë *UJDI*-in, këtë farë Organizatën per Demokratizimin e Jugosllavisë, degën në Prishtinë. Dhe në dhjetor e ftumë njërin, erdhi edhe kryetari i atëhershëm i kësaj organizare, Zharko Puhovski prej Zagrebit edhe mysafirë tjerë. Unë e pata marrë një sallë në, në, atëherë në Boro Ramiz, në Pallatin e Rinisë, që osht' dashtë me pagu 200 marka, me pagu. Por disi dyshojsha që ndoshta që ka qenë e shtune, noshta e gjejmë mbyllun, a din. Se u dashtë edhe me paraqitë tubimin e krejt, në rregull ishte krejt, e paraqita, e çova letrën, e pagova.

Por diqysh dyshojsha se nuk na çelin, a din, na bojnë farë obstrukcioni. E pata pytë atëherë Ibrahim Rugovën që ishte krytar i Shoqatës të Shkrimtarëve, afër Boro e Ramizit osht' selia e Shoqatës, nja dyqind-treqind metra, "Nëse s'na çelin, a mujna me ardhë te Shoqata, me qenë ajo hapur, qaty ta inagurojmë?" Se ishte me randësi me bo diçka. Edhe qashtu ndodhi, kur shkumë aty krejt dyrët e mbyllura, as jashtë, nuk mujshim as me iu afriu sallës. Manej shkumë te Shoqata, aty e mbajtëm mledhjen.

Patën ardhë edhe do serb n'lokal sepse ata insistojshin prej Sarajevës a diçka, Darinka Jerviq, a diçka, e njifarë Ismet Markoviqi, "A munden edhe ata me qenë se dojmë me qenë multi-etnike?" "Po mirë de,

le t'vijne". Po ata manej nisën me folë, me pytë, "Kush është..." A din se e patëm bo njëfarë fletë regjistrimi, "Ndëgjoni kush është aty antarësim, ta kqyri a po antarsohem edhe une". Edhe nisi me lexu aty me emna, i pari ishte Ali Podrimja (qeshë). E ngucsha për këtë manej gjithmonë për këta, thashë, "Ti je demokrat i parë i Kosovës" (qeshë).

Ashtu, ata nuk u pajtun me hy, as Rugova s'deshi me hy në atë mbledhje, por ishte aty prezent. Do tjerët jonë antarësu, çka po di, Bujar Bukoshi, e kështu.... Edhe aty, thjeshtë u themelu ajo u bë njëfarë kryesie edhe u ba një organ i parë. Por ajo i trimëroi edhe tjerët m'u përga... bile kur e përgaditshim neve këtë mbledhje ato i bojshim te kafiteria "Elida" në "Boro Ramiz" mrenda. Gjatë ditës aty u mbledhshim edhe bojshim plane çka me bo.

Edhe tash kur e përgaditshim neve këtë, këtë organizatën tonë, qet farë UJDI-in, ishin këta Jusuf Buxhovi e do të "Rilindjës", thojshin, "Pse pe bojmë këta Jugosllave, ta bojmë njo tonën". Unë thashë, "Okej, mirë është edhe a din me bo diçka, një organizatë t'ktuhit, por kam frikë se nuk ju ndalojnë, ju ndalojnë... Dhe kjo osht' organizatë që veç ekziston, edhe duhet me pasë dikush që flet pak në emër të Kosovës ose angazhohet për një platformë që është okej njëfarë dore për atë moment". Edhe ata vazhdun, dhe ata ishin mandej themeluesit e LDK-së, pak ma vonë.

E kështu, kur bëmë neve këtë organizatën, mas nja dhjetë ditëve u themelu edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, që ka qenë shumë, edhe ajo ka luftë rolin shumë t'rëndësishëm. Mas një jave dikund me 20 më duket dhjetor... Neve e kem pasë mbajtë 9 dhjetor këtë mbledhjen e UJDI-it, mrena dy jave, mandej tri jave u themelunë edhe dy organizata tjera. LDK-ja kjo ka qenë sukses i plotë menjherë. Ata nisën me, ja majshin qesi konferenca për shtyp. Ibrahim Rugova për fat u zgjodh kryetar, edhe pse s'ka qenë diqysh i parapamë, por me që krejt organizimet i bojshim aty te Shoqata e Shkrimtarëve mas asaj.... Këta themeluesit e, iniciatorët e Lidhjes Demokratike, e kanë thirrë edhe Rugovën aty, dhe prej disa kandidatëve ai n'fund doli si i vetmi që i plotësonte krejt kriteret e kështu, edhe e kanë refuzu ose s'kanë qenë t'sigurtë.

Mandej kur i majshin ata çdo javë ato mledhjet, menjëherë bojshin jehonë, krejt gazetarët u mbledhshin aty edhe tonat, edhe Këshilli i Drejtave të Njeriut ka qenë shumë... se kriza ka qenë në kulm në Jugosllavi, edhe këtu. Atëherë ky Jusuf Buxhovi ka qenë sekretar i part... i asaj, mbledhjet i mbajshin serbisht, se gazetarët ishin kryesisht të Jugosllavisë, të qendrave Jugosllave {pin ujë}. Çdo mledhje folke, e niske me një fjali, thojke, "*Imam jedna radosna vest*" (qeshin). "E kom një lajm të gëzushëm, i kemi bo 100.000 anëtarë". Mas një jave thojke 200.000, tani mrrini deri 700.000, dikun ka fundi i janarit.

E neve në "Elidë" vazhdojshim me nejtë edhe me diskutu, a din një ditë rrishim aty me Gani Bobin, Rexhep Ismailin, s'di kush ka qenë tjetër, ndoshta Isuf Berisha, njëfarë shoqnie. Gani Bobi tha, "Kqyri bre këta u bonën si ata, ajo partia e, e, e, si Radio Erevani", tha (qeshë). Se prej një sistemi një partiak, tash krejt kalun n'atë partinë tjetër, prapë tash partia ka qenë (qeshë)... Tha, "A t'nisim me bo do parti..." thashë, "do parti normale me ia bo pak konkurencën, se këta u bonë 700.000 s'meti mo", a din.... Përnime, pak si hajgare, pak... por, jo Gani Bobi nisi me na dhonë do si detyra. E shifke aty përballë e kishte Hifzi Islamin, "Hifzi, ti je selak, ki me bo partinë fshatare" (qeshin). "Ti Xen..." Për mu

thojke, “M’dukesh si social demokrat” (qeshin). “A pajtohesh?” “Po”. E qashtu pak si, gjysë hajgare, gjysë serioze, po përnime ishte momenti me nisë diçka.

E qashtu nisëm me bo do parti. Une e bona me Muhamedinin, me do shokë tjerë me Arbën Xhaferin. Edhe Fehmi Agani na ka ndihmu shumë, se edhe ai me bindje ishte pak si ma social-demokrat, a te LDK-ja ishte, ajo ishte parti kombëtare. Por, e kuptojke rëndësinë me pasë pluralizëm, jo prej një partisë komuniste krejt me kalu në këtë tjetrën. Për nja dy-tri javë u themelun ato partitë në janar, në shkurt të vitit 1990. Edhe m’duket e kem pasë majtë me 10 shkurt partinë, këtë themelimin e Partisë Social-Demokrate, e patëm zgjedhë Muhamedinin kryetar. Unë nuk dojsa kërkun me qenë kryetar, as te *UJDI*, as këtu. Te *UJDI* e bomë Veton Surroin, e këtu Muhamedinin. Po Muhamedini mas një kohe shkoi në Paris diçka si n’qëndrim shkurtë, edhe mbeti krejt. Mandej diqysh unë u bona si kryetar për një periudhë...

Aurela Kadriu: Përnime krejt qito parti vetëm për hirë t’efektit a...

Shkëlzen Maliqi: Po edhe për efektit, po edhe përnime i bomë, po jo...

Aurela Kadriu: Po de, po a kish përmbajtje a...

Shkëlzen Maliqi: Amo jo, kish përmbajtje, kish përmbajtje se nuk... po mendoj ndoshta kish funksionu edhe ashtu, por njëfarë dore edhe ata u bonë njëfarë kaste n’veti LDK-ja, edhe vështirë pranojshin dikënd tjetër. Edhe kishte zëra të ndryshëm edhe dojsim përnime me bo njëfarë, një, një skenë plurale. Ma vonë u bo edhe Partia Demokristiane, iniciatorë kanë qenë, ka qenë Mark, jo Mark Krasniqi s’ka qenë atëherë, ka qenë ky, një tjetër {pin ujë}, Lazëri, Lazëri Krasniqi. Edhe... bile edhe unë kom marrë pjesë në çdo mbledhje kur e bojke Partia Social Demokrate, në kuptimin se duhet me pasë krejt spektrin, djathta...

Te Demokristianët është interesant që ata pak ma vonë kanë nisë, dikun në mars të vitit 1990, e bojshin një konsultë edhe m’thirrke mu Lazëri... Aty ky Mark Krasniqi që ma vonë ka me qenë kryetar shumë vjeçar i asaj partie, po atëherë nuk ishte. Ai thojke, “Nuk bo me bo këtë parti, se na futë përçarjen fetare”. Unë ndëgjojsha në fillim tani i thashë, “Kjo ka qenë ndoshta situatë para njëqind vjetëve a diçka, po tash është mirë. Neve kemi pakicë këtu të krishterë, katolik, thjeshtë me pasë ata një subjekt, munden me qenë pjesë e asaj edhe ata që nuk jonë katolik”. Edhe përnime, qashtu edhe e patëm formulë, se ka qenë Abdullah Karajgliu nënkryetar e edhe do tjetër në atë parti.

Po thashë është si kjo parti jonë Social Demokrate, e vogël është, por i kem atje motrat e, partitë motra t’mdhaja nëpër Evropë, na thërrasin për darsëm e për (qeshë)... E këta tash me randësi është Demokristiane edhe në Jugosllavi, i kanë kontaktet e mira me Kroaci e me krejt, mirë osht’ me pasë asi, edhe një zë ma shumë që na ndigjon dikund jashtë. Se Demokristianët edhe këta në Itali kanë qenë t’fortë, në Gjermani kanë qenë partite fetaro - ideologjike, nuk domethonë ajo nuk është vetëm... Edhe mirë diqysh kaloi ajo, kështu.

Por kjo na mundësoi mandej me kriju edhe një trup pak ma t'gjanë, që këtë Këshillin e Partive, Këshillin e Partive, Këshillin e Partive në Kosovë {pin ujë}, edhe një Këshill ma t'gjanë, të Partive të Shqiptarëve në Jugosllavi. Domethonë, aty vishin edhe këta të Preshevës edhe Maqedonisë edhe të Malit të Zi. Dy këshilla i kanë pasë bo në atë kohë, se hala nuk u pat' shkatërru Jugosllavia, edhe atëherë i patën formulë ato tri opsione, nëse Jugosllavia riorganizohet si federatë, këto partitë, kanë qenë nja nontë a dhjetë, nontë a dhjetë kështu bashkë krejt, në Kosovë ishin vetëm pesë. Atëhere kërkojmë që të krijohet një republikë e shqiptarëve në Jugosllavi, me Malin e Zi, shqiptarët e Malit të Zi edhe Maqedonisë nëse, jo... nëse riorganizohet, jo, e para ka qenë nëse mbetet Jugosllavia, mbetet Jugosllavia si kompozitë, republika e Kosovës si pjesë e, Republika e shtatë, e Vojvodinës s'ishim neve që (qeshë)...

Nëse riorganizohet në baza etnike atëherë me bo këtë njësinë e përbashkët të shqiptarëve në Jugosllavi me asi, me integru neve, shqiptarët e Maqedonisë... Edhe opsioni i tretë nëse prishet krejt Jugosllavia mu bashku me Shqipërinë. Ka qenë... dikush i qeshke, dikush jo, po qashtu kanë qenë asi si njëfar, opsione të hapura. Neve e kemi pasë provu atëherë në të njejtën kohë gati, me Veton Surroin e me disa tjerë, bile me Fehmi Aganin, me formu edhe një forum demokratik, si formë alternative, se shumë morri krah, tepër shumë LDK-ja edhe pak ishin... e bllokojshin këto, njëfarë afrimi me, e, e do njerëzve që kanë qenë shumë t'randësishëm, po nuk gjejshin vend as në LDK, as nëpër parti.

Mendojshim me bo njëfarë forumi sipas modelit të Forumit Demokratik të Çekisë e do vendeve tjera, edhe me i bashku të gjitha forcat të përbashkëta edhe me bo... sepse nga ana tjetër Qosja me disa faktorë tjerë, Demaçi e këta, ata në të njejtën kohë thirrshin do mledhje, ku merrshin pjesë edhe këta të LDK-së me bo Këshillin e Çlirimit Nacional, si organ kryesor i Lëvizjes Shqiptare në Kosovë.

Kaltrina Krasniqi: Çka domethonë ajo?

Shkëlzen Maliqi: Këshilli. Domethonë me qenë...

Kaltrina Krasniqi: Po e kuptoj, po e kuptoj. Po çka osht' këshilli?

Shkëlzen Maliqi: Po ata thojshin që LDK-ja është parti, LDK-ja u deklarojke edhe si parti edhe si lëvizje. Mirëpo, nuk mujke me i integru disa njerëz që se durojshin Rugovën ose çka po di ose Fehmi Aganin, si Qosja. E tash ata thojshin, "Jo..." Nuk ka qenë vetëm Qosja, kanë qenë shumë veta, edhe këta Stavilecët e do tjerë, u mbledhshin ka njëzet veta me diskutu për qita. Por nuk kaloi, u banë disa platforma diçka, por nuk kaloi. Ky forumi ka qenë pak, pak ma ndryshe. Ma shumë edhe debatike diçka, po ku mundemi edhe me artikulu sende. Ashtu, domethanë {pin ujë}...

Çështja ishte si duhet me organizu si, rezistenca, lëvizja e shqiptarëve këtu, që me qenë sa ma gjithëpërfshise. Ne, sa i përket pjesës institucionale, prapë edhe aty i kemi pasë neve do iniciativa që... në vitin 1990, kemi pranë me, tu e ditë se Millosheviqi po e përgaditë me shpartallu edhe kuvendin e Kosovës edhe qeverinë, edhe krejt, neve kem provu në qershor të vitit 1990, n'fund të qershorit m'duket, jo me 2 korrik ka qenë ose 5... jo, tash datën nuk po m'kujtohet, por kemi provu me bo një mbledhje të madhe për krejt partive të Kosovës, me bo një lloj si kuvendi alternativ, me pesëqind veta.

I kem ftu aty, ku kanë qenë pesë parti, LDK-ja me treqind... Me kuota, s'mujshim em ditë kush osht'... 300 kuota ja kem dhonë asi, Lidhjes Demokartike. Ka qenë Partia Parlamentare me njëqind, ka qenë Demokristianët me 50, neve kem qenë me 50, m'duket se edhe Partia Republikane 50. Qashtu u patëm... Edhe nja 50 për intelektual të pavarur e kështu. U pat majtë ajo mbledhja, çudi që s'po m'kujtohen datat në sallën e kuqe të...

Kaltrina Krasniqi: Boro Ramizit...

Shkëlzen Maliqi: Boro Ramizit, me 500 veta... Jo nuk ka qenë Partia Republikane, po ka qenë Partia e Gjelbërt atëherë, edhe ata e patën pranë. E tash aty u përgditi një, një dokument fillestar, atë e lexoi Mehmet Kraja, aty, para krejt tubimit. Edhe e dishin që po pret për dy-tri ditë a, në atë kohë do të, do të... Ai kuvendi ekzistues do të shpërbëhet, ose do të anulohet nga ana e e Sërbisë. Ne dojshim me pasë një trup tash prej subjekteve të vetëshpallura demokratike që i kishim atje, na njihshin edhe faktorët ndërkombëtar, me bo njifarë...

Edhe krejt kaloi ai tubimi mirë. Nuk e zgjatëm shumë, apllaazë e krejt. Të nesërmën LDK-ja edhe vet Mehmet Kraja e shkronë një artikull kundër saj për një asi, vetëm për një arsye, se në atë, në atë mbledhje osht' poshtu kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova. Sepse ai ka qenë aty në rreshtin e këtyne kryetarëve, krejt kem qenë qaty, edhe une me social-demokratët, e këtu, e këtu... por fjalën kryesore e ka pasë Veton Surroi. Veton Surroi si njëri prej organizatorëve të kësaj, edhe pak ma i ri, e ka marrë funksionin e atij konferencieri... E hapë, e mledhë, e kështu diçka. Dhe atyne ju, ju, atyne ju ka kriju përshtyja, disave në LDK, ndoshta edhe vet Krajës, Kraja vetë e ka lexu atë që...

E këto janë kështu, njifarë dore tregon edhe për marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe smirat që i kanë shqipraët në këto momentet e kyçe të rëndësishme. Kështu që prej kësaj nuk doli shumë. Për fat nuk kemi pasë nevojë për këtë, se megjithatë ai kuvendi jonë u shpartallu, por ikën ata në, masi që e shpallën në Kaçanik republikën e Kosovës, ikën në përfundim, në... në fillim mandej kur ishte Jugosllavia, në Zagreb edhe në Lublanë, ma vonë në botë, e kështu. E patën, vazhdoi edhe ajo qeveria në ekzil e Kosovës që... Domethënë neve kishim idenë se atë far strukturën institucionale që e ka pasë Kosova në ish-Jugosllavi ka qenë njifarë dore e vleshme me rujtë, me avancu, me rujtë, me bo pjesë të sistemit plural.

Kurse këta të LDK-së shpesh e merrshin me nënçmim, "Çka na duhet? Ata jonë kumunista, s'na duhen". A din, kështu {pin ujë}... Por, mandej, ma vonë LDK-ja praktikisht e morri krejt n'dorë, nuk... E kontrollojshin edhe ata tre përqindëshin, e krejt këto asi. Gjatë kem pasë marrëveshjen me Këshillin koordinues që edhe partitë e vogla t'ndihmohen, ta kenë një zyre ose diçka. Por nuk i, nuk na, nuk ia kishin... është dashtë vetë m'u gjind disi.

Kjo ka pasë kuptim në fillim, për mu personalisht për me... e kom udhëheqë atë partinë deri në dymijë e... njëmijë e nantëqind e... Në fund të '93-shit. Ndërkohë i patëm ko-optu Luljeta Pula Beqirin edhe Kaqusha Jasharin si, me qenë në, në kryesi. Luljeta Pulën e zgjodhëm edhe kryetare, se për mu kishin vërejtje këta të partisë se jom shumë liberal ose punoj kundër interesave të partisë. Me njëfarë, me një

moment ka qenë njëfarë, m'doket në vjeshtë të '93-shit, pata dalë unë në do intervista në Beograd, kur u përgadishin zgjedhjet në Serbi unë thashë se shqiptarët ndoshta duhet me mendu me dalë në zgjedhje në Serbi, me zgjanu spektrin e rezistencës. Tu e nisë prej përvojës të irlandezëve diçka që kanë pasë gjatë, krahun e luftës, krahun parlamentar që me pasë të njejtin qëllim.

Edhe kjo idea s'ka qenë vetëm e imja, por edhe, në të vërtetë e Gani Bobit. Gani Bobin e kemi pasë si njëfarë mentori, ai ka qenë njeri i qetë, i mirë, por shumë... ai thojke, "Çka u bo kjo LDK-ja, e këto... Me asi, metëm reziste... ta zgjanojmë, të çojmë do njerëz se, që me idenë e pavarësisë të Kosovës t'shkojmë të argumentojmë për to çdo ditë, i bëjmë nervoz ata serbët aty edhe..." Une e plasova këto. Por, aty në atë mledhje unë thojsha me shku si grup i pavarun, jo, domethonë nuk e kompromiton kërkon, domethonë osht' njëfarë angazhimi personal që... ose i njëfarë grupi.

Po thojshin, i thosha, Gani, "A kishe kandidu ti?" "Jo, se s, s, so (qeshë) s'o për mu kjo". "Ti nashta kishe mujtë, se ti po shkrunë kështu..." Se ai nuk ka qenë aq i ditës, njeriu që (qeshë) reagon do ditë. E kështu ka qenë, këto kanë qenë si ide. Rastësisht në të njejtën kohë edhe, edhe Veton Surroi kishte shkrujt diçka të ngjashme... Kjo ka ardhë edhe pasojë se këta diplomatët e kështu, na bojshin presion, "Ndihmoni opozitën në Serbi, a din, mos leni..." Se ata, ai... ata u ankojshin edhe opozita në Serbi, këta farë udhëheqësit e këtyra partive tjera jo komuniste, jo të socialiste... Thojshin se ai Millosheviqi po hyn n'zgjedhje me dhjetë përqind përparsie automatikisht. Sepse i fitojke krejt deputetët, 30 të Kosovës, a din, ma shumë se dhjetë përqind jonë ata, 25 sa i kemi pasë. Edhe mandej të gjitha votat i merrke këtu për veti.

Por neve kur folshim edhe me t'hujtë, thojshin, "Por kjo është e pamundur me realizu neve diçka këtu, me ia qitë vota atij kundër Millosheviqit kur ai e kontrollon krejt terrenin, kutitë vot.... Ose e provokon njëfar, një, e provokon ndonjë incident që shqiptarët nuk dalin në vota... nuk dalin në votime". Por si ide okej, mundet mu mendu, nëse vazhdon qaj farë okupimi edhe dhjetë, njëzet vjet, s'mundesh me nejtë pa {pin ujë}... E këta në parti manej m'kritikojshin, "Ti po del n'krye vete..." Jepsha shumë intervista, ja diçka, "Po na dëmton partinë". Partia edhe ashtu kurrë s'ka fitu kurgjo ma shumë se një përqind (qeshë).

Kaltrina Krasniqi: E mandej mas vitit '93?

Shkëlzen Maliqi: Mas vitit '93 une u tërhoqa nga partia dhe Arbën Xhaferi, Arbën Xhaferi shkoi në Maqedoni dhe bëhet shumë i suksesshëm atje. Edhe ma herët e patëm këshillu neve me shku atje, se ai ka qenë i lidhur me Tetovën. Shokët e tij e patën kriju atë farë, qytetarët e Tetovës, e të Gostivarit, kryesisht të Tetovës. Por, e patën zgjedhë një për kryetar të Partisë të Prosperitetit Demokratik një mësues të anglishtës, a din, i katunit ka qenë, se aty rrethina e katunit kanë mendu se ky a din, njëfarë dore... do njerëz që ngurrojnë me hy në politikë, e kështu okej jonë krejt, por ngurrojnë edhe këta qishtu kanë qëllu.

Edhe Arbeni ka qenë qashtu n'fillim, pak me ngurrime asi. Por mandej ai, u zhgënjynë të gjithë ata me atë Nevzat Halimin. Nuk e reprezentojke si duhet asi këtë çështjen, nuk është gjithkush politikan i lindun. Arbëni nihere nuk shkoi, mandej vitin tjetër kur ishte njëfarë kongresi shkoi, por ata edhe u

përçanë edhe u bo njifarë asi... Por, megjithatë ai ka pasë shumë karrierë të suksesshme edhe e ka normalizu pak edhe diskursin edhe organizimin e partisë. Natyrisht se s'ka mujtë me bo çuda, por megjithatë asi... Megjithatë, kemi qenë neve në kontakt me to për asi. Por, ai ka qenë me bindje kështu edhe ai social-demokrat njifarë dore, a din kështu për një shtet social. Ama në kushtet atë kohë nuk lejoshin që as të mendosh për, për benefite sociale ose me m'mbajtë sistemin edhe ashtu qysh ka qenë i mëparshem, jo aq perfekt por me gjithatë ka qenë shtet social Jugosllavia.

Por, kjo shkatërrimi i socializmit dhe ky instalimi i kësaj modeleve neo-liberale të shtetit, privatizimi asi edhe kursimet për, për të dhanjet sociale për pensione, për shëndetësi e kështu kanë qenë të tmerrshme. Neve kur e patëm bo Partinë Social-demokrate, kur e kqyrshim çka munëm me realizu prej programit tonë, metke zero, a din, gati zero, kurgjo. Veç mu kujdesë eventualisht për, për ata punëtorët që kanë humbë punën, për ato u bojke sindikata e atyne. Edhe ashtu që... kurse me programin nacional s'mujsh me i konkuru askujt. Ajo okej ka qenë me, me luftu për t'drejtat e shqiptarëve por ato i përfaqësojke dikush tjetër. Ende edhe sot është pak a shumë kështu (qeshë) sa i përket mundësive që me e kriju shtetin social edhe pse {pin ujë} tash megjithatë s'paku munesh me i shty, me i shtru do çështje, rreth pensioneve ose përmirësimit të sistemit shëndetësorë e e kështu.

Aurela Kadriu: Qysh ndodhë n'qato vjet që në njëfarë forme ju vendosni me u bo zani i artikulum kritik i artistëve pamor, plotë artistë pamor...

Shkëlzen Maliqi: Ah, jo kështu. Unë domethonë kom qenë edhe shumë i involvuar në politikë edhe kur u dorëheqa prej, asi, prej kësaj, prej partisë, atëherë mu hap mundësia ma shumë me qenë, me bo, me hy në Fondacionin SOROS. Unë edhe ashtu prej fillimit kom qenë në atë fondacion si anëtar i bordit në Beograd kur ka qenë për, fondacioni për mbetjen e Jugosllavisë, se Kroacia edhe Sllovenia kanë pasë dalë. Kom qenë në bord por tash mbeta edhe pa punë edhe ato themeluesit edhe të fondacionit të Jugosllavisë Sonja Licht e kom pasë edhe si shoqe të studimeve. Edhe unë i thashë, "Kisha kalu nëpër programe me punu". Për rrogë, se s'kisha shume kritika, përpara mujsha me mbijetu se shkrujsha për gazetat e Sllovenisë ose kom qenë korrespondent i disa radiove, Radio Berlini, diçka prej... edhe për Radio International e kështu edhe merrsha do honorare, por sidomos sllovenët pagujshin mirë se çdo javë shkrujsha.

Po mandej meta pa ato lekë edhe këtu nisi fundacioni i madh e kështu... problem ka qenë me mbijetu. Atëhere hyna aty me punu, rroga nuk ka qenë e madhe, nja 700 marka, po me gjithëatë mujsh me mbijetu. Prapë do honorare i kisha prej do... edhe aty i kom marrë domethënë shumë programe aktive, ndër to edhe kulturën dhe artin, mediat edhe kështu. Edhe si SOROS n'atë kohë kem ndihmu organizimin e shoqnisë civile, edhe ktyne aktiviteteve që patën nisë në kulturë mu, me nisë njifarë, me gjallnu kjo, kjo trevë. Ata, Soros pa u bo unë pjesë e saj na ka pasë ndihmu me u botu disa numra të revistës të Shoqatës të Filozofëve, ka qenë njo "Thema". Ma vonë kom nisë me u botu me disa intelektualë t'ri këtu në revistën "MM", domethonë dy "M", kjo ka qenë me shkronja, me numratorin latin dymijshi domethonë e kem mendu mileniumin e tretë si njifarë shprese që kur mundëm me dalë, edhe qashtu ndodhi (qeshë). Jo që ka qenë paralajmëruse por njifarë (kollitet)...

Edhe kështu kultura ka qenë gjithmonë ma, ma përpara se politika. Edhe ma herët, te “Fjala” kur u pata dorëheqë nisa me me shkrujtë për... ata m’thojshin... një, një, s’di qysh e pat’ emrin, një albanolog atje, kryeredator, m’thojke, “Cilin sektor don me majtë ti?” Unë thashë... nejta nja tre-katër mujë aty, thashë, “Atëherë, po shkruj për kulturë dhe art, për ekspozita e kështu...” Pata nisë me shkrujt. Po kam qenë unë edhe, kur kam qenë në Beograd i afërt me qarqet artistike, bile edhe të them me avant-gardët e asaj kohës, me këta artistat konceptual të Beogradit, shumicën e tyre i kom pasë edhe shokë të afërt. E kom njoftë mirë edhe këtë Marina Abramoviç, që o bo prej këtyne edhe ma e famshmja në botë. Edhe kom pasë shkrujt disa, dy artikuj t’shkurt, më shumë për në buletin e festivalit për më vonë u botu edhe në libër. Ashtu që kom qenë afër. Bile edhe atëherë kom pasë idenë me bo do projekte në ato, kanë qenë do, një festival që u mbajtë çdo vjet në prill në “*Aprilski Susreti*”, domethanë Takimet e Prillit në Qendrën Kulturore të Studentëve në Beograd.

Në kuadër domethanë të Soros-it, tash edhe këtu i kom njoftë disa artistë të ri prej ma herët, si Sokol Beqirin, Mehmet Belulin edhe këta. Edhe ata në atë kohë deri sa isha në SOROS vishin për me iu ndihmu me shku dikun jashtë e kështu. Kur u bona une, atëhere n’atë program e shkrujsha për gazetën “Zëri” atëherë, kur u rinovu, kur nisi dalja e tyre në pranëverë të vitit 1994, edhe “Koha” edhe “Zëri” rifilluan. Domethonë, prej Soros-it i ndihmojshim me letër, me do... se nuk kanë pasë.

Kryesisht me fonde t’huja u mbajshin, pak edhe diçka këtu edhe prej shitjes. Për kulturën edhe kështu kur nisi një trend, në ‘94-shin pat’ nisë ni trend me disa artista, nisën me organizu ekspozita nëpër kafiteri. Artistat akademik n’fillim e kqyrshin këtë si shtremt, çka, qysh me hi n’kafe, nuk është... Une e pata shkrujtë një shkrim firmativ, edhe me një titull asi pak si, nashta osht’ dukë pak si bombastik, “Arti i rezistencës” për një ekspozitë të Iliriana Loxhës atëherë, e ka pasë te Gal... te kafe-galeria “Koha”, këtu ka qenë dikun te, përballë “Rilindjes” aty dikun.

Mandej nisën edhe do ekspozita tjera në Pejë, njëfarë kafiterie “*Evergreen*”, edhe në njëfarë qendre ose Multimedia a qysh e ka pasë emrin, jo kjo e Jeton Surroi, e Jeton Neziraj {pin ujë}.

Kaltrina Krasniqi: Jeton Surroi (qesh)

Shkëlzen Maliqi: Edhe ashtu, unë i pata ndihmu ata me fonde, sa kom mujt. Edhe “Dodona” u aktivizu, “Dodona” si “Dodonë”, por edhe si teatër, Faruk Begolli ishte atëhere si drejtor. Dhe atyre jo që ju ndihmojsha me, me lekë, me pare të Soros-it, po ia shkrujsha edhe programin edhe krejt, vetëm këtë farë, ato aplimikin, se ky Faruk Begolli veç m’i bijke ato, sa herë don me organizu, cilat shfaqje ka me përgaditë, veç listën, tha “Unë s’di tjera, ti bomi këto edhe nxjerrmi do pare”, (qeshë) edhe ashtu.

Ma vonë, aty te Dodona afër e gjetëm një hapësirë shumë t’bukur me bo aty si njëfarë Qendre Kulturore t’vogël, një galeri, që është Galeria Dodona. Edhe unë e sigurova atje në Beograd, bordi, te udhëheqësit me dhanë do pare edhe për me meremtu, me rregullu atë hapësirë, u deshke 20 mijë marka me e rregullu. Ka qenë një, si me thanë, shtëpi private. Rastësisht kanë qenë kusherinjët e, e Faruk Begollit, ajo gruja, a ai burri ka qenë njëfarë Stavileci, kusherini im (qeshë). A din, jo i afërt po... Edhe qeshtu u morrëm vesh me ta, e rregulluam atë hapsinë edhe prej janarit ‘97 aty u mbajshin ekspozitat shumë t’bukra. Kanë qenë dy vjet e gjysë, sa ka punu, gati tre, ‘97, ‘98, ‘99 në pranverë u,

s'mujke me u... nisi hallakama, lufta e madhe. E jonë organizu plotë ekspozita kështu të bukra, me kritere... edhe plus i merrshim majshim edhe promovime, aktivitete tjera kulturore...

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë për ty...

Shkëlzen Maliqi: Hë?

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë për ty me qenë jashtë institucioneve?

Shkëlzen Maliqi: Po unë gjithë kam qenë jashtë institucioneve. Ashtu jam rritur edhe atëhere në '78-tën kur jam punësu diqysh... domethonë deri në 35, 36 vjet s'kom punu nëpër institucione, nuk ka qenë kjo najfarë çude e madhe. Në '91-shin, '90-tshin unë pata shku ne Amerikë për gjashtë javë, njëfarë programi e kanë ata special, *Visiting program* [Anglisht - program i vizitave], i thrrasin ka dy-tre mijë vetë nga bota, krejt bota, njerëzit diçka që përfaqsojnë, e premtojnë a diçka. E kanë edhe një listë, kur shkon atje me asi, i shetisin nëpër Amerikë dhe është njëfarë si propagandë. E kur shkon atje, kur t'njoftohesh me ta të tregon, "Këtu ka qenë, çka po di, Willy Brandt si i ri, ose..." Qisi farë sendesh, a din kësi farë, nashta bash jo Willy Bradti, s'ja qëllova, po do figura t'njoftuna, që kanë shku t'ri e mandej jonë bo asi...

E qeshtu ashtu ata zgjedhshin gazetarët e... mu m'patën ftu një herë, qatëhere në të '90-tën me shku, bile një herë m'patën caktu me shku me do gazetarë jugosllav atëherë. Por mandej, atëherë pat' qëllu se une dikun bash në të '90-tën, nashta në janar, pata shku në Zagreb te Shoqata e Studentëve Kosovare atje, njifarë tubmimi a patën organizu atje. Edhe aty e mbajta një fjalim ku pata thonë ashtu, ndër tjera, çka po di e momentin qishtu m'ka pasë ardhë me thonë, "Jugosllavia po shkatërrohet, por kërkesa për republikë nashta nuk osht' edhe ma, ajo që e lyp momenti, po ma shumë bashkimin me Shqipninë..." A din, ashtu, jo, jo, jo si une jom për atë opsion, por unë ma shumë gjithmonë kom folë ose kom shkrujtë për trendet që ekzistojnë.

Natyrisht se me ndodh që, edhe atëherë edhe sot, edhe kurdo, me ndodh që po organizohem edhe m'u deklaruar a me mbetë Kosova e pavarur edhe me u bashku me Shqipninë, unë ma përpara kisha votu m'u bashku me Shqipnin jo njifarë asi.... Se mendoj që megjithatë faktorizimi i shqiptarëve kish qenë ndoshta ma i mirë, se shtet ma i madh, e ma i qëndrueshëm, se sa kështu i coptum. Po okej, ai opsion tjetër, po nuk jom dikush që insiston për këto bash, bash a din. Por, interesant ata, ata i patën përcjellë do gazeta do sene u bë njëfarë aferë e vogël. Por në buletin e ambasadës të, të Amerikës në Beograd atëherë pat' dalë ai farë shënimi diçka kështu. Plus ata e kanë vlerësu diçka, s'di pse, me vijat e veta CIA, a dikush që....

Kaltrina Krasniqi: Edhe shkove në ambasadë?

Shkëlzen Maliqi: Po, po, jo ambasada m'thirri tha, ai farë sekretari i ambasadës që me mu kontaktojke, tash ia kom harru emrin, tha, "Ta kemi ndrru neve ty atë farë programin, nuk ke me shku me grup por vet, edhe ta japim një, një përcjellës, përkthyes e kështu, me ty tanë kohën me qenë. Edhe ta bëjmë një program special". Edhe tash u ulëm neve e bojshim atë programin. Pak ndërrim, por unë e

dija ata se ndoshta interesi me pasë qasi farë njeri që angazhohen për me i bashku shqiptarët (qeshë), po boj hajgare (kollitet). Po qashtu edhe ndodhi, mandej shkova në maj edhe në qershor kom qenë atje gjashtë javë.

Mandej ndodhi që atë ditë kur kom pasë m’u kthy prej atij udhëtimi lufta nisi në Slloveni, e shkurtë ajo që ka qenë nja ni javë. Avionat nuk fluturojshin për asi, mo për Zagreb, se prej Zagrebit u pata nisë. Nejta edhe nja dy jave a tre atje, s’kishte *aviona* [serbisht - aeroplan] mo. Por mas nja tri jave m’thanë ata të Panamit, thanë, “Nëse don mundesh me shku në Mynih, dhe prej aty manej gjeje naj mënyrë me shku në, në Kosovë”. Thash, “Okej, po shkoj në Mynih...” Se edhe Agim Malën e pata taku atëherë në Amerike, edhe familja e tij dojke m’u kthy, edhe ata në Europë dikun, pastaj këtu në Prishtinë. Me gruan dhe fëmijët e tij patëm udhëtu deri në Mynih. Mandej prej Mynihut, ditën e parë, t’nesërmën, masnesër treni i parë shkojke për Lublanë, mas disa jave.

Shkova në Lublanë, prej Lublanës Zagrebi afër. Aty ishte... në Zagreb prapë edhe një javë prita se u ndërpre në edhe trenat, nisi njëfarë lufta e parë në Slloveni, as trenat nuk shkojshin, as avionat për Shkup. Po mas nja një jave diqysh u, thanë se trenat po shkojnë, edhe shkova deri në Shkup qashtu u ktheva, mas nja, një mujë ditë kom nejtë ma shumë se sa që osht’ dashtë.

Kaltrina Krasniqi: Hajde po kthehem prapë në vitin 1997.

Shkëlzen Maliqi: ‘97 isha...

Kaltrina Krasniqi: Domethonë, kur filloi mu organizu njëfarë jete paralele në Prishtinë edhe atje...

Shkëlzen Maliqi: Jo... edhe ‘94, ‘95... Paralele në çdo kuptim. Domethonë ato funksionet elementare të shoqërisë, tregtinë e këto, nuk e prekshin aq shumë këta regjimi, vetëm si i patën marrë disa firma, i përjashtuan prej punës krejt shqiptarët që kanë punu këtu edhe në administratë edhe nëpër fabrika. Por ajo ka qenë jo vetëm në ‘91-shin, shkollat e këto. Kur nisën me organizu shkollat, nisën edhe senet tjera me organizu si n’mënyrë paralele, edhe sporti edhe domethonë... po edhe kultura atëherë nisi me u orgnizu, domethonë qekjo ka qenë njeni prej organizimeve... Une prej SOROS-it, neve u mundojshim me ndihmu me, me u ngritë kjo shoqëria civile. Domethonë i ndihmojshin organizatat e grave, shkollat, e kemi pasë bo në 1996-tën një projekt për, special jashta fondit t’rregullt, dy milion dollar na pat dhonë SOROS-i me i ndihmu shkollat paralele.

Edhe e patëm bo njëfarë programi shumë interesant, po mendoj me disa aspekte të ndihmës, edhe direkt shkollat edhe me i furnizu me paisje, me kompjutera edhe projekti ma i suksesshëm aty ka qenë... dy kanë qenë në të vërtetë, një ka qenë që kemi organziu kurse një mujore të kompjuterave për shkollat e mesme në Kosovë nëpër të gjitha qendrat. Ka qenë koha kur kompjuterizimi u përhap shumë, interneti filloi me u... unë e pata bo atë projekt kështu për një paradite, sepse m’thirrën prej Beogradit, po thotë, m’tha, “SOROS-i po don diqysh me i ndihmu shkollat paralele në Kosovë, a munesh diçka me bo deri sot...” Ka qenë ora nantë a diçka m’ka thirrë, “Deri në dy se osht’ mbledhja në Budabest ku duhet m’u vendosë. Veç” tha “duhet diçka në letër, një faqe e gjysë, dy”.

U ula edhe i mendova do projekte, do i kom pasë mendu edhe kështu po... Edhe qajo, mendova se kto kursi i kompjuterave osht' diçka përgaditje për t'ardhmën se në çdo fushë që do të punon njeriu edhe me qenë kasier a diçka, këto duhej me mësu, këtë farë ekranin, si sot që i kemi këto telefonat mobil, atëherë s'kanë qenë por... Edhe njëfarë dore e fut njëfarë teknologjie t're, se në fillim të '90-tave shumë punë na kanë kry edhe faks makinat. E kom ditë edhe prej revolucionit kinez që kanë qenë njëfarë tentimi me bo njëfarë protestat e mdhaja në Kinë në fund të, dikun në '88-tën a kur kanë qenë ato demonstratat e mdhaja, edhe ata e quajshin nëpër gazeta që ka qenë "Faks Revolucion" përmes faksave është përgaditur rrjeti... e kjo, kjo teknologjia e re ma e avancume osht', mirë osht' me i familiarizu t'ritë s'paku me e prekë kompjuterin, a din.

Se e kisha edhe përvojën teme, se ndoshta ndër t'parët e kom pasë kompjuterin personal prej '87-tës, a '88-tës, a din? E kom pasë një shoqe amerikane Janet Rainik, e kom pasë njoftu atëherë në Beograd kur punojsha si bibliotekist në Fakultetin Filologjik. Si rastësisht u patëm njoftu aty edhe diçka i interesojke Kosova edhe pse kish ardhë për me e vizitu Serbinë, si folkloriste ka qenë. Mandej une e pata çu këtu te familja jeme, e kështu. Mandej ka pasë ardhë këtu e ka bo një studim për muzikën e lojrat në Opojë. Tash çka folsha për...

Kaltrina Krasniqi: Kompjuterin a ta pruni ajo apo...

Shkëlzen Maliqi: Ajo e kryjti këtu njëfarë misioni diçka, nejtj nja një vjet a diçka me qat'here... Edhe kur shkoj aty tha, "E kom një kompjuter IBM t'parë asi, shumë, shumë t'parë, 286" tha, "E kisha shitë për njëqind marka". Thashë, "Ani, qe une po ta marr". Edhe unë punova me to nja një muj ditë, shumë m'u doke fantazi. Problemin kryesor përpara kur kom shkru tekste në letër, si e prishësja naj rresht ose naj diçka, nxjerre krejt letrën {bohët se shkurran në tastierë} prej fillimit (qeshë). E në kompjuter mujsha me u kthy edhe me rregullu aty, ooh u dashurova menjëherë.

Po nuk m'majti ai kompjuter as një muj ditë, u prish diçka, shkojsha te këta, te ky Agron Dida e kështu në fakultet a diçka, ata e kqyrshin si çudë, s'kishin pasë ata... thashë, "Që po ju fali veç a mundesh me ndreqë?" Tha, "Ja s'kemi pjesë, s'kemi diçka... "Hajt mirë..." Ama qëlloi që shkova në Londër menjëherë mas një kohe, ndoshta, njëfarë konference në Londër, ish kështu për do çështje Ballkani, Kosova, çka po di, mbajta njëfarë ligjerate. Edhe aty paret që kisha menjëherë e bleva një kompjuter. E prej atëhershit nuk jom nda mo prej kompjuterit.

Edhe e disha se kjo vlenë shumë edhe ashtu m'duket se ka, ka ndiku shumë ky farë kontakti, se një kohë Kosova ka pri shumë në rajon me shfrytëzimin e kompjuterit. Domethanë, shumica e ka shfrytëzu edhe këta sepse kemi shumë gastarbeitera a diçka, për kontakte a diçka edhe sot kryesisht për Skype e kësi sene.

Kaltrina Krasniqi: Po s'ka lidhje po mendoj, me randësi osht' qe...

Shkëlzen Maliqi: Ky ka qenë njani prej programeve që mendoj se ka qenë shumë i suksesshëm edhe i mirë. Por kemi pasë edhe tjera, njana prej tyne ka qenë edhe këta që ma vonë u bo Qendra "Gani Bobi", se u bo si njëfarë instituti për shkenca sociale a diçka, me do analiza, hulumtime të opinionit e

kështu. Ato menjëherë pas lufte masnena e dhanë *spin off*, thanë, “Pavarësohuni se s’na duheni këtu mrenda SOROS-it”. Kështu, edhe masnej ka pasë disa programe për, atëherë të ‘90-tave vajzat nuk i lejshin n’shumë katunde me shku nëpër shkolla, ka pasë probleme. Edhe pak me punu me ta, me i vetëdijshu se është mirë me vazhdu shkollën por edhe ma dhanë ndihma organizimit, me i pagu autobusat e kështu shembull.... Po mirë ka qenë puna në terren, plus edhe me kurikula, me sende, kem provu të gjitha aspektet e... po mirë ka qenë, domethonë ka qenë një, një diçka e dobishme në atë kohë.

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 23 tetor, 2018]

Pjesa e Shtatë

Kaltrina Krasniqi: Qysh ka qenë viti ‘98, ‘99 për ty? Çfarë atmosfere ka qenë?

Shkëlzen Maliqi: ‘98, ‘99 ato ka qenë... ‘97-ta ka fillu... në ‘97-tën une e kam organizu ni aktivitet tjetër që ka qenë me rëndësi brenda SOROS-it, por edhe jashtë edhe si “Dodona”, e kemi organizu për herë t’parë një ekspozitë të artit bashkëkohor të Kosovës në Beograd në Qendrën për Dekontaminim Kulturor, me disa artistë, domethanë, me ni mbledhje kur bojshim si *briefing*, përgaditje për sezonin e ri. Unë pata thanë, se s’mujsha ku me i çu shumë jashtë artistët nëpër botë tonë, nuk kishte ftesa problem ishte, nuk i njifshin shumë. Sokoli pat’ shku me intervenimin e Gjelosh Gjokaj dikun atje në Ausburg njëfarë ekspozite, por s’kishte mundësia, mundësi, mundësi tjera.

E tash unë thashë, “Hajt ta bojmë brenda Jugosllavisë”, se SOROS-i i Jugosllavisë i ka pasë katër zyre; një në Beograd qendrorën, në Novi Sad, në Podgoricë, në Mal të Zi edhe në Kosovë. Atëherë thashë, “Hajt t’bojmë këmbime mes veti, se kjo ka kuptim tash. Arti është art”. Ma aprovun atje dikun n’janar, mandej mas një dy, tre mujve po thërret Sonja, po thotë, “Ku është projekti i ekspozitës?” Thashë, “Mu nuk m’keni lajmru as që u aprovu as diçka”, thashë, “Okej e përgadisim, po duhet me gjetë dikun që e përgaditë”, ata, “Neve kem mendu që ti e përgadit”, unë thashë, “Okej, po provoj po flas me disa artista”, edhe qashtu masnej u bona kurator.

Fola me do artista Sokoli, Mehmeti, edhe Maksi, ky që e takum. Ata menihere pranun edhe Ilir Bajrin e thirrëm me bo muzikë. Do tjerë, “Po, jo, po, jo”, nuk, nuk, po u morëm me qata që ishin, e bonëm qit’ ekspozitën. Ka dalë shumë e mirë. Edhe ajo njëfarë dore mandej afirmoi këta artista edhe neve e vet skenen, se masnej ia nisën me na thirrë edhe në Shqipni, në Lublanë kishin marrë vesh se këtu ka njëfarë arti interesant në Kosovë, na thirrën në “Onufri”. Mandej n’qershor u mbajt ekspozita në Beograd, na thirrën në Bienale të Cetinjës, atje shkova une me Mehmetin edhe me Sokolin. Mirë, ashtu ka qenë kjo një prej aktivitetëve edhe katalogun e patëm bo t’mirë e kështu.

Kaltrina Krasniqi: Çka ka pasë në ekspozitë?

Shkëlzen Maliqi: A?

Kaltrina Krasniqi: Çka ka pasë në ekspozitë?

Shkëlzen Maliqi: Ekspozita, në ekspozitë ka pasë, kështu objekte edhe instalime edhe objekte kryesisht, edhe disa piktura Maksi që i ka ba, krejt konceptuale. Ky Sokoli i ka pasë do instalime, i ka marrë do kaca ku përpunohet djathi e kështu edhe ia ka bo ni konus prej llamarinës edhe u dokshin si etnobomba, si granata. Ky ka qenë komenti i tij edhe titullin ia patëm bo kështu “Fluturon, fluturon...” I ka pasë edhe do dritare t’vjetra që janë shkul prej ndonjë shtëpie t’vjetër ku i ka gjetë. Mandej aty, i ka fut do, i ka përpunu diqysh mandej edhe te këto etnobombat e këto sendet tjera i lyjke kapak me do ngjyra kësi farë pastele e kështu.

Edhe e ka pasë ni instalim hapësinor që e ka pasë bo këtu në Prishtinë, e ka pasë bo për ni vjetorin e vdekjes të Gani Bobit. Ka pasë *çetri, çetri* unë, m’u përzi me serbisht, {tregon katër gishta} katër vishnje t’njoma, dikush i ka shkul, a din, e ky i ka marr n’shpi i ka majt një kohë. Mandej iu ka kujtu me i ly ato njifarë ngjyre edhe ato pastele. Edhe këtu te Qafa në ni koridor i pat’ ekspozu kështu n’hapsirë, me shënu ni vjetorin e vdekjes të Gani Bobit, edhe ate e ka pasë aty.

Kurse Mehmeti, Mehmet Behluli i ka pasë disa instalime. Ni instalim e ka pasë që iu ka kushtu Sarajevës, 6 prill 1991, kur ka nisë bombardimi i Sarajevës. Aty e ka bo si një dhomë, po kryesisht i mbulojke me zift ato, zi, si ni dhomë e Sarajevës e pak diçka njifarë kujtimi do setra e do orë t’vjetra e kështu. E bukur ka qenë, e ka pasë edhe këtu në ekspozitën te Dodona. E mandej i ka pasë edhe do karriga edhe mbi karriga i ka rendit do libra kështu kryesisht t’komunizmit najfarë Stalin, çka ka gjetë Enver Hoxhë kështu, këtu s’ka pasë shumë të Enver Hoxhës, po si libra i ka shti n’zift krejt edhe e ka pasë një seri t’pikturave të zeza qashtu të punuara vetëm me zift e asi. E Maksi i ka pasë do replika të Maleviqit piktura kështu ni ansambël shumë i bukur. A Ilir Deda e ka pasë një kompozim hapësinor, a e dini çka është?

Kaltrina Krasniqi: Bajri?

Shkëlzen Maliqi: Bajri po, Bajri po, diçka m’u ka asi, nashta që jam pak i lodhur, fundi po m’vjen mu (qeshë). Duheni me e bo edhe ni seancë (qeshë). Qishtu...

Kaltrina Krasniqi: Çka ka bo Iliri?

Shkëlzen Maliqi: Iliri ka pasë bo ni komponim kështu shumë i bukur është qashtu emrin “Përtej” si ekspozita, “Përtej”. Duheni me e pa atë material se shumë është i mirë tash e kem gjetë edhe inçizimin e atij.

Kaltrina Krasniqi: Po e di. Kjo është hapë n’cilin vit?

Shkëlzen Maliqi: Më 1997, në qershor.

Kaltrina Krasniqi: Edhe mandej është e ‘98-ta.

Shkëlzen Maliqi: Unë në ‘89-tën...

Kaltrina Krasniqi: Ndoshta jo, para se me hi në '98-tën, e maj në mend që ka pasë reaksion për qat' ekspozitë?

Shkëlzen Maliqi: Po normal, ka pasë edhe atje kundër edhe këtu, ka pasë reagime, disa të fakultetit, Xhevdet Xhafa e ka sulmu edhe ka pasë polemikë me, me Sokolin. Kryesisht, "Pse me shku atje, a din, në Beograd te okupatori. Aty me ekspozu me ia bo qefin me thanë ata qe këta janë asi". Edhe na ka pasë sulmu, edhe këta Qendra Informative e Kosovës, QIK-u i famshëm, edhe nëpër gazeta kanë shkrujt që erdhen ktu, n'kohën kur qindra veta këtu po burgosen edhe po dënohen artistat kanë gjet me shku në Beograd me bo. Kurse Beogradi u zgjedh kështu. Une e kam propozu për shembull Suboticën ose Budvën, thjesht me i nxjerr dikun, e Sokoli e Mehmeti e Maksi thojshin, "Shku për shku, po shkojmë në Beograd se aty ka publik, aty ka interesim", edhe përmbajtja e ekspozitës ka qenë relativisht eksplozive edhe provokuese ma shumë provokuese për atje se për këtu...

Çka po di, kemi rreziku pak. Unë e kam pasë edhe aty vet në Soros mu s'guxojshin me m'thanë kurgjo se kam qenë njëfarë si shefi, po ktyne artistëve ata punëtorët e Soros-it, "A e dini çka po boni, ku po shkoni atje? A e dini çka ju bojnë këtu?" Ata kanë thanë, "P'e dijmë çka po bojmë, vet e kemi zgjedh nuk është që..." Ti ekspozu këtu ose ekspozu në Beograd, domethënë ndonjëherë do sene duhesh me i tregu edhe atij atje. Tash në atë logjikë që unë thojsha edhe ma herët, "Po shkojmë në Parlamentin e Serbisë me iu tregu që ne jemi për pavarësi", është njëfarë... Jo defanziva po... në t'vërtetë nuk ka nevojë gjithmonë as me luftu me armë ose me... normal se me fitu ni armik si këta që kanë qenë ndoshta ish dashtë vetëm me bo rezistencë t'armatosur, po edhe lufta politike i ka shkalltë e ndryshme të shprehjes. Çka po di, nashta kemi gabu nashta jo, në esencë jo.

Pasiqë u zgjodh, domethanë, u themelu LDK-ja edhe Ibrahim Rugova u zgjedh kryetar, dikun në shkurt na pat' ardhë ni ftesë, Ibrahim Rugovës edhe mu, me bo ni turne evropiane, domethanë në Vienë, Stokholm edhe në Oslo me ftesën e Komitetit të Helsinkit. Kjo vizitë është dashtë me u realizu pak ma herët, dikun n'vjeshtë po diçka janë ngatërru ato farë... disa qarqe atje në Suedi e në Norvegji, sepse unë kam qenë njëfarë kontakti për Komitetine Helsinkut gjatë atyne viteve përmes meje i ka pasë do kontakte edhe Berit Beker, një antropologe nga Oslo. Ajo e vizitonte gjatë '80-tave shpesh, gati dy herë n'vjet Kosovën edhe zakonisht une kam qenë njëfarë si *stringer*⁷... Vinte me mu edhe bonte biseda edhe ajo ka propozu që une edhe Rugova me qenë në atë delegacion, por ky Milaim Zeka a dikush atje që ka pasë kontakte me to atje e ka prish ata, "Xeni s'bon, por duhet Qosjen". Mandej ata janë shty, ai e ka bo ma vonë për shkurt këtë vizitë. Pak jemi vonu po s'ka lidhje ajo.

Kur shkum atje neve në Evropë, kemi pasë shumë takime. Ma s'pari në Vienë ka qenë, ndoshta vizita e parë e Rugovës si kryetar i LDK-së, jo ma kryetar i shoqatës ma herët qysh e përfaqësonte. Edhe ka qenë njëfarë... shumë takime kemi pasë domethanë, nja tre, katër ditë kemi nejt. Gati dy javë ka zgjatë udhëtimi edhe me shkrimtarë, po edhe me politikanë edhe me burra shteti. Ka qenë shumë vizitë e përcjellur nga mediat në Vienë, kena pasë edhe disa konferenca për shtyp qe kanë bo jehonë. Në Vienë

⁷Stringer është një gazetar i pavarur, fotograf, ose videograf, i cili kontribuon raporte, foto ose video në një organizatë të lajmeve mbi baza të vazhdueshme, por paguhet individualisht për secilën pjesë të punës së botuar ose transmetuar

e kemi taku bile atëherë edhe Zoran Gjingjiqin, atëherë ka qenë ma shumë njeri i opozitës e kështu. E kam pasë njifarë muhabeti ma shumë privat, se kemi qenë edhe në disa tribuna publike bashkë. Më kujtohen krejt detalet po ajo [vrasja e tij] ka qenë shumë e pritshme.

Për mu ka qenë shumë interesante ajo vizita ose këto takimet që i kena pasë me Ibrahim Rugovën, sepse ai e ka pasë njifarë tregimi, çdo herë ai fliste i pari se ishte zyrtar, unë isha vetëm shoqni civile ose kështu diçka. I ka pasë njo dhjetë minuta, e kishte njifarë tregimi që e përsëritke si fjalë për fjalë, si pllaka e gramafonit: cilat janë kerkesat e shqiptarëve, çka kemi bo deri tash. Edhe mu duke interesante se i përvetësonte edhe ato aksione që nuk i bojke LDK-ja. LDK-ja zakonisht ishte kundër, i kemi pa protestat masive që i ftojshin njerëzit me dalë n'rrugë edhe ata dilshin vet e kontrollojshin situatën. Bile kishin frikë se çfarë do t'ndodhë, po atje kur i numërojke sukseset e Lidhjes i përvetësonte, thonte e kem bo këta e kem bo këta, mu m'dukej simpatik.

Kur e kryjke ai muhabetin e vet atëherë ai shunte, ata çdo pyetje që e bonte ai thojke, “Këtu e keni profesor Maliqin, ai është sociolog e filozof edhe iu përgjigjet për këto sene”, edhe kështu mu m'ka bo përshtypje kjo sa e ka pasë ai tregimin preciz, gati të njejtë çdo herë. Kurse kur kemi qenë në Stokholm ka qenë njifarë tubimi publik, atëherë ndodhi njifarë incidenti, folëm sa folëm. Masnej, kishin ardhë do serbë ekstremist fillun me bërtitë, ai udhëheqësi e nderpreu atë tubimin mos me dalë naj farë ekcesi kështu edhe kështu. Domethanë, ka qenë ndoshta prezantimi i parë i krejt skenës, atëherë sa pat' nisë me u pluralizu skena. E patëm formu edhe Partinë Social Demokrate edhe disa parti tjera kanë qenë të formune edhe kështu u prezantojshim atëherë, që edhe Kosova ka kapacitete demokratike.

Mandej në prill ka qenë vizita në Amerikë në Kongresin Amerikan, *hearing* [Anglisht - seancë dëgjimore], edhe aty Rugova ishte yll në të vërtetë. Plus e bonën yll disa rrethana se dikush i kishte lajmëru Shërbimet Sekrete Amerikane se po përgaditet atentat, se këta ekstremistet serbë, çetnikët, a çka janë organizatat e tyne, po përgaditin atentat në Ibrahim Rugovën. Edhe ia dhanë njifarë, ni sigurim t'profilit ma t'nalt. Ishin nja 15-20 burra krejt kështu kah dy metra edhe as neve që ishim anëtarë të delegacionit, që ishim 15-20 veta, nuk na lejshin me u afriu ngat tij. Rastësisht me iu afriu, ata t'shtyjshin.

Kjo mandej e rriti famën e Rugovës te popullsia e Kosovës. Kur u kthym secili e tregoi çka kemi fol atje. E kemi pasë edhe njifarë mitingu t'madh me diasporën tash mas atij *hearing*, që edhe pala serbe edhe neve kemi dëshmu para Kongresit Amerikan ose Senatit për çështjen e Kosovës. E këta aty kanë qenë edhe Qosiqi e këta, te na kanë qenë Rugova me Qosjen edhe kështu.

Ka pasë qenë një Agim Gashi, një rapsod, ai e pat' marr një tekst të Halil Matoshit e ka botu në “Zëri” me fjalimet tona, e krejt e ka romantizu atë viziten tonë atje në asi.... Ka qenë njifarë rapsodie e “Sheraton”, se atje atë tubimin e kem pasë në “Sheraton” e ky mandej Agim Gashi e ka bo si kangë popullore me çifteli. Unë mandej bojsha hajgare thashë, “Kemi hy në epiken legjendare” (qeshë). Kështu, ka qenë simpatike kjo farë, muajt e parë të legalizimit të lëvizjeve me ni formë plurale. Domethanë, tash i kemi pasë jo vetëm LDK-në, por pesë-gjashtë parti që u formun.

Aurela Kadriu: E qysh e përfaqësojshit ju çështjen e Kosovës? Ka qenë hera e parë që Kosova është përfaqësu qashtu ndërkombtarisht në '90-tat.

Shkëlzen Maliqi: Po tash, neve tregojshim çka po ndodh. Domethanë, represionin e '80-tave, burgosjen masive, po edhe ata që nisi që e patën marrë me dhunë autonominë edhe krejt procesi ka qenë i sforcun me... kur e ka mbajt mledhjen Kuvendi i Kosovës i atëhershëm ka qenë e rrethume krejt lagjja edhe Kuvendi edhe mrena ka qenë policia edhe kanë votu ata që kanë qenë n'sallë, delegatët kanë votu. Edhe mandej ka qenë njëfarë periudhe e dhunshme kur e kanë zvoglu edhe e kanë anulë praktikisht autonominë e Kosovës. Domethanë, kjo ka ndodhë në '89-shin po ishte ni periudhë gjendje e jashtëzakonshme. Mas asaj u hapëm, i krijum disa parti edhe Këshillin për të Drejtat e Njeriut. Edhe kjo ishte dalja e parë e ni delegacioni t'madh atje në Washington, kurse kjo vizita me Rugovën ka qenë ma specifike n'fillim të vitit, domethënë në shkurt.

Aurela Kadriu: A dalim pak se po kom qef me u ndalë te jeta e juj familjare, qysh jeni taku me Alisën?

Shkëlzen Maliqi: Kur jam kthy prej Beogradit, domethanë ka qenë dikun në vjeshtë të vitit '82, 1982, edhe kam... në fillim nuk dilsha, rrisa te shpija lexojsha gazetën atëherë. Kur kam nisë me dalë nëpër kafe me do shokë që i kam pasë këtu edhe i bojsha do rrethe tjera. Njiherë rasisht e kam taku në shoqinë e disa vetave që i kam njoftë te "Grandi", aty jashtë te "Hotel Grandi" në atë kafiterinë që është te Zahir Pajaziti sot, aty jam njoftu edhe kem nisë me u shoqnu. Edhe nji kohë kem qenë vetëm shokë, po pastaj unë pata shku me ni... verës, në qershor m'duket, kam pasë shku me ni udhëtim nëpër ishujt e Adriatikut me arkeologët t'u i vizitu kolonitë greke të Adriatikut, në atë zonë. Edhe prej atjehit, prej Hvarit i'a pata shkrujt si nji kartolinë, si diçka dhe kur u ktheva atëherë pak sikur u afrum ma shumë edhe qishtu.

Unë nuk kam pasë ndërmend diçka me kriju familje a diçka, po çka po di, ndodhi qashtu që ajo ka qenë vajzë simpatike, ka qenë distanca gati 13 vjet mes nesh. I ka pasë 22 vjet m'duket, unë kam qenë 35 [vjet] a diçka gati 36 qashtu. Mu këtu do shokë që i kam pasë prej Beogradit, Sylejman Kllokoqi ky kameramani i famshëm i joni, ai m'thoshte, "Këtu vajzat nëse del njiherë, dy herë vajzat t'thojnë, 'A po m'fejon se s'guxoj me dalë?'" (qeshë). Atëherë kanë qenë ma konservative rrethanat, nuk i lejshin vajzat me dalë as në Prishtinë deri 21:00, 21:30 maksimum. Me Alisën qashtu edhe na dilshim e kalojshim natën deri ma vonë unë thashë, "Kjo shumë e emancipune kanë kalu tri javë", derisa nji natë m'ka thanë, "Valla, po kam edhe une probleme. Nashta mirë është me u feju", po atëherë u bona une tolerant thashë, "Okej".

Aurela Kadriu: U zbutë mandej vendose me u feju a?

Shkëlzen Maliqi: Jo, mirë, boll e emancipume. Tri javë! Dhe ndonjëherë e nguci, ajo zemrohet për këtë a din, kur ja përmendi, por është njëfarë hajgare që e tregon realitetin se qysh ka qenë atëherë. Po ka qenë vajzë shumë simpatike. Vetëm ni problem e kishim se unë isha pak n'moshë, kurse ajo shumë e re, i thojsha, "Pse po m'merr mu? Kqyre i keq jam, plak" (qeshë).

Aurela Kadriu: A keni dalë në Kurriz në të '90-tave?

Shkëlzen Maliqi: Në Kurriz, në Kurriz kemi dalë, po të '90-tave, në të '80-tave, vërtetë edhe në '80-tat edhe në '90-tat. '90-tave mandej kemi dalë këtu te Qafa, se Kurrizi nisi me ra. Në të '80-tat kemi dalë ma së pari ka qenë "Laibachu" atje në... te ajo farë tuneli dikun pak ma nalt. Nuk po m'kujtohet tamam ku ka qenë, po aty ka qenë edhe "Hani i Dy Robertit" e dilshim edhe atje edhe '90-at. Mandej, vazhdimisht kemi dalë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë Kurrizi '80-ave?

Shkëlzen Maliqi: Ka qenë njëfarë oaze interesante. Muzika ka qenë kryesisht qisi farë alternative, ndonjëherë disa edhe jugosllave, ka qenë si "Bijelo Dugme" i kanë dëgju. E te "Laibachu" ka qenë ky, seni kryesor ka qenë ajo faza kur ky farë rock-u sloven edhe grupi "Laibach" kanë qenë shumë t'popullarizum. Por, nuk kanë qenë ndonjë grup i madh, po ashtu. Gati çdo natë kemi dalë, po them, ka pasë ndonjëherë edhe kësi kontrolla t'policisë, po s'na nijke atëherë kemi qenë pak ma t'ri. Ajo pjesë e Prishtinës, domethanë ka qenë... është lidhë me muzikën rock edhe jazz edhe kësi pak ma perëndimore. Por, jazz ka pasë ma pak, në aspektin se ajo kërkonte hapësirën pak ma ndryshe. E kafiqat kanë qenë vendet e vogla ku rrishim ngusht njëri me tjetrin.

Interesant, ma çonte mallin e Sarajevës, se '70-ave, vetëm në Sarajevë ka pasë kësi bashkësi lokale, deri diku edhe në Zagreb, Beogradi ka qenë pak ma ndryshe. Po ashtu, Jugosllavinë e kam pasë njoftë mirë këto kryeqendrat. Në Prishtinë ajo ka qenë si njëfarë risie, bash te Kurrizi, te ai tuneli aty ka qenë koncentrimi, ka qenë nashta pesë a gjashtë vende edhe ushtojshin. Mandej, plus ka pasë piceria edhe kështu. Ka qenë shumë specifike për Prishtinën n'tanësi, kurse në këto zonat tjera te Prishtina e vjetër e kështu, atëhere ende kanë dominu këto çajtoret edhe "Tatlisësi" e këto filmat e kjo...

Mandej kem pasë edhe do restorane pak ma serioze si restorant "Rugova". Atëherë dojshin restaurante ma familjare edhe për darkë edhe diçka. Ka pasë edhe kësi kafene të stilit t'vjetër për këta t'them ashtu boemat, pijanecët e kështu me meze me sene. E kështu ka qenë e përzime Prishtina. Ma vonë kanë nisë me dominu gjithnjë ma shumë këto kafiqat, ma vonë u bo i famshëm edhe "Imigji" edhe sot e kësaj dite është njëri prej vendeve ma interesante, po ajo ka qenë në atë pjesën andej nga Bregu i Diellit.

Aurela Kadriu: E Qafa, '90-ave?

Shkëlzen Maliqi: "Qafa" mandej kur u kriju knej këto ndërtesat që janë bo m'duket t'viteve të '80-a, atëherë edhe këtu ky kompleksi këtu ku jemi, ka qenë pjesë e asaj. Atëherë edhe këtu me një zonë këtu u bonën do, njëfarë tuneli është... po këtu nisën me u hapë disa restaurante. Edhe prej qendrës, prej të '90-tave edhe ni kohë ka qenë këtu te "Qafa", ka qenë qendra. Kanë qenë disa lokale si "Rozafa", mandej ka pasë Shaipi atje si, knej nga Kino Rinia, ka qenë ni vend ku rrishim shpesh kështu. I ndrrojshim disi vendet edhe kjo farë edhe "Elida" në "Boro e Ramiz" edhe ajo është relativisht afër.

Po qendrën në vitet e '90-tave e pushtun serbët edhe aty rrallë kalojshim edhe u bo diqysh e bezdisshme, po s'kishte mo lokale ku me u ulë si duhet edhe "Grandi" ni kohë pat' hy Arkani e këta

kriminelët serbë, paramilitarët nuk ishte bash.... Vetëm kur vishin këto delegacionet e huja nuk kishin ndonjë hotel ma t'mirë ku t'rrishin e shkojshim me i taku, po vet këta kamarierët e "Grandit" që ishin shqiptarë na thojshin, "Ej kqyrni se tash shumë policë e sene", kështu.

Niherë kam pasë qenë, ka pasë ardh Joseph DioGuardi, nashta për herë t'parë në Prishtinë edhe e pata lanë takimin me to aty bash në "Grand", se aty ai ishte i vendosur. Ai m'thoshte mu, "Këta tjetër krejt që i kam thirrë, pse s'po guxojnë me ardhë këtu? Vetëm ti erdhe". "Po", thashë, "çka po di unë s'po ua vëjë veshin, vijnë, flasin, shkojnë". Edhe i ka pasë shkru do tekste do diçka. Joseph DioGuardi ka qenë kryetari i asaj Aleancë Kosova Amerikane në New York. E ka udhëheq Lobin Shqiptar ni kohë, derisa nuk janë përça edhe ata diaspora. Disa e mohojshin, disa... jo ai ka qenë ni kohë kongresmen amerikan edhe tonët atje, diaspora e ka kuptu që ai është me prejardhje nga Italia e jugut, nga Kalabria me prejardhje shqiptare. E kanë përpunu pak, ia kanë dhanë do informata edhe atij iu ka kujtu që prindtë e gjyshit i ka pasë prej atje. Ka punu mjaft edhe sot hala është aktiv në këtë aspekt.

Pjesa e Tetë

Aurela Kadriu: Ku keni qenë gjatë luftës, a keni qenë këtu?

Shkëlzen Maliqi: Në '99-tën?

Aurela Kadriu: Në '99-tën, po.

Shkëlzen Maliqi: Në '99-tën s'kom qenë... kur kanë fillu bombardimet s'kam qenë në Kosovë. Nji javë para bombardimeve me Mahmut Bakallin kam shku në Zvicër, me ftesën e Sindikatave Gjermane me ia spjegu punëtorëve shqiptar atje në Zvicërr Rambujenë. Neve s'kemi qenë bashkë, ai ka shku me ni vend, une me njo tjetër. Por, në të njëjtën kohë e kem pasë edhe nji përkthyes, përcjellëse atje edhe ashtu i kem pasë fjaltë. Kemi qenë ne Cyrih, Lozanë e kështu me takime... edhe atje na ka zatet fillimi i bombardimeve. Une kam qenë në Lozanë atë natë, në 8:00 ka pasë me fillu ajo tribuna, plot u mbush salla. Edhe sa deshtëm me ia nisë ata dikush i kish pa lajmet erdhi atje dhe tha, "Nisën bombardimet", mua m'u zbeh pak ftyra, jo që diçka, po e disha që krejt familjen e pata pasë këtu.

Edhe i pata thanë Alisë me i marr fëmitë edhe nanën time, se une jetojsha me nanën, me dalë deri në Shkup ose me shku në Tetovë. Pata fol me Arben Xhaferin, po në të vërtetë Alisa ka pasë dalë po tjerët patën mbetë, vëllau, familja, motrat krejt këtu i kam pasë. Alisa një ditë përpara pat' dalë. Derisa unë isha atje u dike se ka me pasë intervenime e diçka. Nëse Millosheviqi me Holbrookun kanë pasë negociatat, që megjithatë kanë me leju me nënshkru qatë farë marrëveshjen e Rambujesë. Deri në moment të fundit ka pasë shpresa se nashta e nënshkrun, por nuk e nënshkrujtë edhe e disha se ka me pasë bombardime. I thojsha Alisë, "Shkoni atje!" Nana jeme s'ka dashtë, e [ka] rujt shpinë e kështu si zakonisht. Por edhe familja e Arbenit këtu, Arbën Xhaferit, edhe ata domethanë edhe ata qishtu kanë qenë si Alisa, në mëdyshje.

Por, këtu kanë qenë lajmet se nuk po lejojnë maqedonët me kalu atje, po. Arbëni ka pasë folë me Alisën edhe i ka thanë, “Nëse serbët iu lëshojnë, une e rregulloj me kalu anej”, edhe atëherë kemi pasë telefona mobil a diçka, “Po veç lajmëroni se keni kalu zonën e serbëve, atëherë iu lëshojnë”. Edhe këta, megjithatë janë nisë bashkë me djemtë, me familjen e Ali Podrimjës e kështu. Edhe ashtu na kemi pasë jarani, fëmijtë e tonë djali jem me djalin, me Petritin, e Ali Prodimës ka qenë shok i ngushtë e kështu. Edhe do tjerë që kanë qenë nga ajo anë janë nisë edhe i kanë lshu këta, mandej ka ardh dikush prej maqedonëve, Arben Xhaferi i ka dërgu, edhe ata janë strehu atje n’Tetovë. Po familja tjetër e jemja ka qenë këtu.

Unë mandej ma shumë se një jave iu kam bashkangjitur atyne në Tetovë edhe mu s’dojshin me m’lshu, por unë i kam pasë krejt në rregull, s’kam pasë as refugjatë. E kam pasë një vijë t’rregullt të avijonit në Ohër kam zbrit, po nihere nuk dojshin me m’lshu, thanë, “Jo s’bon”. Se atëherë patën shumë refugjat prej ktuhit shkun atje prej Bllacës e knej, mandej prapë intervenum te Arbeni na lshun jo vetëm mu po edhe nja 20 veta tjerë. Ashtu ka qenë njifarë hallakame. Po une e disha që edhe në zyren e SOROS-it prej Prishtinës u bart atje në Shkup edhe atje mandej e vazhdum punën. Unë s’kam qenë asnji ditë refugjat, po kështu punojshim si punëtor i SOROS-it e u bartëm atje. Mandej, kur u ndërpre në bombardimet u dorëzu Serbia edhe nja ni muj e ma shumë kem punu atje me refugjatë e me kështu. Jemi kthy tek n’korrik dikund në Prishtinë.

Aurela Kadriu: Qysh e keni gjetë?

Shkëlzen Maliqi: Nana jeme, Agoni kanë ardh t’partë mandej edhe Alisa e krejt janë vendos këtu. Shpija ka qenë okej po pak e... ata e kanë shfrytëzu, kanë flejt si duket ata policët, se përballë shpisë teme ka qenë njifarë objekti i vogël ku është tash, njifarë, këto Western Union që është njifarë dugoje aty është te njifarë, Kuarti Kinez i thojshin dikur, aty ka qenë punkti policor që e ka kontrollu rrugën. A te shpija jeme m’duket se kanë flejt, i kanë plaçkitë krejt senet çka kanë mujt, prej librave n’fillim mu kanë duk që krejt janë aty mandej i kam pa që dikush i kish marrë vetëm do komplete, a din, kështu Dostoyevsky ose Nietzsche kësi, dikush që...

Dikush që ose si duket i ka ditë që çka po merr ose komplet po e merr ma lehtë me i shitë, se e kanë vlerën qishtu nja pesëdhjetë-njiqind atëherë marka, nja dy torba dikush që ka mujt me i bajt. A këto senet, mobilet e këto senet krejt çka kanë vlerë ose teknikën krejt i kanë marrë edhe n’podrum i kem gjetë kështu. Aty ku e kemi atë kalldajën, n’vend të kalldajës e kanë bo ni grumbull ashtu si t’druve i kanë përgaditë si me kallë, po si duket s’kanë pasë kohë u bo hallakam a diçka s’e kanë djeg. Shtëpia ka mbetë ashtu, vetëm se e plaçkitun a din kështu. U dashtë prej fillimit me ia nisë me ble sene, mobile sene edhe këto jorgana e sene.

Aurela Kadriu: A iu kanë lanë naj mesazh? Kanë ditë me shkru nëpër mure ata...

Shkëlzen Maliqi: Jo, vetëm kemi gjetë asi nëpër mure e nëpër dhoma gjak, po ai, ni qen i kojshive ka qenë i plagosun edhe u mshef nëpër shpi dikun e kanë lidh. Ka qenë qeni i ktyne Dedajve, Mollos e ka pasë emrin, për ata kemi ni që aty pari ka qenë, kështu. Mandej unë ma vonë e kom zbulu se edhe në zyren e SOROS-it edhe aty m’i kanë marr krejt kompjuterat edhe disqet, edhe ato t’voglat edhe krejt.

Plus i kam pasë do disqe kështu ma t'mdhaja që kanë qenë si USB me kapacitet pak ma t'madh, ata kanë qenë, çka po di, njëqind Kilobyte a diçka qishtu, jo ksi me Gigabyte, por aty i mbajsha krejt tekstet që i kam pasë deri atëherë. Ato nuk i kam gjetë.

Zakonisht e merrsha gjithë njanën prej atyne disqeve me veti kur shkojsha n'rrugë, a diçka. Atëherë, shpejt e shpejt jom nisë edhe pata haru me e marrë, thashë mos i kishte marrë Alisa, por jo as ajo nuk i kishte marrë. E kom një... mandej i kam gjetë, letrat veç i kanë gjujt edhe i kam pasë krejt gati, gazetatat, shkrimet ato i kam gjetë në 95 përqind ndoshta krejt po vetëm *file*-t, se me kompjuter ia pata nisë shumë herët me punu. *File*-at për atë periudhë '95-'99 nuk i kom, kurse prej '90-tës e pak ma herët deri '94-'95 i kam gjetë me do copy disqe t'mdhaja, kanë pasë qenë edhe kanë qenë si pllantikë. Menxi i gjeta se ato i kam pasë dikund në rafte me libra, ato nuk i kanë gjetë. Mezi e kom gjetë ni kompjuter te "Zëri", të vjetër asi që nuk u përdorke, m'u ka dashte një javë ditë me i bartë tekstet e asaj periudhe.

Ato të viteve '95-'99, ato nuk i kam në formë elektronike. Duhet diqysh me i skenu e me i qitë. Tash kohëve të fundit kam punu me bo krejt arkivën e shkrimeve, janë bo shumë, po mendoj ka edhe duplikate e kështu, po gati janë 3 - 4 mijë njësi. Ndoshta dy të tretat janë tekste në origjinal, por po mungon këto katër vite, për me pasë njifarë arkive personale. Nuk kam mujt asnihere me i ndam një muj ditë me punu as këto tekstet që i kam. Në t'vërtetë une i kam fut nëpër ato farë folje edhe disa i kam organizu që i kam pasë si seri, por janë kështu pa kronologji e pak si hallakam. Ni dollap i madh është plot është me ato sene, dikush duhet, vet nëse mbërrij me i rregullu mirë nëse jo s'po di, mbetën qashtu.

Aurela Kadriu: Deshta me t'pyt para se me dalë te kjo pjesa pas luftes po kom qef te kjo shpia te "M" kur jeni bartë?

Shkëlzen Maliqi: Gjithë kemi jetu neve aty.

Aurela Kadriu: A gjithë qaty jetu aty...

Shkëlzen Maliqi: Po, prej vitit '65.

Aurela Kadriu: A okej, se diçka s'di pse mendojsha që jeni bartë...

Shkëlzen Maliqi: Jo, aty kem jetu. Kur jam ardhë për herë të fundit në Prishtinë, në vitin 1964, përkohësisht nja ni vjet, ni vjet e gjysë kemi qenë këtu te rruga ku janë "Pishat", atëherë ka qenë emri m'duket "Moša Piade", tash s'di qysh e ka as vet. Por, mandej jemi bartë atje se baba jem ka qenë ministër a diçka edhe ka pasë qef me e pasë ni shtëpi si kështu... ato janë konsideru si villa shtetnore, a din. Bile '90-tave kur janë privatizu krejt këto banesat. Të gjithë kanë nejt me ble për njëqind, dyqind, pesëdhjetë, treqind marka. Neve na pat' ardhë vendimi që duhet me pagu 150 marka, qashtu e vlerësojshin ata n'bazë të vjetërsisë kur është ndërto shpija, sa vjet e kemi pagu qiranë. Ato krejt u llogaritshin edhe bike me pagu 150.

Po mandej erdh vendimi se këto villat shtetore që janë, domethanë ato të Fadil Hoxhës, Xhavit Nimanit këto n'qendër të krejtve, ato nuk mundën me u privatizu, po kanë me na dhanë banesa n'vend t'asaj. Por, ka qenë n'vitet e '90-ta hallakam këtu. Mandej edhe nuk kishin ata as banesa, krejt u privatizun tjerat edhe mbetem aty, çka po di. Mas luftës është dashtë me i kalu nja shtatë, tetë, dhjetë dymbëdhjetë vjet derisa i kemi bo letrat me e bo pronë private edhe ma shumë m'ka kushtu avokati edhe eksperti që e ka vlerësu vlerën e atëhershme se sa vlejke. Unë padinë meniherë e kom pasë bo në '90-tën, ma shumë vlejke ato, se sa që e kam pagu kundërvlerën në euro, prap 150 euro e kam ble shpinë. A avokati e këto m'kanë kushtu 2500 a 3000 euro, se m'patën përfaqësu gjatë atyne viteve nëpër seanca e diçka, me kalu si pronë t'familjes.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë qajo lagjja, a e mbani në mend diqysh transformimin...

Shkëlzen Maliqi: Lagjja ka qenë ashtu, gati nuk ka ndryshu. Tash ia ka nisë pak me ndryshu mas 2000-shit. Mirë ka qenë aty, përballë e kemi pasë bllokun e parë. Nuk ka qenë deri në fillim të '80-tave, kjo farë Kuarti Kinez, ato dugojat e sene. Aty ka qenë pompa e benzines krejt, ka qenë rruga për Gërmi relativisht e qarkullueshme, por e ngushtë. Gjithnjë e ma e ngushtë se u nisë me u zgjanu Prishtina edhe anej nga Velania edhe knej nga, qysh e ka emrin ajo përballë... Mandej knej rrugës për Gërmi e naltë te Vneshtat anej janë bo shumë shpia private, por shumë ma qetë ka qenë, çka po di. Edhe e pastrojshin ato çdo natë edhe në '60-tat, '70-tat edhe verës kur visha këtu ka qenë relavisht qetë. Në 12:00 të natës fillojshin me pastru rrugën e këto. Çdo natë e kanë pastru, pos dimrit nashta s'ka pasë nevojë, jo borë, jo shi. Ama verës ka qenë interesante, une rrisha deri vonë natën, qajo m'ka pasë pelqy, s'ka pasë tepër shumë zhurmë. Nganjëherë rinia e kështu kur u kthejshin pak ma vonë u nijshin t'u bërtitë e kështu, por mu m'ka pëlqy atëherë ajo farë atmosfera e qytetit.

Rruga jonë ka qenë me, me plot me bli, blina ka pasë. Era e mirë i vike në qershor. Edhe te shpia edhe sot e kem ni bli t'madh aty përpara shpisë. E kemi pasë edhe nji arë tepër t'madhe nga ana tjetër, plus mbrapa n'oborr baba jem ka pasë mjell dardha, molla ka pasë, edhe pak kanë mjell edhe kështu misër ose dredhza. E kësi sene gjithmonë kemi pasë, jo qepë, jo magdanoz, e kështu. Ai ka qenë... masdite kur u kthehej prej punës gjithë ka punu n'bashqë, ka pasë qef pak me punu fizikisht. Une ashtu ndonjëherë i kam ndihmu, po s'më ka interesu shumë, ma shumë me libra jam marr e me lexime.

Aurela Kadriu: A e mban në mend ndërtimin e "Grandit", atëherë kur je kthy prej Beogradit?

Shkëlzen Maliqi: Jo, ma herët ka qenë veç i ndërtun "Grandi", nuk më kujtohen shumë këto ndërtime edhe unë kur visha, visha nji ditë, dy. Në vitet e '70-ta kam pasë nisë me u ndërtu këto objektet e mëdha edhe "Boro Ramizi" e "Grandi" po nuk... e kam pa vetëm se po përparon, po rregullohet njifarë dore. Biblioteka ma vonë është ndërtu, Shtëpia e Mallrave, krejt '70-tave, të gjitha objektet janë ndërtu në të '70-tat qito representative, se përpara kanë qenë ma shumë me ni arkitekturë ma tepër provinciale si ajo rruga qendrore që e kemi, tash hala është aty.

I vetmi objekt që ka qenë ma mirë ose me ma kujdes ka qenë "Bozhuri" edhe disa ndërtesa aty, po n'përgjithësi vetëm kanë qenë objekte banimi, pak ndoshta dikun ndonjë dugoj diçka. Ma vonë e kam pa që janë si njifarë modeli ka qenë i do provincave gubernive të Rosisë, qashtu m'u ka dokë këtu. Ku

është Komiteti, ku është tash që është rruga qendrore aty ka qenë korza e dikurshme. Korza është sipas modelit të fillim shekullit në Itali e gjithkunj. Eh në mramje, në ora 7:00-7:30 dilshin u shetitshin, u sillshin. Prishtina e ka pasë ni anë ma t'gjanë të trotuarit për shqiptarët, në anën tjetër kanë qenë serbët e kanë pasë trotuarin ma t'ngushtë, se ata ma pak edhe në mes u shetitshim ne që ishim as anej as knej si t'përzim.

Aurela Kadriu: Gjatë cilave viteve ka qenë qishtu e ndame a gjithë?

Shkëlzen Maliqi: Deri vonë ka qenë, po deri në '90-tat. Mandej në të 90-a krejt u prish, se neve nuk shkojshim ma atje.

Aurela Kadriu: Tani e murrën krejt ata?

Shkëlzen Maliqi: Ata e murren po krejt po, u tutshin edhe ata kur dilshin aty, se diqysh iu duke tepër e madhe për ata s'janë mësu ashtu, s'di çka kanë bo ata, përnime nuk jom shku hiç, shkojsha direkt te Kurrizi ose këtu te Qafa e kapërcejshim qendrën.

Aurela Kadriu: E qysh ish me gjetë rrugë alternative n'qytet se s'ka qenë qaq i zhvillim qyteti, a din?

Shkëlzen Maliqi: Kjo rruga alternative e kem kapërcy e kem kalu ditën po se ma shkurt ka qenë shkojshim në "Grand" ose dikun, nuk është që krejt e kem, po n'mramje u bojshin ata u mledhshin aty ma të sigurtë a din, kur kanë dalë ose i kanë pasë disa kafiqa t'vet atje. Në të '90-tat, ndonjëherë edhe neve që ishim ma t'trentë mas kafiqave prapë shkojshim n'do kafiqa t'serbëve se ishin ma t'mirë se tontë, a din. Ka ndodhë, çka po di. Edhe këta, sidomos këta që njekshin çika ma lehtë kanë gjetë atje. Edhe pse ka qenë *zabrana* [Serbisht - e ndalume], a din kështu, jemi nda me serbët, po nuk ka pasë konflikte t'hapura kështu, po qashtu politika na ndajti. Ata që edhe përpara janë shoqnu që nuk kanë pasë paragjykime shkojshin në qato vende se jo n'secilin vend, tash. Për shembull, mu kjo tash "Zanji Bari" ata kanë qenë njifarë klubi serb edhe dizajni e diçka kurrë s'më ka pelqy, ka qenë tepër primitive.

Mas lufte disa herë patëm shku atje edhe u ankojsha, m'dukej tepër asi çirilicë, a din, jo n'kuptimin negativ, se s'kam asgjë kundër çirilicës po kështu njifarë dizajni shumë dallojke. Për shembull, ato që i ka karakterizu këtë në aspektin artisik ose dizajnin, jashtë s'mujshim me ndërto kurgjo po këto mrena. Kafiqat që janë bo edhe në Qafë edhe në Kurriz edhe kudo në qytet, skajeve, e kanë përcjellë njifarë, t'them ashtu, trendi nga bota. Edhe ka qenë shumë ma moderne se sa serbët lokal, ata s'kanë pasë shumë shije ose njifarë shije krejt tjetër edhe materiale e kështu që këta dizajnerët tonë, arkitektët tonë i kanë edhe atëherë e kanë përcjellë aq sa kanë mujt ose kanë shku edhe nëpër panaire a diçka. Kanë qenë ndryshe t'them ashtu, ma kreative ka qenë krejt skena jonë edhe pse na kanë shty në margina, në margjina, ka qenë shumë ma kreatvie edhe kjo u pa edhe n'sferën e artit edhe n'aktivitete e n'teatër.

Krejt lëvizja shqiptare ka qenë njifarë çude, ka pasë shumë spontanitet po edhe njifarë vullneti me u tregu aty, aq sa ka pasë mundësi. Prej, jo vetëm kultura, por edhe sporti, kjo zejtaria e kështu, këta tregtarët e vegjël ka pasë shumë edhe këta t'mdhejt njifarë dore e kanë majt gjallë Kosovën. Ka pasë

shumë asi t'them, ka pasë shumë jo vetëm interesi ekonomik, po njifarë dore, ni lloj akt i rezistencës ka qenë, për shembull m'doket edhe nëse s'gaboje në vitin 1992- '93, kur ka qenë edhe inflacioni ma i madh edhe kriza ma e madhe në Jugosllavi. Ata ia vnunë sanksionet Jugosllavisë, kishte mungesë të artikujve. Këta tregtarët tanë ishin t'gjindshëm edhe bishin mall këtu, për shembull, u ankojshin edhe vet serbët, prej Vojvodinës miell ose vaj luledielli edhe këto i bojshin stoqet ma t'mdhaja këtu sesa që kanë mujt me pasë në Serbi.

Këtu ka pasë shumë tregtar privat që mujshin diqysh me i korruptu këto drejtorat e fabrikave në Vojvodinë ose sidomos edhe të millit. Lu jepshin 15 mijë marka, atëherë edhe ju jepshin ato miellin këtu. Ka qenë për shembull, në '92-shin shumë interesante se këta, Sali Banana, njifarë tregtari i famshëm i Pejës bashkë me këta të "Dukagjinit", me Ekrem Llukën, ai e ka pasë bo njifarë kontrate me gati dy mijë privat nëpër Kosovë me çelë te shpiat e tyne dyqane, marketa t'vogla. Ata i furnizojshin me mall, kamionat shkojshin, e këta edhe punojshin aty edhe e shitshin qata, cigare e çka duhet. Edhe Sali Bananës qashtu i ka pasë mbetë mbiemri, se atë vit paten ble shumë banane edhe i patën majt aq lirë sa që familjet kanë mujt me u ushqy me banane shumë lirë, me killa e sene, ke mujt me i ble në rrugë a gjithkund.

E patën ble ni anije, a disa stoqe me anije mandej i patën pru ato. I blenin t'papjekuna ndërkohë ato pjekeshin, ashtu atë periudhen e krizës ma t'madhe, thuhet se e kemi kalu shumë veta me banane po jo, pos bananeve ka pasë edhe sene tjera. Ka qenë asi lloj inflacioni që ma shumë kanë pësuar serbët se shqiptarët. Edhe secili ka pasë dikond që ka dërgu familja jashtë ose diçka ose këtu që kanë pasë ndonjë biznes, të gjithë majshin marka si rezerva ose franga, ose kësi valuta ma serioze. A serbët që punojshin në sektorin shtetnor, profesorë ose diçka e merrshin në dinarë rrogën, atyne inflacioni brenda ditën ia rrxojke vlerën. Ndonjëherë është dashtë me bajt me qese t'mdhaja ato dinarët, se inflacioni ka qenë si atëherë në Gjermani ndoshta edhe ma i madh, qa po di... Nji markë ka qenë njiqind miliard, a diçka kështu. Marramendëse ka qenë, mrena ditës...

Une nihere e di, pak ma vonë ka qenë '94-shin, e patëm vendos me botu, Soros-i këtu i Prishtinës, Ekrem Murtezaj e ka pasë bo ni fjalor t'filozofisë kështu nja dy mijë faqe dorëshkrime e kështu edhe thashë, "Hajt ta marrim botojmë", edhe pse ai ka qenë i përgaditun ma herët në kohën e komunizmit edhe frazeologji ka pasë. Edhe ai nisi pak me e reduktu. I thamë "Heki pak këto, shkurtoje..."

Aurela Kadriu: Çka ka qenë kjo, '95?

Shkëlezen Maliqi: '94-'95 ka qenë. Edhe i përgaditëm ato edhe tash kur shkum me i marrë paret atje, ata thanë, "S'kem marka...", atëherë markat hala ishin, "s'kemi valuta, por nëse doni i kem do dinarë..." tha, unë isha me këta të "Dukagjinit" me punë e diçka tjetër atje në Beograd. Ata dojshin, SOROS-i me i ndihmu me e ble ni shtypshkronjë, jo shtypshkronjë, por aparat, ni maqinë t'shtypit të re a diçka. Provojshin me fitu edhe prej tyne naj grant me na ndihmu diçka. Nuk u bo ajo punë po tha, ajo kish kalu si totalisht OK "Mujna me ndihmu", po thanë, "A t'ju jepim dinartë, se i kem dinartë?" I pyta këta, "A i merrni dinartë?" "Po more, se i kthejmë menihere n'marka neve" edhe na dhanë me dy asi, a tre kanë qenë kësi t'najllonit të mdhaja keset plot me pare.

Tash nuk kishim ku me i lanë e nuk i lamë as në *gepek* [bagazh], po përpara te kamtë e mia n'makinë. Edhe na nalshin ndonjëherë kontrolla a diçka edhe e patëm bo nëse na nalin vesin kontrolla me iu thanë, “Shkum me e ble ni makinë në Beograd, po s’e gjetëm”, po s’na pyten, e hapshin *gepekin*, thojshin, “Çka keni këtu?” “Kurgjo s’kemi”. “A keni armë?” “S’kena armë” qishtu pytshin ata. Edhe kurgjo, ka kry punë edhe ato, si t’kanë ardhë këtu i kena ndrru në marka, se n’çdo qosh kena pasë kësi, markaxhi ju thojshim na atëherë.

Pjesa e Nëntë

Shkëlzen Maliqi: Vlera ka qenë e krejt projektit ndoshta njëzet mijë marka, edhe ato kur na i patën dhanë në dinarë ka qenë si me bajt çka po di. Kohë e çuditshme ka qenë kështu. E neve mandej u organizojshim... shoqnia jonë kem pasë këto klube, e këto, “Hani i Dy Robertëve” ka qenë atëherë pak ma vonë është çelë si restoran atje, jo te Kurrizi po kjo pjesa anej, qysh i thojnë?

Aurela Kadriu: Te Santea...

Shkëlzen Maliqi: Te Santea, bash te Santea. Santea ka qenë ni lokal i parë mandej përpara e pat’ bo, Fadil Dragaj me Meritën qat’ restorantin poshtë si në podrum. E rregullum relativisht mirë, aty edhe diplomatët vijshin e patën a din kështu, ka qenë si njifarë qendër e takimeve. Atëherë neve... edhe shok e kishim Fadilin, ndonjëherë e mbyllshim krejt rrishim deri n’mëngjes, deri vonë, edhe kur ishte ndonjë orë policore diçka, pritshim deri mëngjesin. Mandej kemi pasë me një shoqni pak ma t’ngushtë, po krejt kanë qenë... Ky Arben Xhaferi e ka pasë në Hajvali atë farë, atëherë e ka pasë ma shumë si vikendicë a diçka edhe atelenë e grusë t’vet, Violeta Xhaferi, edhe ajo piktore, por ajo pat’ shku me fëmijtë në Oslo, në Norvegji si filloj këtu tollovia lufta në Slloveni anej knej. Djali ishte i rritun, me e largu prej ushtrisë edhe nuk durojke ajo vet këtu Arbeni mbet i vetëm.

Neve shkojshim qatje te ajo farë *hacienda* [farmë] e tij që e ka pasë atëherë në Hajvali, kojshi ka qenë me Pacollin kur e pat’ bo atë farë shtëpinë alamet t’madhe aty, në hymje të Hajvalisë. Edhe aty organizojshim qisi... jepshim kah pesë marka a diçka, bojshim mish e sene edhe ka qenë ajo salla e madhe njifarë pingpongu ka pasë atje po mandej ato shishet kishim qef m’i thy kah njiqind, a din, e me fshisë e pastrojshim t’nesermën. Ashtu pak, ndonjëherë edhe thojshim, çka po di, “I mirë ky okupimi”, a din (qeshë). Është dashtë me pasë njifarë...

Shpesh kemi jetu n’frikë a diçka, ni lloj asi, e po bash qaty në atë ndërtesën, *haciendën* e Arben Xhaferit aty kem përgaditë do, do, do, kemi punu. Për shembull, atje ka ni javë ditë me përgadit themelimin e Forumit Demokratik të Kosovës në vitin ‘90-të. Aty kanë qenë përfaqësusit e partive, Fehmi Agani, Hivzi Islami i Partisë Social... këtij të Fshatarëve, me disa tjerë, Blerim Shala i Partisë Parlamentare, Veton Surroi, hala ka qenë m’duket ma shumë i *UJDI*-t a diçka. Qashtu pak e kem pasë përgadit ata si... pata fol m’duket ma herët me e bo qata si Parlamentin e Kosovës në përfaqësim relativ proporcional. Domethanë edhe kem punu edhe ndonjëherë e kemi pasë njifarë si ventili me u ni si njeri me u pi pak, me kalu.

Aurela Kadriu: Qysh ka vazhdu jeta juj mas luftës? Çka keni vazhdu me bo?

Shkëlzen Maliqi: Mas luftës, mas luftës ma s’pari është dashtë me e lanë SOROS-in, jo menjherë, po mas luftës mandej edhe gjatë luftës, menjhere mas luftës, prej Maqedonisë, prej Shkupit edhe Tetovës patëm shku me ni mbledhje me SOROS-in në Budapest. Edhe George Sorosi më tha që duhet me pa se çka do t’bojmë, neve hale ishim degë e Beogradit e Jugosllavisë. Kur e takum Sorosin tha, “Juve NATO ju ka okupu apo? E tash muni me bo SOROS-in, degën e shoqërisë të organizatës së shoqërisë së hapur t’pavarun, Kosova duhet me u pavarësu prej Serbisë”. Ashtu, edhe u mor vendimi. E mandej ata i dërgun disa veta, ia nisën një organizim me e bo.

Unë kam qenë aty i dyti në hierarki, i pari ka qenë Luan Shllaku. Mandej kur erdhën disa veta që bojshin konsulta, mu m’thanë me përgadit bordin e ri edhe ata m’caktun me qenë anëtari i atij bordi. Edhe mu ma dhanë me bo ni projekt une, që zgjedhi vet çka me punu edhe ma dhanë ni si bursë 25 mijë dollarë. S’kom pasë nevojë me punu, por veç anëtar i bordit edhe me e kry qat’ projekt. Une e pata zgjedh me bo ato ni temë për nacionalizmin shqiptar, kom punu një vjet, po ata thanë mas ni vjeti ndërpritet ajo farë... bursën e merr, po nuk je ma anëtar i bordit, por je i lirë. Edhe thanë këtë që qendrën “Gani Bobi” që e kemi pasë neve ka qenë pjesë e SOROS-it, thanë, “Edhe asaj ia bojmë njëfarë *spin off*, mundeni me u pavarësu”. Aty dikush tjetër e udhëheqte atëherë, Astrit Salihu ia dhanë diçka do mjete me ble kompjutera me e hapë ni zyre edhe qashtu u morën vesh.

Une e kuptova që në të vërtetë aty, meqë në atë SOROS-in e vjetër unë e kam pasë atë farë lidhjen drejtpërdrejtë me ato farë themelusen e SOROS-it të Jugosllavisë, që ka qenë Sonja Licht, shoqja jeme a diçka edhe raporti u prish. Tash a din qysh, kur dikush don me t’hek n’mënyrë elegante t’çon ambasador dikun ose të jep njëfarë... nuk isha ma as i interesun. Mas luftës, atëherë kom nisë nihere jam punësu si korrespondent i “Radio i Evropës së Lirë” nga Praga. Për një vjet kam qenë këtu shef i korespondenturës. Ma vonë edhe ajo punë m’u doke pak e ranë e diçka, po punojsha edhe sene tjera.

Por mandej u ktheva, mandej kam qenë prej ‘94-shit edhe ashtu kam qenë pjesë e shtëpisë botuese “Dukagjini” edhe kam botu shumë libra edhe njëfarë serie të filozofisë, sociologjisë këto librat e kolanës, Fryma, edhe ni kolanë me letërsi edhe do botime speciale. Aty tanë kohën kam qenë deri në 2005-2006, po mandej kalova kur Astrit Salihu pat’ bo zëvendës drejtor i RTK-së. Atëherë, une u ktheva te “Gani Bobi” edhe jam marr me hulumtime, me sondazhe, me do projekte për media e kështu. Deri në vitin 2010, 2011, 2012 kemi qenë relativisht të suksesshëm, ka pasë shumë fonde ashtu.

Në këso fusha kam punu edhe kam qenë, kam shkru për gazetën. Ma s’pari për “Zërin” edhe ‘90-tave tonë kohën kam shkrujt, sidomos për ditoren. E menjhere mas luftës 1999 kam nisë nja gjashtë muj, kur ka nisë “Zëri” ditor kam shkrujt çdo ditë ni kolumne t’shkurt, ka pasë ashtu titullin “Pikëpyetje”. Por, kur kalunë gjashtë muj, për ato gjashtë muj nuk pytsha thojsha, “Sa t’keni paguni, s’më intereson, mas gjashtë mujve e kontraktujmë njëfarë çmimi”. Ata mandej, atëhere m’pagujshin për shembull për tridhjetë marka. E kur kalun gjashtë muj thashë, “Hajt ta bisedojmë” ata, “Jo, s’kemi çka bisedojmë”, nuk dojshin me e rrit çmimin. Thashë, “Okej, atëherë une s’po shkruj ma”, edhe qashtu u ndava prej tyne.

Mandej Batoni, Baton Haxhiu e pat' marrë ni pozitë si kryeredaktor i "Kohës Ditore" edhe m'thirri me shkru te "Koha". Shkrujsha për ta, nji vjet a dy, kur ato e largun edhe unë e lashë qashtu. Mandej ma vonë e kemi themelu, kam qenë edhe une njëri ndër themeluesit e "Expressit", atëherë ka qenë drejtor Petrit Selimi në fillim, ma vonë prapë Baton Haxhiu. Derisa ata dytë kanë qenë edhe une kam qenë me ta, ma vonë shkrujsha, ndonjëherë, por jo.

Ni kohë kam qenë edhe redaktor për kulturë edhe për kolumna të "Express-it", por gjithë kam pasë dy-tre projekte. 2003-2004 e kemi nisë qat' projektin "Missing Identity" për artin bashkëkohor, aty unë pos kurset me studentët që i kem pasë të artit e kam pasë redaktu edhe ni shtojcë për art që e ka pasë emrin "Arta" nja dymbëdhjetë numra. Kështu vjet kam qenë aktiv, plus kam shkrujt për katalogje e sene kështu për ekspozita vazhdimisht.

Edhe i kam botu në atë kohë dy seri të revistës "MM" e kem pasë fillu '90-tave, tetë numra i kem botu 1995-1998, mandej u ndërpre. Mas luftës ni atashe për kulturë i Ambasadës Franceze deshti me na ndihmu me vazhdu atë seri edhe për tri vjet e kemi botu. Ma s'pari dojshin me e botu si, si kështu gazetë formale t'formatit t'madh, diçka si *New York Review of Book* qasi farë cilësie, po si format pak ma... por nuk pati shumë sukses. Mandej prapë e ktheva n'format të revistës, ma vonë edhe ProHelvetia m'i ka dhanë për katër numra ni grant pak ma serioz edhe aty kam botu nja disa numra të revistës. Mandej u ndërpre se s'kishte ma fonde. Këtu pata konkuru te ministria [e kulturës], asnjihere s'na kanë ndimu, kështu që...

Aurela Kadriu: Çfarë tematikash ka trajtu "MM"?

Shkëlzen Maliqi: "MM" ka qenë reviste mikse filozofi, sociologji, art, letërsi, gjithçka. Edhe '90-tave kur e kam nisë këta, vet asnjëherë s'kam qenë kryeredaktor po kam qenë si producent, kam qenë gjithë... Atëherë e mendojsha se të gjitha fushat e kemi kah tre, katër, pesë që shkrujnë mirë ma mirë me i mbledh krejt edhe ashtu ishte si njëfarë koncepti postmodern i hapun, pak poezi, pak prozë, pak përkthime edhe gjithmonë ka qenë ato.... Mbaj mend, nji kohë të '90-tave e kem botu prej numrit dy deri n'tetë bashkë me redaksinë e Shqipnisë. SOROS-i tyne kur e pa atë numrin e parë të revistës, thanë, "Po dojmë edhe neve me ju ndihmu", ata e krijun atje ni redaksi me Bashkim Shehun, Remzi Lani, Piro Misha edhe nifarë Qapojev. Edhe kështu edhe ata e përgaditshin ni pjesë, na ni pjesë edhe mirë ka qenë ajo revista mas 2000-tes i merrsha do bashkëpunëtor atje i mledhsha do tekste po nuk kem vazhdu bashkëpunimin ma. Kam qenë i shkepun në shumë punë edhe kurrë s'jom koncentru bash bash vetëm nji send, ndoshta ka qenë gabim po s'e di.

Aurela Kadriu: A ndrron, po më intereson edhe diçka, a ndrron qasja domethanë, a shënon luftën njëfarë pragu ku ndrron qasja juj në shkrime?

Shkëlzen Maliqi: Qasja jeme... Domethanë une n'politikë kam qenë shumë aktiv, në qat' periudhën e parë kur është kriju kjo skena plurale edhe '80-ave kom ndiku që diskursi i Kosovës të lirohet të mos ketë kompleks ndaj Beogradit, a din. Une e kam pasë nji qasje që ka qenë pak ma, t'them ashtu, ma e kapshme ose ma... ata që e pata fol ma herët. Une e kisha tezën se nacionalizmi shqiptar nëse don me luftu ashtu, nuk bon ato me luftu nacionalizmin serb që është ma i rrezikshem edhe se ai shqiptar,

qishtu. Kjo kalojke në atë kontekstin Jugosllav a diçka. Nuk mujshin me m'akuzu se une jam si këta irredentistat e kështu. Po gjatë më mbrojshtin edhe do njerëz që janë atje që kishin prirje nacionaliste serbe, po ishin pak ma normal, ata thojshin, "Jo, Maliqi e ka qendrimin intelektual t'analistit", a din kshtu nuk m'barazojshin me këto grupet marksiste-liniste.

Edhe une nuk thojsha që Kosova duhet me u bashku me Shqipninë ose kësi sene. Intimisht ndoshta edhe e kam thanë, për shembull me një intervistë '90-tave me ni libër që e ka botu ni gazetar serb me titullin e ka, "I kom pytë shqiptarët çka duan, ata m'kanë thanë republikë nëse mundet". "*Pitao sam Albance šta žele, republiku ako može*". Qashtu ai e ka ironizu pak. Aty në atë intervistë une kam thanë që nacionalist as s'më ka shku mendja, pak ma i ri kur kam qenë, me bashku Kosovën me Shqipninë sepse ashtu jam rrit me një familje edhe komuniste, edhe anti enveriste edhe s'e kom mendu këtë punë. Por, kur i lexojsha n'fillim të '80-tave e kështu, ato sulmet ndaj shqiptarëve ato akuzat që shqiptarët po dojnë republikën po dojnë me u bashku me Shqipninë a diçka tash kur i kam mendu une këto mandej kom thanë, "E pse jo, pse mos me u bashku?" A din kështu se ideja ishte nëse ju m'keni bo, Serbia, kështu kështu këto farë diskutet kështu kjo ka qenë. Çka ishte pytja se harrova.

Aurela Kadriu: Ke pytja jem a ka shenu lufta njëfarë pragu ku....

Shkëlzen Maliqi: Po, thashë unë atëherë kam qenë me politikë ma *deep* [Anglisht - thellë] e kështu, po nuk ka qenë nuk është vokacioni im politika. Une për shembull kur e kem formu *UJDI*-n ma s'pari s'e kom mendu për veten po kom propozu Vetonin me qenë. Se e shifsha që ai është njeri shumë ambicioz, e ka n'gjak politikën a diçka edhe me ia dhanë atij, se une nuk e kam asi... nuk jam për politikë njëfarë dore. Mandej e kam kuptu edhe në disa situata tjera, për shembull kur kemi qenë '90-tave niherë me njanin prej gjeneralëve shqiptar nga Zagrebi kem pasë shku në Zarë me do takime me... hala as... m'duket as Kroacia s'ka qenë plotësisht e pavarur, po kem pasë shku me do farë takime edhe kem marrë pjesë me tubimin në Zarë t'madh dhe tash u dashke me fol, a din.

Une as nuk disha me fol si duhet a din, nisa me zhvillu njëfarë teze kështu për m'i kundërvu serbëve po e kisha tezen kështu, pak e çuditshme kështu, që nuk disha me artikulu kështu para masës, ata bërtitshin kështu, thojsha, "Shqiptarët janë popull ndoshta ma i vjetër në Ballkan, ndër ma t'vjetrit sigurisht bashkë me grekët edhe ma i ri kështu për nga moshja, edhe shumë t'vjetër edhe shumë t'ri", por thashë, "janë si njëfarë lule e rrallë qe duhet me e mbrojt", njëfarë argumenti estetik. Ata qyrrshin si bardh, s'dishin as qysh me mendu. Edhe ndegjojsha atje do asi, do ustash, e kroat thojshin, "Profesor, mos u tut, fol mshoj, qepoj atyne çetnikëve", une s'disha, nuk jam për asi diskursi. Qashtu m'ka ndodhë edhe kur kemi qenë në New York, në atë farë Washington njëfarë *hearing* [Anglisht - seancë] që e kem pasë me i thanë i patën mbledh diasporën, i thojshin Simpozium për çështjen e Kosovës, qishtu ka qenë titulli.

Kur hina me njëfarë salle neve na rreshtun nja 30 veta aty me Qosja me krejt, s'di a ka qenë Rugova, m'duket po, edhe aty Repishti, një dietar atje prej shqiptarëve atje. Ai ishte pak ma normal se tjetër, edhe tjetër kanë qenë krejt patriotat nuk po thom ashtu, po ky edhe folshin qisi farë.... Une nisa aty me ju zhvillu njëfarë teze, se atëherë lypshin "*Free Kosovo, free Kosova*" edhe "*Kosovo Republikë*" unë thash, atëherë nuk di pse provova me zhvillu njëfarë teze, se nuk është republika maksimumi që neve

duhet me lyp, se hala Jugosllavia ekzistojke, po nashta nuk mundet kjo me përfundu në Republikë po ndoshta me bashkimin”. Prapë e kisha idenë se ashtu po shkojnë proceset me Serbinë, nëse prishet Jugosllavia çka?

Po nuk mujsha me përfundu se nuk m’lejšin ata veç në çdo rast *uuuu* {onomatope} brohorisnin “Free Kosova, free Kosova” tash unë dikur e ndërpreva thashë, “Jam i lodhun s’po muj me fol ma gjatë”, e nuk ishte për mu ashtu, nuk jam asi tipi që muj me punu n’atë masë, unë ma shumë jam tip kamertal në t’folme me grup t’vogël me pyt, me përgjigjë, mos me ditë m’u përgjigjë. E kjo farë nuk m’u përshtatke. Une di me bo analiza, po s’di me marrë vendime ose me çu punën ashtu me u bo najfarë lideri a diçka. Ashtu që nuk kam pasë shumë ambicie. Edhe gjithë kqyrsha edhe kur nisa me u angazhu edhe kështu me ikë sa ma shumë t’mundem prej politikës. Si atëherë që thashë që kam ikë ‘70-tave prej asaj politikës t’parë n’regjimin jugosllav e kështu nëpër manastire jam marrë me Mesjetë e sene qishtu. Edhe ‘90-tave gjithë kisha dëshirë me u marrë me art e me kulturë edhe mas 2000-tës qashtu njejtë.

Për me mbijetu gjithë është dashtë me u marrë qisi farë sondazhe, ndonjëherë ata m’qitshin n’krye t’agjendës kur ishin, për shembull 2005 në Shqipni mu m’ra diqysh zari me i bo ExitPoll-at e para në Shqipni. Edhe për këto pak e ka fajin në të vërtetë Erion Veliaj, Erion Velija indirekt jo direkt. Erion Velija pat’ ardhë këtu nja ni vjet para, në 2004-shin e kam taku dikun. Kërkonte dikë që bën sondazhe asi edhe i interesojke, a din dikush ktu me bo Exitpoll-a. Ai ish kthy prej Amerikës aty ka pa këto sa janë t’rëndësishme sondazhet, e lypke, une i tregova thashë, “Mundemi edhe neve po s’kem bo kurrë”. Edhe ai mandej është lidh me Top Channel atëherë në Shqipni edhe ata i ka bind se duhet me bo ExitPoll edhe ata qitshin reklama.

Konkurenti, kjo Klani i Shqipnisë, ai Aleksandri e ka pytë Batonin ka thanë, “Këta Topi po don me e bo njifarë sondazhi” ata e kanë marrë njifarë Gallup të Shqipnisë, njifarë organizate me ia bo, “a ka edhe dikush tjetër që munet për neve me e bo?” Ai Batoni ka thanë, “Po janë Shkëlzeni e këta që bojnë...” Neve bojshim këtu qisi farë hulumtime edhe ata na thirrën. Plus 2004-shin na pat’ marrë kur u nda ky si e ka emrin, ky Meta, Ilir Meta prej Partisë Socialiste, Batoni edhe ata e ka bindë me i’a bo hulumtimin e parë, me ia tregu ku është sa ka me fitu n’zgjedhje.

Kur ia bom neve hulumtimin, ai shumë i zhgënjym, “Jo s’keni të drejtë...” se ai e kish marr ni të tretën e partisë, si numra. Thojke, “I kam 25 mijë anëtarë të partisë që kanë kalu prej Partisë Socialiste”, që i ka pasë ndoshta 70, 80 mijë anëtarë edhe i numërojke çdo anëtar n’familje nga gjashtë vota thojke, “I kom 200 mijë vota”, te na dilke shumë ma pak, a din, nuk është bash që shkon ajo me automatizëm. U pat’ zemëru shumë, po kur dolen zgjedhjet bash qashtu doli. Tash ndërkohë kur punum edhe une si ato nja dy hulumtime që ia bom si ato. Veç e kishim njifarë ideje se çka po ndodh në Shqipni edhe dikun në maj ata na thirrën te Klani thanë, “A muni me na bo edhe neve ni ExitPoll, sikur ata që po e reklamojnë?” Ne ju tham, “Po...”, edhe hym edhe e bom ato përgaditjet e krejt n’rregull. Topi nuk e boni, hoqën dorë qishtu,

Tash Erioni i kish organizu ata po s’di, e neve vazhdum deri në ditën e parafundit kur e bom gati ditën e parafundit, ata drejtusit, tre i ka pasë themelus ky Klani, njo ka qenë francez, njo i Shqipnisë edhe ky

Aleksandër, pronari i Klanit, Frangaj, Aleksandër Frangaj. Ditën e parafundit, ata janë bo në mes veti llom, jonë përta, “Jo bon, jo s’bon”. Shërbimi sekret i Nanos aty tonë kohën ka qenë, “S’bon, se këta po dojnë me bo skenarin e Ukrainës me e shpall fitues Sali Berishën”. Nano ishte në pushtet n’televizion e mandej me u çu populli me e ndrru.

Neve s’dishim çka po ndodhë veç thojshim, “Neve e bojme”. Mandej tanë ditën ata kishin vendos vetëm masdite na thanë, “Okej”, na e kishim përgadit krejt edhe e bom. Krejt ditën kem punu, i mblodhem rezultatet në 16:00 ia tregum për afersisht qysh është tendenca, ata thanë, “Okej”. U shifke se po fiton Partia Demokratike veç thanë, “Në rregull është,” tha, “mundeni me shpall po s’guxojmë me e shpall për krejt vendet. A bon veç për Tiranën?” thashë, “rezultati është i ju”. Tirana Durrësi a din, ajo ishte edhe ma keq, se krejt këto dolën kaltërt, po fiton bindshem veç njo a dy zona i ka fitu, atëherë ka qenë me zona. Edhe ia qëllum që s’ka fitu Sala, u ndrru pushteti e sene. Po qashtu ka qenë shumë interesante, ma vonë mandej ndonjëherë ja qëllujshim ndonjëherë jo.

Tani edhe këtu jena marr me kësi sene, po domethanë qikjo farë, aktiviteti ka qenë thjeshtë me i bo do pare me i shkollu fëmijtë e mi, se nuk isha une ndonjë rroge permanente. Pak prej gazetave pak kështu. Ama prej ktyne projekteve ndonjëherë fitojshë mirë. Kam punu në 2003-tën edhe për Partinë e Re të Bujar Bukoshit, kështu kohë pas kohë. Domethanë, i bojshim hulumtimet n’fillim, u tregojshin ku janë, ku mujn me u përmirësu e ksi sene. Ama, ndonjë punë stabile e kështu.

E kam pasë qat’ shtëpinë nuk ka qenë problem për banim, po edhe kam fitu ndonjëherë pak ma shumë. Ama thjeshtë une provojsha sa ma shumë me u largu prej politikës edhe nihere kur m’ka pasë thirrë “Ora” në 2007-tën me ndihmu me i fut në lista. Edhe atëherë pranova, domethanë, 2007-tën ka qenë m’thirren këta të “Orës”, Ylber Hysa ka qenë, m’tha, “A don me qenë pjesë e listës, me ju ndihmu a diçka?” Unë thashë, “Okej”. Por, pranova me ni kusht une, disi nëse mujn edhe n’parlament nëse hyjmë me e përfaqësu shoqinë civile. Ndoshta ka qenë si idealizëm, si diçka po mirë.

Nuk patëm sukses, nuk e fitum, nuk e kalum cenzusin, se vet Surroi e këta kanë gabu kur kanë kërku me qenë pesë përqind, kanë mendu se i fitojnë ma shumë se pesë. Une prej hulumtimeve e disha që janë katër rreth tre, katër. Ai Yll Hoxha gjithë vike kur i votojshin ma herët ato anketat, “E ke gabim neve jemi shumë...” “Po nashta...” tash këto partitë e vogla nuk mundemi gjithë me i kap se e kanë votën e koncentrone po thashë, “Me punu ma shumë n’teren, me e mbrojt votën, se ndoshta i keni. Por, qato 200-300 vota që i fitoni dikund me naj qytezë, a në Istog a anej a knej, ato duheni me i mbrojt, se ato i fshijnë. Nuk i numërojnë”. Edhe nuk patën kalu.

Edhe atëherë hera e fundit që kam dashtë me hy n’politikë edhe ma vonë këtu kur m’ka thirrë Edi Rama me u bo këshilltar i tij për rajonin, m’u ka duk pak si interesant se mendojsha pak me ndrru me jetu në Tiranë. M’ka pëlqy gjithë Tirana, po nuk m’i ka plotësu krejt ato kushtet që m’ka premtu. Jo me pasë edhe ni rrogë t’dytë, se rroga ka qenë shumë e vogël, me ma gjetë edhe ni banesë kështu derisa jam atje. Ashtu që me 750 euro sa i merrsha u dashtë me pagu edhe banesën edhe kështu. Nuk m’ka dalë hesapi. I kam pasë une do kursime t’mija, por i kam pasë edhe do probleme me do kamë e diçka do operacione, që edhe qato kursime hupën, që ma shumë kam vujt u dashtë me punu me përkthime e kështu edhe punë t’natyrës tjetër për me mbijetu. Mandej u ktheva këtu megjithatë, se këtu ma

t'lehtë e kam me jetu. Kështu, politika nuk ka qenë ambicia ime ma e madhe, po njifarë dore e kam mësu zanatin e analistit, t'them ashtu, por nuk e kam pasion kryesor.

Aurela Kadriu: A ka diçka që kishit pasë qef me shtu që keni harru na me ju pyt, ose ju që nuk e keni përmend?

Shkëlzen Maliqi: Po ka shumë sene po s'po di.

Aurela Kadriu: Naj sen që është ma e rëndësishme?

Shkëlzen Maliqi: Jo s'di. Ka shumë sene por.... Këtu është problemi me mu kur intervistë përgadit dikush edhe din çka me m'pyt ose çka do që ty t'intereson une muj me t'u përgjigjë po s'po di s'po m'kujtohet naj send me thanë.

Aurela Kadriu: As une nuk kam naj pyetje tjetër, veç faleminderit shumë për kohën.

Shkëlzen Maliqi: Shumë mirë, mjaft është nashta. Nëse keni prapë mundemi me vazhdu, po s'ka nevoj nashta. M'duket që pak a shumë e kemi rrumbullaksu.

Aurela Kadriu: Po pak a shumë po vetëm nëse keni edhe diçka. Unë s'kam pyetje tjetër. Faleminderit shumë.